



Agjencia Ndërkombëtare Japoneze për Bashkëpunim (JICA-Kansai)




Qendra për trajnim për reduktimin e fatkeqësive (DRLC)

Byroja e zjarrfikësve në qytetin Kobe

"BOKOMI" Doracak

Shkëmbimi i mësimëve të fituara në Qytetin Kobe nga Tërmeti i madh i ashtuq. Hanshin-Awaji

Programet për Stërvitje gjatë
Emergjencave në komunitet
dhe
Programet Edukative Arsimore
gjatë Fatkeqësive



Porti i qytetit Kobe



Organizatrat vullnetare në komunitet të Kobes për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive “Komunitetet për mirëqenie të sigurtë gjatë fatkeqësive” janë të njohura me pseudonimin BOKOMI, që paraqet shkurtesën nga gjuha japoneze “Bosai Fukushi Komyunithi”



“BOKOMI” Doracaku

Shkëmbimi i mësimëve të fituara në Qytetin Kobe
nga
Tërmeti i madh i ashtuq. Hanshin-Awaji

**Programet për Stërvitje gjatë Emergjencave në komunitet
dhe
Programet Edukative Arsimore gjatë Fatkeqësive**

Shkup, 2016

Botues:

QENDRA PËR MENAXHIM ME KRIZA

Recenzim:

m-r Suzana Saliu

d-r Urim Vejseli

Përkthimi:

Nehim Tairi

Shtypshkronja dhe Pregaditjen kompjuterike:

DIGI PRINT - Shkup

Tirazhi:

50

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

37:[504.4:355.58(035)

ВОКОМИ doracaku : shkëmbimi e mësimëve të fituara në qytetin Kobe nga tërmeti i madh i ashtuq Hanshin-Awaji : programet për stërvitje gjatë emergjencave në komunitet dhe programët edukative shkollare gjatë fatkeqësive / [përktheu Nehim Tairi. - Shkup : Qendra për menaxhim me kriza, 2016. - 142 стр. : илустр. ; 21 см

Превод на делото: Vokomi guidebook. - Преведено според: Бокоми прирачник

ISBN 978-608-65931-1-7

а) Природни катастрофи - Заштита и спасување - Образовни програми
- Прирачници

COBISS.MK-ID 100412170

Përmbajtja

1. Historiku i përpilimit të Doracakut	5
2. Organizata Vullnetare e Komunitetit të Kobes për Reduktim të Rrezikut gjatë Fatkeqësive–BOKOMI	7
3. Edukimi gjatë fatkeqësive në Kobe (Bashkëpunimi ndërmjet Aktiviteteve të Komunitetit për Reduktim të Rrezikut gjatë Fatkeqësive dhe Edukimit shkollor për Fatkeqësitë)	9
4. Si të përdoret ky Doracak	13
I. Formimi i Organizatës Vullnetare në Komunitet për Reduktim të Rrezikut gjatë Fatkeqësive Natyrore–“BOKOMI”	
1. Masat për Nxjitjen e Aktiviteteve të Organizuara për Reduktim të Rrezikut nga Fatkeqësitë	16
2. Hartimi i Planit të Komunitetit për Menaxhim të Fatkeqësive (me Mostra)	19
3. Përmbatja e Mbështetjes Komunale për Aktivitetet Vullnetare për Reduktim të Rrezikut gjatë fatkeqësive natyrore	36
II. Programet e Komunitetit për Stërvitje Emergjente	
1. Krijimi i Planit Vjetor të Ngjarjes	44
2. Si të realizohet një Stërvitje Emergjente	47
3. Pajisjet dhe materialet e nevojshme për Reduktim të Rrezikut gjatë Fatkeqësive	49
4. Trajnim duke përdorur “Bombola uji për fikjen e zjarrit gjatë Provave të Evakuimit”	53
5. Prova Evakuimi duke përdorur “Bombola me pluhur për fikjen e zjarrit”	55
6. Trajnimi i Brigadave me Kova	57
7. Provat e shpëtimit	60
8. Trajnim për Lidhjen e Nyjes së Litarëve	63
9. Stërvitje për evakuim	66
10. Stërvitje për përhapje të informacioneve	70
11. Harta e Sigurisë së Komunitetit	74
12. Stërvitje për kontrollin e përmbytjeve	82
13. Realizimi i Stërvitjeve në kombinim me Aktivitetet në Komunitet	86
III. Programet edukative arsimore gjatë fatkëqsive	
1. Modeli i një Plani për Menaxhim të Fatkeqësive në Shkolla (Shkolla fillore)	90
2. Modeli i një Plani Vjetor të Shkollave për Edukim gjatë Fatkeqësive (Shkolla fillore)	103
3. Vizatimi i përfytyrimit tuaj të Tërmetit	104
4. Stërvitja për raportim gjatë emergjencave	106
5. Eksplorimi i shkollës për gjetjen e Resurseve për Reduktimin e Rrezikut gjatë Fatkeqësive	108
6. Shëtitja nëpër qytet për gjetjen e Resurseve për Reduktimin e Rrezikut gjatë Fatkeqësive	110
7. Evakuimi në mënyrë të sigurtë dhe pa rrezik! (Stërvitje për evakuim)	112
8. Loje me qitje në objektiv duke përdorur Bombola uji për fikjen e zjarrit	114
9. Përjetimi i transportimit të një personi që përdor batanije	116
10. Të stërvisim si t’i trajtojmë lëndimet trupore	118
11. Përballja! Brigadat me kova (description / reference)	120

Recenzim

BOKOMI doracaku është një mjet me qëllim edukativ, të cilën popullata dhe shkollat mund të përdorin për të fituar njohuritë e duhura teorike dhe praktike nga fusha e "zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë në nivel të komunitetit."

Doracaku është përkthyer nga gjuha angleze, kurse në origjinale është shkruar nga një grup autorësh në gjuhën japoneze. Qëllimi fillestar është që të shërbejë si një udhëzues praktik për komunitetin dhe shkollat si literaturë profesionale që është në dobi të madhe për popullatën, për bashkëpunim mes komunitetit dhe shkollave. Gjithashtu përdoret për të fituar njohuri në fushën e vetë-ndihmës dhe ndihmës të ndërsjellë në rast të fatkeqësive natyrore, dhe gjithashtu paraqet një material të dobishëm për konsultimin e kuadrove të arsimtarëve dhe prindërve të fushës në fjalë.

Doracaku rrjedh nga përvoja dhe mësimet e nxjerra nga tërmeti i madh Hanshin -Avaxhi, i cili goditi qytetin Kobe më 17 janar të vitit 1995, dhe me pasojat e të cilit ballafaqoheshte komuniteti japonez.

*m-r Suzana Saliu, Drejtor i Qendrës për menaxhim me kriza
d-r Urim Vejseli, Udhëheqës i sektorit për bashkëpunim ndërkombëtar*

1. Historiku i përpilimit të Doracakut

Tërmeti i madh i ashtuq. Hanshin-Awaji i cili ndodhi në ora 5:46 në mëngjes, më 17 janar të vitit 1995, shkaktoi dëme shkretuese në rajonin e Hanshin-Awaji, përfshirë dhe qytetin Kobe.

Tërmeti shkatërroi një numër të madh të shtëpive, ndërsa shpërthyen zjarre në shumë pjesë të qytetit. Kjo e bëri thuajse të pamundur për njësitë e shpëtimit dhe të zjarrfikësve të arrijnë dhe veprojnë në të gjitha vendet e katastrofës.

Prandaj, u realizuan operacione shpëtimi nga vetë qytetarët në shumë vende të qytetit. Gjithashtu, qytetarët luftonin me zjarret duke formuar brigada me përdorim të kovave me ujë.

Mirëpo, nuk patën pajisje të mjaftueshme të veprojnë në mënyrë të organizuar, madje nuk kishin as trajnim të duhur në mënyrë rutinore.

Qyteti Kobe fitoi mësim nga tërmeti, ndërsa pushteti lokal është përqendruar në themelimin dhe zhvillimin e organizatave vullnetare në komunitet për reduktim të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore. Kjo gjithashtu ka të bëjë edhe me shpërndarjen e pajisjeve dhe materialeve të llojllojshme për reduktimin e rrezikut gjatë fatkeqësive, të ndihmojë organizatat në realizimin e provave të ndryshme të evakuimit, si dhe akordimin e subvencioneve për realizimin e aktiviteteve për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive.

Qyteti Kobe i quan këto organizata vullnetare të komunitetit për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive si “Komunitete për mirëqenie të sigurtë gjatë fatkeqësive.” Emri i shkurtuar për Komunitetin për mirëqenie të sigurtë gjatë fatkeqësive është BOKOMI, e cila është shkurtesë nga emri japonez “*Bosai Fukushi Komyunithi*”.

Këshilli arsimor i Qytetit Kobe poashtu krijon materiale të llojllojshme edukative për reduktimin e rrezikut gjatë fatkeqësive të cilat mund të përdoren nëpër shkolla me qëllim të përcjelljes tek nxënësit mësimet e fituara nga tërmeti.

Ky udhëzues përmban një sërë programesh për stërvitje gjatë emergjencave të cilat mund të zhvillohen nga organizatat vullnetare në komunitet për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive, si dhe një sërë programesh edukative gjatë fatkeqësive kryesisht dedikuar shkollave fillore. (Përmbajtja është marrë nga një broshurë e përpiluar nga Byroja e Zjarrfikësve të Qytetit Kobe.)

Byroja e Zjarrfikësve e Qytetit Kobe dhe JICA Kansai kanë realizuar program trajnimi në temë “Reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive në komunitet” për paraqitjen e rasteve të Komunitetit për mirëqenie të sigurtë gjatë fatkeqësive në çdo shtet të botës qysh në vitin 2007, me pjesëarrjen e më shumë se 145 zyrtarëve në krye të sektorëve për reduktim të rrezikut nga fatkeqësitë, nga të cilat 45 shtete shpesh herë kanë qenë të goditur nga fatkeqësi natyrore (qysh mars 2015). Trajnimi i paraqet metodat dhe shembujt praktik të organizatës vullnetare në komunitet për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive BOKOMI në Kobe. Pjesëmarësit e çdo shteti i përcjellin

njohuritë e fituara nga Japonia në shtetet e tyre përkatëse dhe e praktikojnë programin BOKOMI në formë të përshtatshme për shtetin ose rajonin e tyre.

Shpresojmë që ky udhëzues do t'ju jep informacione të dobishme për realizim të teknikave dhe provave të evakuimit për të ndërlidhur aktivitetet e komunitetit për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive me edukimin shkollor rreth fatkeqësive, pasi që të themeloni dhe kultivoni organizata vullnetare për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive në vendin tuaj përkatës.

Shpresojmë që përdorimi i këtij udhëzuesi do të kontribuojë në reduktimin e rrezikut gjatë fatkeqësive natyrore në vendin tuaj.

[Raste të Aktiviteteve për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive të realizuara nga ish pjesëmarrës]



Aktivitet edukativ mbi fatkeqësitë dedikuar fëmijëve të shkollave fillore (Çile)



Një punëtori për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive dedikuar banoreve lokal (Myanmar)



Korpusi vullnetar i zjarrfikësve i përbërë nga banorë lokal (Iran)

2. Organizata vullnetare në komunitet e Kobes për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive–“BOKOMI”

Organizatat vullnetare në komunitet të Kobes për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive “Komunitetet për mirëqenie të sigurtë gjatë fatkeqësive” janë të njohura me pseudonimin BOKOMI, që paraqet shkurtesën nga gjuha japoneze “*Bosai Fukushi Komyunithi*”.

Themelimi i BOKOMI-it u promovua pas Tërmetit të madh të ashtuq. Hanshin-Awaji. Organizata modele u themeluan në 11 rajone të qytetit duke filluar që nga viti 1995. Aktualisht, në 191 rajone në qytet funksionon BOKOMI, duke përfshirë tërë zonën e Qytetit Kobe (BOKOMI janë të organizuar 100% në të gjitha rajonet e Qytetit Kobe).

BOKOMI-it janë të themeluara duke u bazuar në rajonet komunale të shkollave fillore sipas banorëve.

Arsyeja pse BOKOMI-it janë të bazuar në rajone të shkollave fillore është sepse ekziston tashmë një organizatë për “Mirëqenie në komunitet” e themeluar për qëllime të mirëqenies në çdo rajon të shkollave fillore, ndërsa një organizatë për reduktim (*bosai*) të rrezikut gjatë fatkeqësive u integrua në organizatën ekzistuese.

Gjithashtu, shkollat fillore shërbejnë si zona evakuimi në raste emergjente (si p.sh., fatkeqësi natyrore dhe krime) në Japoni. Kjo është edhe një arsye pse BOKOMI është themeluar në çdo rajon të shkollave fillore në mënyrë që çdo BOKOMI të vë në funksion zonën e tyre të evakuimit në raste emergjente.


Procesi i themelimit të BOKOMI-t në zonat lokale është si në vijim. Së pari, diskutohet dhe merret vendim nga ana e organizatave të vetëqeverisjes lokale për themelimin e një organizate vullnetare në komunitet për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive, përfshirë dhe zyrën lokale të pushtetit lokal dhe njësitin e zjarrfikësve, së bashku me liderë të asociacioneve lokale, asociacioneve të grave, asociacioneve të moshës së tretë, korpuseve vullnetare të zjarrfikësve, asociacioneve e prindërve dhe mësimeve, etj.

Pasi që merret vendim për themelimin e BOKOMI-t, pajisjet dhe materialet e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve distribuohen nga pushteti lokal (Kobe), si dhe krijohen depo në parqet lokale, si parapërgatitje për raste emergjente.

Në kohëra të zakonshme, çdo BOKOMI realizon programe për stërvitje emergjente siç shpjegohet në faqet e mëvonshme, përfshirë atë se si të përdoret materiali dhe pajisjet e siguruar, si pjesë e aktiviteteve të parapërgatitjes për katastrofa të mëdha.

Me qëllim të përdorimit të rrjeteve të njerëzve në raste emergjente, BOKOMI gjithashtu realizon aktivitete të mirëqenies (siç është mbajtja e kontakteve dhe organizimi i drekave të

përbashkëta me të moshuarit që jetojnë vetëm) si përpjekje për të mbuluar edhe aktivitetet për mirëqenie të komunitetit edhe aktivitetet për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive në komunitet. Ky është një tipar karakteristik i organizatave vullnetare në komunitet për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive në Qytetin Kobe, të cilat u themeluan duke u bazuar në mësimet e fituara nga Tërmeti i madh i ashtuq. Hanshin-Awaji.



3. Programi i Kobes për edukim rreth fatkeqësive (Bashkëpunimi ndërmjet aktiviteteve të komunitetit për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive dhe aktiviteteve për edukim shkollor rreth fatkeqësive)

Bashkëpunimi ndërmjet BOKOMI-t dhe shkollës

Në Japoni, “edukimi rreth fatkeqësive” nuk është një lëndë konkrete e vetme për dallim nga “aritmetika” ose “gjuha japoneze.”

Edukimi rreth fatkeqësive në Japoni përfshin: mësimin rreth mekanizmave të shpërthimeve vullkanike dhe tërmeteve, motin, etj., në leksionet për “studimin e natyrës”; mësimin rreth reduktimit të rrezikut gjatë fatkeqësive natyrore, rolin e policisë, shërbimin e zjarrfikësve, aktivitetet e komunitetit për reduktim të rrezikut nga fatkeqësitë, etj., në leksionet për “lëndët shoqërore”; si dhe mësimi rreth rëndësisë së jetës dhe frymës së ndihmës së ndërsjellë në leksionet e “etikës” dhe “mësimin të integruar”. Për më tepër, nxënësit zakonisht mësojnë për reduktimin e rrezikut gjatë fatkeqësive nëpërmjet stërvitjeve emergjente, të cilat i parapërgatisin ato për raste të zjarreve dhe fatkeqësive, së bashku me stërvitjet për evakuim të cilat shkollat duhet t’i realizojnë sipas ligjit në Japoni.

Në Qytetin Kobe, BOKOMI lokal ndihmon në realizimin e këtyre stërvitjeve emergjente nëpër shkolla sepse bashkëpunimi ndërmjet shkollave dhe komuniteteve ka përparësitë në vijim.

Përparësia 1 BOKOMI mund t’u ofrojë shkollave këshilla dhe drejtime sepse ato rregullisht realizojnë stërvitje emergjente në komunitetet e tyre dhe posedojnë njohuri, pajisje dhe material për stërvitjet.

Përparësia 2 Banorët e komunitetit e përjetuan Tërmetin e madh të ashtuq. Hanshin-Awaji dhe prandaj mund t’ua përcjellin drejtëpërsëdrejti fëmijëve, të cilët nuk e kanë përjetuar atë; mësimet e fituara nga tërmeti. Për më tepër, numri i mësimdhënësve që nuk e kanë përjetuar tërmetin është poashtu në rritje. Banorët e komunitetit që marrin pjesë në aktivitete shkollore mund t’i ndihmojnë mësimdhënësit që nuk kanë përjetuar tërmete dhe të mundësojnë edukim më efektiv për fatkeqësitë natyrore nëpërmjet të cilëve nxënësit do të kuptojnë me të vërtetë rëndësinë e tij.

Përparësia 3 Prindërit e nxënësve dhe këshillat e prindërve, të cilët nuk marrin pjesë shpesh herë në stërvitjet e komunitetit kanë më shumë gjasa të marrin pjesë në stërvitjet emergjente që mbahen nëpër shkolla. Kjo mundëson një rast për ata të interesohen dhe marrin pjesë edhe në aktivitetet e komunitetit për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive, kurse kjo mund të shpie në rigjallërimin e BOKOMI-t.

Bashkëpunimin ndërmjet Organizatave të pushtetit lokal dhe ndihma e tyre për Komunitetet (BOKOMI-t)

Këshilli Arsimor i Qytetit Kobe dhe KCFB-ja (e cila e mbështet BOKOMI-n) së bashku hartuan një sërë programesh për edukim rreth fatkeqësive të cilat mund të përdoren në shkolla (kryesisht shkolla fillore) dhe institucione tjera arsimore. Keto programe pastaj u përpiluan në broshurë. (Vargu i programeve për edukim rreth fatkeqësive e shpjeguar në këtë udhëzues është marrë nga ajo broshurë.)



[Programet e Qytetit KOBE për mbështetje të edukimit rreth fatkeqësive]

Kjo broshurë përfshin një mori të programeve edukative nëpërmjet të cilave fëmijët mund të përfitojnë njohuri, përfshirë dhe teknikat për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive përderisa mendojnë në mënyrë të pavarur dhe të argëtohen njëkohësisht.

Përveç vargut të programeve për edukim rreth fatkeqësive, kjo broshurë gjithashtu ka për qëllim të shpjegojë atë sesi mund të bashkëpunojnë shkollat me BOKOMI-n lokal gjatë realizimit të çdo programi.

Broshura i shpërndahet BOKOMI-t dhe shkollave që synojnë promovimin e aktiviteteve për arsim të integruar rreth fatkeqësive nga ana e komuniteteve dhe shkollave.

Pritet që zbatimi i kësaj broshure në edukimin rreth fatkeqësive të avancojë aktivitetet e bashkërenditura ndërmjet komuniteteve dhe shkollave fillore.

KCFB-ja gjithashtu e bën bashkërendimin e shkollave dhe komuniteteve duke dërguar një person me njohuri për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive në çdo stacion të zjarrfikësve, i/e cili/a ka për detyrë të ofrojë këshilla për stërvitje dhe edukim rreth fatkeqësive, huazimin e materialeve edukative, dhe pajisjeve dhe materialeve të tjera, si dhe dërgimin e personelit zjarrfikës tek komunitetet dhe shkollat.

Korniza për bashkëpunim ndërmjet sektorëve të llojllojshëm në Prefekturën Hyogo dhe Qytetin Kobe (Organizata të vetëqeverisjes lokale, universitete, komunitete, shkolla, kompani private, OJQ, etj.)

Qysh nga tërmeti i madh i ashtuq. Hanshin-Awaji që ndodhi 20 vite më parë, popullsia e Prefekturës Hyogo dhe Qytetit Kobe e kanë mësuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet sektorëve të ndryshëm (raporti “horizontal”) për përmirësimin e aftësive për reduktimin e rrezikut gjatë fatkeqësive dhe promovimin e programeve edukative shkollore për fatkeqësi, sesa të realizojnë aktivitetet e tyre veç e veç si sektorë individual (raporti “vertikal”).

Gjatë 15 viteve të ekzistencës së vet, është zhvilluar kornizë bashkëpunuese siç është paraqitur më poshtë, nëpërmjet të cilave sektorë të ndryshëm në Hyogo dhe Kobe tani i mbështesin aktivitetet e komuniteteve dhe fëmijëve.

(Shih diagramin në faqen e ardhshme [Edukimi rreth fatkeqësive i integruar ndërmjet komuniteteve dhe shkollave].)

Shpresojmë që do të përdorni këto informacione kur të promovoni programet për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive nëpër komunitetet e vendit tuaj sepse vendosja e bashkëpunimit ndërmjet aktiviteteve të komuniteteve për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive dhe programeve për edukim gjatë fatkeqësive në shkolla mund të kontribuojë edhe për rigjallërimin e aktiviteteve të komuniteteve për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive edhe për edukim më cilësor për fatkeqësi në shkolla.




Edukimi i integruar rreth fatkeqësive ndërmjet komuniteteve dhe shkollave

Rasti në Prefekturën HYOGO dhe Qytetin KOBE

Ofron materiale / Realizon stërvitje për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive

Krijon & dhe ofron nëntekste



4. Si të përdoret ky Doracak

(1) Programet e komunitetit për stërvitje emergjente

Kjo pjesë shpjegon programe të llojllojshme të stërvitjeve të cilat mund të realizohen nga banorët lokal të komuniteteve, si udhëzime dedikuar organizatave vullnetare të komuniteteve për reduktimin e rrezikut gjatë fatkeqësive.

Kjo pjesë, gjithashtu, përfshinë informacione për atë sesi të hartohet një plan stërvitjeje dhe si të realizohen stërvitje emergjente gjatë implementimit të stërvitjeve në komunitetet lokale.

Kur iu jepni udhëzime komuniteteve lokale për të realizuar stërvitje emergjente, mund të përdorni programet e këtij udhëzuesi dhe ta ndani përmbajtjen me pjesëtarët e komunitetit.

Nëse nuk ekziston ndonjë kornizë konkrete për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive në rajonin tuaj, mund të përdorni zona tjera dhe aktorë të ndryshëm në ato zona (si p.sh., organizata rezidente, institucione religjioze, shoqata të grave dhe grupe për mbështetje të ndërsjellë). Nëse ekzistojnë grupe që merren me çështje konkrete në komunitetin tuaj (si p.sh., fushën e mirëqenies, mjedisit apo shëndetësisë), mund të punoni me këto grupe dhe t'i inkurajoni që të përfshihen në aktivitete për reduktimin e rrezikut gjatë fatkeqësive krahas aktiviteteve të tyre aktuale.

Për shembull, mund të konsiderohen grupe që merren me:

“ mirëqenien + reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive”
“ mjedisin + reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive”
“ shëndetësinë + reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive”

Gjithashtu rekomandohet që para kohe të kontrolloni dhe diskutoni me organizatat përkatëse për atë se cilat organizata qeveritare mund të ndihmojnë aktivitetet për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive dhe në çfarë mënyre (lidhur me udhëzimet gjatë stërvitjeve, huazim të pajisjeve dhe materialeve, sigurim të hapësirës për aktivitete, mbështetje financiare, etj.) që t’ua prezantoni informacionet rezidentëve.

(2) Programet shkollore për edukim rreth fatkeqësive

Kjo pjesë i shpjegon programet e llojllojshme për edukim rreth fatkeqësive, të cilat kryesisht synojnë shkollat fillore. Kjo pjesë përfshin shembuj të planeve shkollore për menaxhim me fatkeqësi dhe një plan shkollor vjetor për edukim rreth fatkeqësive.

Programet (përshkrimet dhe referencat e programeve) janë të hartuara për t’u përdorur dhe udhëzohen vetem nga mësimmhënësit, mirëpo shumica e programeve mund të realizohen në bashkëpunim dhe me komunitetet lokale. Kështu, mund të përdorni

informacionet për implementim të aktiviteteve edukative së bashku me komunitetin dhe shkollat.

Në Kobe, komunitetet lokale (BOKOMI) i ndihmojnë shkollat të realizojnë stërvitje emergjente, të cilat zakonisht mbahen pas stërvitjeve të evakuimit nëpër shkolla. Organizata qeveritare lokale përfshirë dhe zjarrfikësit gjithashtu ndihmojnë gjatë stërvitjeve emergjente.

(3) Çështje që duhet konsideruar

Përmbajtja e programit është kryesisht për aktivitete që përfshijnë parapërgatitje për tërmete.

Programi për stërvitje emergjente dhe programi për edukim rreth fatkeqësive gjithashtu bazohen në kushtet e Japonisë. Prandaj, ju lutemi që ta përshtatni përmbajtjen sipas kushteve të vendit tuaj gjatë përdorimit të këtyre informacioneve.

Në Japoni, mbështetja qeveritare për stërvitjet emergjente dhe trajnimi për ofrimin e ndihmës së parë kryesisht realizohet nga stacionet e zjarrfikësve. Çdo mbështetje qeveritare në përputhje me kushtet aktuale të çdo shteti duhet të sigurohet nëpërmjet kornizave të përshtatshme.

Gjithashtu, është ide e mirë që të rishqyrtohet dhe diskutohet korniza e bashkëpunimit ndërmjet organizatave qeveritare në këtë fushë.



**Formimi i organizatës
vullnetare në komunitet
për Reduktim të rrezikut
gjatë fatkeqësive–
“BOKOMI”**

1. Masa për nxitjen e aktiviteteve të organizuara për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive

(1) Reagimi ndaj fatkeqësive në një organizatë vullnetare (Sistemi i qytetit Kobe)

Për reagimet ndaj fatkeqësive në çdo komunitet, Komuniteti për mirëqenie të sigurtë gjatë fatkeqësive (BOKOMI) merret me aktivitete për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive në kohë paqeje me çdo ekip të specializuar të zjarrfikësve, të shpëtimit dhe ndihmës, etj., të formuara brenda organizatës. Pasiqë të ndodh një fatkeqësi natyrore, do të formohet shtabi i BOKOMI-t nga ato ekipe të specializuara për të drejtuar çdo bllok godinash.

Në kohë fatkeqësie, është ideale që ato ekipe të formuara që më përpara të kryejnë aktivitete për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive në fushat e tyre të caktuara. Mirëpo, varësisht nga dëmet e bëra, nuk është patjetër që të gjithë pjesëtarët e ekipeve të specializuara të mblidhen në vendngjarje dhe se sistemi patjetër të funksionojë sipas planit.

Në kohë fatkeqësie, është reagim real edhe nëse nuk mblidhen të gjithë pjesëtarët e BOKOMI-t në vendngjarje, ata që janë mbledhur e vënë në funksion organizatën dhe e riformojnë çdo ekip me banorët lokal që janë mbledhur aty.

Kundrejt një sfondi të këtillë, Qyteti Kobe paradokohe ka përgatitur një sistem të ri drejtimi për Komunitetet e mirëqenies së sigurtë gjatë fatkeqësive.

(2) Përgatitja e një sistemi për drejtimin dhe aranzhimin e aktiviteteve lokale për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive (politikat për formim të ekipeve)

Sipas modelit të ICS (Sistemi për komandim me incidente), një sistem i standardizuar për menaxhim me fatkeqësi në Britani të Madhe, Qyteti Kobe ka caktuar role për Organizatat vullnetare për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive (BOKOMI-t) dhe banorëve lokal si më poshtë. Prej tyre pritet që t'i luajnë këto role si reagim fillestar ndaj fatkeqësive. Futja e mekanizmit të ICS në Komunitetet për mirëqenie të sigurtë gjatë fatkeqësive do t'iu mundësojë atyre të kenë drejtime definitive dhe funksione të aranzhuara.

(Shih “Figurën e aktiviteteve të BOKOMI-t gjatë një fatkeqësie” në faqen e rradhës.)

Anëtarët e Komunitetit për mirëqenie të sigurtë gjatë fatkeqësive (BOKOMI):

Themelojnë shtabin e BOKOMI-t në një lokacion të paracaktuar në “planin e komunitetit për menaxhim të fatkeqësive.” Rindërtojnë çdo ekip me banorët lokal që janë grumbulluar e ndërkohë bëni aranzhime për të dërguar ndihmës tek komunitetet të cilëve iu mungon fuqia punëtore.


Bloqet e ndërtesave për çdo rajon (banorët): banorët lokal kryejnë reagime të para të mundshme, si për shembull zjarrfikje, shpëtim fillestarë dhe ofrim të ndihmës së parë, me nismë të përfaqësuesve të rajonit dhe udhëheqësve të mbrojtjes civile.¹

¹

Udhëheqësit civil të trajnuar nga Byroja e zjarrfikësve të Qytetit Kobe. Prej tyre pritet që të marrin rolin udhëheqës gjatë stërvitjeve emergjente rutinore dhe kur ndodh ndonjë fatkeqësi.

< Figura e aktiviteteve të BOKOMI-t gjatë një fatkeqësie >


Diagrami organizativ në kohë fatkeqësie



Anëtarët e BOKOMI: Themelojnë shtabin e BOKOMI-t në një lokacion të paracaktuar në “planin e komunitetit për menaxhim të fatkeqësie.” Rindërtojnë çdo ekip me banorët lokal që janë grumbulluar e ndërkohë bëni aranzhime për të dërguar ndihmës tek komunitetet të cilëve iu mungon fuqia punëtore.

Bloqet e ndërtesave për çdo rajon (banorët): banorët lokal kryejnë reagime të para të mundshme, si për shembull zjarrfikje, shpëtim fillestar dhe ofrim të ndihmës së parë, me nismë të përfaqësuesve të rajonit dhe udhëheqësve të mbrojtjes civile.


Figura e aktiviteteve të BOKOMI-t gjatë një fatkeqësie



2. Hartimi i planit të komunitetit për menaxhim të fatkeqësive

(1) Çfarë është Plani i komunitetit për menaxhim të fatkeqësive?

Japonia ka një sistem autonom lokal me një strukturë tre shtresash që përbëhet prej pushtetit qendror, vetëqeverisjes lokale dhe komunave, nën të cilat vetëqeverisjet lokale dhe komunat hartojnë një plan lokal për menaxhim me fatkeqësi për çdo rajon në pajtim me Planin themelor për menaxhim me fatkeqësi të Këshillit qendror për menaxhim me fatkeqësi pranë pushtetit qendror.



Ligji i sapo rishikuar themelor për Kundërmasa gjatë fatkeqësive e rekomandon hartimin e “planit të komunitetit për menaxhim me fatkeqësi” për çdo komunitet, një zonë edhe më e vogël se sa një komunë, e cila paraqet zonën më të vogël administrative dhe pritet nga ajo të hartojë një “plan lokal për menaxhim me fatkeqësi.” Plani i komunitetit për menaxhim me fatkeqësi parasheh aktivitete që duhet të ndërmerren në vendngjarje ose në nivel të komunitetit, gjatë një fatkeqësie. Në Qytetin Kobe, plani i komunitetit për menaxhim me fatkeqësi hartohet për çdo Komunitet të mirëqenies së sigurtë gjatë fatkeqësive (BOKOMI).

Planet lokale për menaxhim me fatkeqësi në Qytetin Kobe karakterizohen kryesisht me stilin e tyre të saktësimin të aktiviteteve dhe planeve që duhet të ndërmerren gjatë fatkeqësive në formë të listave kontrolluese (çeklistë). Lista kontrolluese përshkruhet në dy hapa: një “kapitul ku qartësisht theksohen çështje si për shembull, ku duhet të grumbullohen anëtarët e BOKOMI-t dhe njerëzit e tjerë të bllokut” dhe një “kapitull ku listohen sendet thelbësore si një çeklistë gjatë reagimit ndaj fatkeqësive.” Ky stil i mundëson çdo anëtar të BOKOMI-t ose banori vendas menjëherë të merr pjesë në menaxhimin organizativ me ndihmën e kësaj liste në dorë të tij/saj kur ndodh ndonjë fatkeqësi.

Që qartë të tregohen aktivitetet që ndërmerren në një fatkeqësi, përveç planit të komunitetit për menaxhim me fatkeqësi, hartohen edhe “udhëzime paraprake për veprim” që përshkruajnë se çfarë duhet të bëjë çdo ekip reagimi në çdo bllok, përfshirë dhe “komunikimin dhe grumbullimin e informacioneve”, si dhe “konfirmimin e sigurisë së banorëve. Reagime emergjente do të kryhen nëse “udhëzimet paraprake për veprim” i dorëzohen dhe shpërndahen ndërmjet anëtarëve të BOKOMI-t ose postohen në vende lehtësisht të dukshme tek shtabet e BOKOMI-t (baza).

Kur ndodh ndonjë fatkeqësi me përmasa të mëdha, është e nevojshme që së pari të integrohet fuqia punëtore e banorëve në aktivitete për reagim ndaj fatkeqësive. Gjatë

këtij procesi është e rëndësishme për të gjithë banorët e komunitetit të formojnë ekipe veprimi në bashkëpunim me njëri tjetrin dhe të kryejnë me elasticitet reagimet ndaj fatkeqësive, përfshirë dhe dërgimin e ndihmësve nëpër komunitetet e tjera, të cilëve iu mungon fuqia punëtore, nën drejtimin e BOKOMI-t.

(2) Çështje që duhet konsideruar gjatë hartimit të Planit të komunitetit për menaxhim me fatkeqësi

- a. Të caktohet lokacioni për shtabin e BOKOMI-t ku anëtarët e BOKOMI-t do të mblidhen kur të ndodh ndonjë fatkeqësi.
- b. Të caktohen vende ku banorët vendas do të mblidhen për çdo bllok që të kryejnë reagime individuale ndaj fatkeqësisë (p.sh., vende ku janë në dispozicion makineri, materiale dhe rezervuare/burime uji).
- c. Të kontrollohen lokalitetet e rrezikshme në komunitet nëpërmjet diskutimeve paraprake dhe ecjes nëpër qytet.
- d. Të shqyrtohen me vëmendje çeklistat për artikujt e nevojshëm për reagim që i duhen komunitetin.

Plani i komunitetit për menaxhim me fatkeqësi dedikuar komunitetit XX (Mostër) Përpiluar më datë MM/DD, 20xx

☆Pikat për hartimin e planit të komunitetit për menaxhim me fatkeqësi ☆

Në qytetin Kobe, “plani i komunitetit për menaxhim me fatkeqësi” hartohet për çdo Komunitet për mirëqenie të sigurtë gjatë fatkeqësive sikurse dhe udhëzuesi për reagim ndaj fatkeqësive në komunitet kështuqë Organizatat vullnetare për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive mund të veprojnë në mënyrë më efektive gjatë fatkeqësive.

Reagimet fillestare gjatë një fatkeqësie dallojnë nga njëra tjetra për nga lloji i fatkeqësisë (dëme nga fortunat dhe përmytjet, tërmetet, cunamit, etj.). Për çdo lloj të fatkeqësisë, reagimet fillestare në thelb përfshijnë ngritjen e shtabit të BOKOMI-t dhe grumbullimit të informacioneve. Nga ana tjetër, ngritja e shtabit dhe sjellja gjatë evakuimit para se të ndodh ndonjë fatkeqësi çojnë në reduktimin e dëmeve në rast të “dëmeve nga fortunat dhe përmytjet” dhe “cunamit,” ndërsa shpëtimi dhe ndihma për të plagosurit dhe zjarrfikja fillestare pas shpërthimit të ndonjë fatkeqësie priritetizohen në kategorinë e “tërmeteve.”

Shpresohet që ky udhëzues/mostër të merret parasysh si udhëzues për aktivitetet e Organizatave vullnetare për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive kur të praktikoni aktivitetin për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive në vendin tuaj.

Plani i komunitetit për menaxhim të fatkeqësive dedikuar komunitetit XX (Mostër)

Kriteret për ngritjen e shtabit të BOKOMI-t

- Kur regjistrohet një dridhje seizmike prej 5 ose më pak apo më shumë ose kur lëshohet një paralajmërim për cunami në bregun e Detit Seton ë Prefekturën Hyogo
- Kur shkaktohet një fatkeqësi nga ndonjë tërmet ose kur mund të përhapet fatkeqësia
- Kur lëshohet një paralajmërim i veçantë
- Kur lëshohen informacione për fatkeqësi nga rrëshqitja e dheut në Kobe për shkak të rreshjeve të mëdha të shiut, etj.

Politikat e veprimit

Mësimet e fituara nga fatkeqësitë e kaluara e dëshmojnë rëndësinë e ndihmës së ndërsjellë ndërmjet fqinjëve. Mirëpo, kur ndodh ndonjë fatkeqësi, duhet mirë të kontrolloni mjedisin që ju rrethon, të kujdeseni për sigurinë tuaj, si dhe të kryeni aktivitete për reduktim të rrezikut nga fatkeqësitë sipas mundësive në dispozicion, por dhe nuk duhet të rraskaniteni shumë.

Lokacioni për shtabin e BOKOMI-t	P.sh.) Shkolla fillore A (Parku B në rast të cunamit)		
Lokacioni për shtabet e blloqeve	P.sh.) Parku B, qendra e komunitetit, tempull, etj.		
Lokacionet për depotë me materiale dhe makineri për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësisë	P.sh.) Parku B, qendra e komunitetit, tempull, etj.		
Strehimoret e përcaktuara të evakuimit	P.sh.) Shkolla fillore A		
Çisterna me ujë (që e përballojnë zjarrin) për zjarrfikje	P.sh.) Parku B		
Vende ku ruhet lista e njerëzve të rrezikuar	P.sh.) Shkolla fillore A		
Mbajtëse për radio	P.sh. Kryetari C		
Lokacionet për materiale të rrezikshme në komunitet	P.sh.) Pranë lumit D Nën urën E, etj.		

(1) Dëmet nga fortunat dhe përmytjet

[Para se të ndodh fatkeqësia]

1. Ngritja e shtabit të BOKOMI-t

- Anëtarët e Komunitetit për mirëqenie të sigurtë gjatë fatkeqësive (BOKOMI) që tashmë janë grumbulluar e ngritin shtabin e BOKOMI-t. (Pritet që të mos grumbullohen të gjithë zyrtarët e BOKOMI-t gjatë ndonjë fatkeqësie).
- Zgjedhja e liderit të përgjithshëm për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive nga anëtarët e BOKOMI-t që tashmë janë grumbulluar.
- Lideri i përgjithshëm për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive i organizon anëtarët e BOKOMI-t që janë grumbulluar në ekipe (ekipi për informacione strategjike, ekipi për menaxhim me resurse, etj.).
- Sigurimi, te shtabi, i materialeve si për shembull harta lokale, harta për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive, si dhe listën e njerëzve të rrezikuar.

Përgatitja e tabelës së bardhë për të ndarë informacione ndërmjet anëtarëve.

2. Komunikimi dhe grumbullimi i informacioneve

- Grumbullim të informacioneve për motin, informacione për paralajmërim të fatkeqësive për rrëshqitje të dheut, etj., nëpërmjet radio sistemit për menaxhim me fatkeqësitë ose radio/TV.
- Informacionet e grumbulluara i përcillen liderit të bllokut nëpërmjet linjës telefonike tokësore, celular, etj.
- Në rast se pritët rrezik nga përmytjet ose rrëshqitja e dheut, iu bëhet thirrje njerëzve të rrezikuar të evakuhohen në mënyrë vullnetare sa më shpejtë që është e mundur. Në ndërkohë, bëhen përgatitje (p.sh., sigurimi i personelit) për ekipet e veprimit në çdo bllok për të udhëzuar njerëzit e rrezikuar drejt vendit të evakuimit.

3. Sigurimi i mjeteve të komunikimit në organizatë

- Të caktohen paraprakisht mjetet dhe mënyra të komunikimit (Cili i komunikon kujt dhe në çfarë mënyre?).

4. Udhëzime evakuimi për njerëzit e rrezikuar

- Në rast se pritët rrezik nga përmytjet ose rrëshqitja e dheut, ekipet e veprimit në çdo bllok i udhëzojnë njerëzit e rrezikuar drejt vendit të evakuimit nëse nuk mund të evakuhohen vetvetiu.

5. Sigurimi i makinerisë dhe materialeve

- Të sigurohen materialet dhe makineria për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive, si dhe ushqime emergjente në përgatitje për fatkeqësinë.

[Menjëherë pas ndodhjes së fatkeqësisë]

1. Drejtime nga ana e shtabit të BOKOMI-t

- (Ngritja e shtabit të BOKOMI-t njësoj sikurse [para se të ndodh fatkeqësia].)
- Ekipi për informacione strategjike mbledh informacione për dëmet e zonës dhe jep udhëzime për aktivitete konkrete (p.sh., komunikimi dhe grumbullimi i informacioneve, konfirmimi i sigurisë së banorëve, shpëtim dhe ndihmë për viktimat) për secilin bllok varësisht nga dëmet e shkaktuara.
- Në rast se ndonjë blloku i mungon fuqi punëtore të ekipeve, dërgohet personel tek ai bllok nga shtabi.

2. Reagime ndaj fatkeqësive për çdo bllok

- Qytetarët e aftë për pjesëmarrje në aktivitete për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive grumbullohen tek “depoja më e afërt e materialeve dhe makinerisë për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive” ose “rezervuarin e ujit të përballueshëm ndaj dridhjeve,” dhe kryejnë aktivitete për reduktim të rrezikut në grupe të vogla.
- Lideri i bllokut (p.sh., kryetari i asociacionit të banorëve lokal) i organizon qytetarët që kanë arritur në ekipe, si p.sh. në ekip për “shpëtim dhe ndihmë,” në pajtim me natyrën e fatkeqësisë.

3. Komunikimi dhe grumbullimi i informacioneve

- Grumbullim të informacioneve për motin, informacione për paralajmërim të fatkeqësive për rrëshqitje të dheut, etj., nëpërmjet radio sistemit për menaxhim me fatkeqësitë ose radio/TV.
- Informacionet e grumbulluara për motin etj., i përcillen liderit të bllokut nëpërmjet linjës telefonike tokësore, celular, etj.
- Lideri i bllokut e kontrollon gjendjen, përfshirë dëmet e shkaktuara dhe sigurinë e banorëve në çdo bllok nëpërmjet linjës telefonike tokësore, celularit, etj.

4. Konfirmimi i sigurisë së banorëve

- Të konfirmohet siguria e banorëve bazuar në listën e njerëzve të rrezikuar të përgatitur paraprakisht.
- Nëse lista nuk është përpiluar paraprakisht, atëherë të konfirmohet siguria e rezidentëve në bashkëpunim me vullnetarët e autorizuar të mirëqenies dhe me anëtarët e komisionit për fëmijë.
- * Diferencimi, për shembull, duke shënuar ndonjë shenjë ose cope letre në derën e çdo shtëpie për të konfirmuar sigurinë e banorëve poashtu është metodë efektive.

5. Shpëtim dhe ndihmë

- Të shpëtohen viktimat me përdorim të materialeve dhe makinerisë për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive për secilin bllok, e ndërkohë të kihet kujdes nga fatkeqësia dytësore.

- Nëse ndonjë viktimë është e plagosur, ofroni atij/asaj ndihmë të parë si p.sh., ndërprerje të gjakderdhjes dhe transportim deri te institucioni mjekësor.

6. Raportimi tek zyra e lagjes dhe stacioni i zjarrfikësve

- Dëmet e shkaktuara dhe aktivitetet e ndërmarra të raportohen tek zyra e lagjes dhe stacioni i zjarrfikësve.
- Për gjësendet e nevojshme për menaxhim me strehimoret e evakuimit të raportohet tek zyra e lagjes, etj.

7. Ngritja e strehimoreve të evakuimit

- Të ngriten strehimore evakuimi në bashkëpunim me shkollat dhe zyrtarët e lagjes.
- Të përpilohet lista e personave të evakuar.

(2) Tërmetet

[Menjëherë pas ndodhjes së fatkeqësisë]

Veprimet e secilit person

1. Sigurimi i vendit të sigurtë menjëherë pas ndodhjes së tërmetit

- Nëse përdorni nxehtësi, fikeni nxehtësinë kur të jetë e mundur.
- Pasiqë të ndjeni dridhje nga tërmeti, së pari kujdesuni për sigurinë tuaj duke, për shembull, u grumbulluar nën ndonjë pemë të fortë.
- Kontrolloni sigurinë e familjes suaj.
- Në rast të zjarrit, kryeni zjarrfikjen fillestare me bombola kundër zjarrit, etj.
- Dëgjojeni radion për informacione.

Aktivitetet e Komunitetit për mirëqenie të sigurt gjatë fatkeqësive (BOKOMI)

1. Ngritja e shtabit të BOKOMI-t

- Anëtarët e komunitetit për mirëqenie të sigurtë (BOKOMI) të cilët tashmë janë mbledhur e ngritin shtabin e BOKOMI-t. (Pritet që të mos grumbullohen të gjithë zyrtarët e BOKOMI-t gjatë ndonjë fatkeqësie.)
- Zgjedhja e liderit të përgjithshëm për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive nga anëtarët e BOKOMI-t që tashmë janë grumbulluar me nxitim tek shtabi.
- Lideri i përgjithshëm për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive i organizon anëtarët e BOKOMI-t që janë grumbulluar në ekipe (ekipi për informacione strategjike, ekipi për menaxhim me resurse, etj.).
- Sigurimi, te shtabi, i materialeve si për shembull harta lokale, harta për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive, si dhe listën e njerëzve të rrezikuar. Përgatitja e tabelës së bardhë për të ndarë informacione ndërmjet anëtarëve.
- Ekipi për informacione strategjike grumbullon informacione mbi dëmet në zonë dhe jep udhëzime për kryerjen e aktiviteteve konkrete (p.sh., komunikimi dhe grumbullimi i informacioneve, konfirmimi i sigurisë së banorëve, shpëtim dhe ndihmë) për çdo bllok varësisht nga dëmet e shkaktuara.
- Në rast se ndonjë blloku i mungon personel për ndihmë, atëherë dërgohet personel shtesë tek ai bllok nga shtabi.

2. Reagimet ndaj fatkeqësive për çdo bllok

- Qytetarët e aftë për pjesëmarrje në aktivitete për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive grumbullohen tek “depoja më e afërt për material dhe makineri për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive” ose “rezervuarin e ujit,” dhe kryejnë aktivitete për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive në grupe të vogla.
- Lideri i bllokut (p.sh. kryetari i asociacionit lokal të banorëve) i organizon qytetarët që janë mbledhur në ekipe, si p.sh., ata për zjarrfikje dhe shpëtim, tek depoja e materialeve dhe makinerisë për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive në pajtim me natyrën e fatkeqësisë.

3. Komunikimi dhe grumbullimi i informacioneve

- Grumbullim të informacioneve për tërmetin nëpërmjet radio sistemit për menaxhim me fatkeqësitë ose radio/TV.
- Informacionet e grumbulluara për tërmetin nëpërmjet radio sistemit për menaxhim me fatkeqësi i përcillen liderit të bllokut me anë të lajmëtarëve.
- Lideri i bllokut e kontrollon gjendjen, përfshirë dhe dëmet e shkaktuara dhe sigurinë e banorëve në çdo bllok, me anë të lajmëtarëve.
- * Gjatë një tërmeti, edhe linja tokësore dhe celularët ka gjasa të jenë të paarritshëm.

4. Konfirmimi i sigurisë së banorëve

- Të konfirmohet siguria e banorëve bazuar në listën e njerëzve të rrezikuar të përpiluar paraprakisht.
- Nëse lista nuk është e përpiluar, të konfirmohet siguria e banorëve në bashkëpunim me vullnetarët e autorizuar të mirëqenies dhe anëtarët e komisionit për fëmijë.
- * Diferencimi, për shembull, duke shënuar ndonjë shenjë ose cope letre në derën e çdo shtëpie për të konfirmuar sigurinë e banorëve poashtu është metodë efektive.

5. Aktivitetet për zjarrfikje

- Të kryhet zjarrfikje fillestare duke përdorur një pompë të vogël me energji për tankun e ujit i përballueshëm ndaj tërmeteve, si dhe pajisje të tjera për zjarrfikje për çdo bllok.
- Të zbulohet ku ka filluar zjarri.
- Dërgimi i personit për zjarrfikje.
- * Përdorimi i bombolave të zjarrit ose brigadës me kova gjithashtu është i rëndësishëm, varësisht nga shkalla e zjarrit.

6. Aktivitete për shpëtim dhe ndihmë

- Të shpëtohen të plagosurit duke përdorur materiale dhe makineri për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive për secilin bllok, ndërkohe të kihet parasysht fatkeqësia dytësore.
- * Vegla si p.sh., kriko, shufra hekuri dhe sharra janë të dobishme gjatë operacioneve të shpëtimit
- Të dërgohet personel shpëtimi.
- Nëse ndonjë person është plagosur, ofroni asaj/atij ndihmë të parë si p.sh., ndërprerje të gjakut dhe transportim tek institucioni mjekësor.

7. Mbështetja për njerëzit e rrezikuar gjatë evakuimit

- Të mbështetet evakuimi i njerëzve të rrezikuar të cilët i kanë shtëpitë e dëmtuara dhe kanë nevojë për strehim.
- Dërgimi i mbështetësve.

8. Raportimit tek zyra e lagjes dhe stacioni i zjarrfikësve

- Dëmet e shkaktuara dhe aktivitetet e ndërmarra të raportohen tek zyra e lagjes dhe stacioni i zjarrfikësve.
- Për gjësendet e nevojshme për menaxhim me strehimoret e evakuimit të raportohet tek zyra e lagjes, etj.

9. Ngritja e strehimoreve të evakuimit

- Të ngriten strehimore të evakuimit në bashkëpunim me zyrtarët e shkollave dhe zyrën e lagjes.
- Të përpilohet lista e personave të evakuuar.

(3) Cunami

1. Ngritja e shtabit të BOKOMI-t

- Edhe pse mund të mos ketë informacione nga qyteti, supozoni se mund të ndodh cunami kur ndjeni dridhje të fuqishme dhe të vazhdueshme. Ngriteni shtabin e BOKOMI-t në një lokacion të paracaktuar që të mos ketë gjasa të goditet nga cunami, si p.sh. shkollë fillore ose ndonjë qendër për mirëqenie lokale.
- Anëtarët e komunitetit për mirëqenie të sigurtë (BOKOMI) të cilët tashmë janë mbledhur e ngritin shtabin e BOKOMI-t. (Pritet që të mos grumbullohen të gjithë zyrtarët e BOKOMI-t gjatë ndonjë fatkeqësie.)
- Zgjedhja e liderit të përgjithshëm për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive nga anëtarët e BOKOMI-t që tashmë janë grumbulluar me nxitim tek shtabi.
- Lideri i përgjithshëm për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive i organizon anëtarët e BOKOMI-t që janë grumbulluar në ekipe (ekipi për informacione strategjike, ekipi për menaxhim me resurse, etj.)
- Sigurimi, te shtabi, i materialeve si për shembull harta lokale, harta për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive, si dhe listën e njerëzve të rrezikuar. Përgatitja e tabelës së bardhë për të ndarë informacione ndërmjet anëtarëve.
- Në rast se ndonjë blloku i mungon personel për ndihmë, atëherë dërgohet personel shtesë tek ai bllok nga shtabi.

2. Komunikimi dhe grumbullimi i informacioneve

- Grumbullim të informacioneve për cunamin nëpërmjet radio sistemit për menaxhim me fatkeqësitë ose radio/TV, dhe përcjellja e informacioneve të grumbulluara liderit të bllokut me anë të linjës telefonike tokësore, celularit, etj.
- T'iu bëhet thirrje njerëzve të rrezikuar të evakohen menjëherë

3. Mbështetje gjatë evakuimit

- Banorët e bllokut e mbështesin evakuimin e njerëzve të rrezikuar të cilët janë pothuajse të paaftë për t'u evakuar menjëherë dhe bërtasin, "Ikni! Po vjen cunami!" dhe njëkohësisht i prijnë evakuimit.

Cilat grupe konsiderohen të rrezikuara?

Secili që e ka vështirë të evakohet në një vend të sigurtë apo që jetonë në strehimoren e evakuimit, si dhe ka nevojë nga njerëzit përreth tyre nën ato rrethana

- Personat me aftësi të kufizuar
- Personat që kanë nevojë për infermiere
- Të moshuarit (që jetojnë vetëm ose me bashkëshortin/ten e moshuar)

Personat pothuajse të paaftë për t'u evakuar vetvetiu, përfshirë pacientët me sëmundje të vështira, foshnjat, grate shtatzëne ose ato që japin gji, si dhe ato që janë plagosur gjatë fatkeqësisë.

(4) Artikuj të zakonshëm

[Disa orë deri tre ditë (72 orë) pas ndodhjes së fatkeqësisë]

1. Shqyrtim të ndarjes së roleve

- Rolet shqyrtohen duke u bazuar në gjendjen e grumbullimit të zyrtarëve të BOKOMI-t dhe gjendjes së fatkeqësisë

2. Menaxhimi me strehimoret për evakuim

- Strehimoret e evakuimit të menaxhohen në bashkëpunim me zyrtarët e shkollave dhe zyrën e lagjes dhe vullnetarët për restaurim të fatkeqësisë
- Të kihen parasysh gratë dhe familjet me fëmijë të vegjël
- Të kihen parasysh kafshët shtepiake të evakuar me pronarët e tyre
- Të kihen parasysh njerëzit e rrezikuar (p.sh., krijimi i një hapësire të veçantë tek strehimorja për mirëqenien e njerëzve të rrezikuar në pajtim me dëshirat e atyre njerëzve dhe familjeve të tyre; shfrytëzimi i zyrës së infermierisë në shkollë)
- * Në veçanti, është e rëndësishme që edhe personat e tjerë të evakuar të kuptojnë domosdoshmërinë e trajtimit special për personat me aftësi të kufizuar intelektuale, psikike, ose zhvillimore, të cilët e kanë të vështirë të jetojnë në grupe, si dhe personat me çrregullime të brendshme si p.sh. dializë apo pacientë që përdorin anus ose fshikëz artificiale).
- Të referohen ato që kanë nevojë për strehim të mirëqenies (shih faqen e radhës) tek ndonjë infermiere publike, i/e cili/a iu bën vizitë strehimoreve të evakuimit.

3. Grumbullimi i informacioneve për rutinën ditore

- Të grumbullohen informacione për rutinën ditore dhe të shpërndahen ndërmjet banorëve në komunitet.

4. Patrulla për zjarfikje dhe parandalim të krimit

- Të formohen ekipe patrullimi dhe të patrullohet me rrradhë në komunitet.

Udhëzime paraprake për veprim (shembull)
Procedura e veprimeve në formë të shkruar të dërgohet tek vendngjarja
gjatë një fatkeqësie

Komunikimi dhe grumbullimi i informacioneve

- 1. Të grumbullohen informacione për tërmetin, etj., nëpërmjet radio sistemit për menaxhim me fatkeqësinë ose radio/TV.**
- 2. Të kuptohen dëmet nga fatkeqësia në komunitet.**

Çështje kryesore në mbështetje të evakuimit

1. Grumbullimi i informacioneve

Informacionet e grumbulluara duhet vendosur në një tabelë të bardhë, etj., sipas renditjes kronologjike.

- (1) Grumbullimi i informacioneve nëpërmjet radios dhe mediave të tjera
Të përdoren radio/TV dhe radio sisteme për menaxhim me fatkeqësinë, si dhe celularë në qoftëse sigurohen mjete të tilla.
- (2) Grumbullimi i informacioneve nga qeveria
Të kontaktohet drejtpërdrejtë me agjencitë përkatëse për grumbullimin e informacioneve të nevojshme. Gjithashtu, të vizitohet zyra komunale në mënyrë të rregullt për të grumbulluar informacionet e shpallura.
- (3) Grumbullimi i informacioneve nga çdo bllok

2. Komunikimi

Si mjete për komunikim përdorni me efikasitet megafonë, tabelën e shpalljeve ose qarkore.

Konfirmimi i sigurisë së banorëve

1. Grumbullimi i informacioneve për sigurinë e banorëve

2. Konfirmimi i banorëve siguria e të cilëve nuk dihet

- (1) Të konfirmohet siguria e banorëve duke u bazuar në listën e njerëzve të rrezikuar të përpiluar paraprakisht.
- (2) Nëse lista nuk është e përgatitur, të konfirmohet siguria e banorëve në bashkëpunim me vullnetarët e autorizuar të mirëqenies dhe anëtarët e komisionit për fëmijë.

Procedura e konfirmimit tek shtëpia e banorit

1. Kontrolloni pamjen e shtëpisë

Të kontrollohet pamja e shtëpisë nëse ka pësuar ndonjë dëm serioz.

2. Thërritni emrin e të zotit


Thërritni emrin e familjes jashtë portës.

3. Trokitni te dera

Nëse nuk ka përgjigje, trokitni te dera e njëkohësisht thërritni emrin.

4. Kontrolloni oborrin, derën e pasme, etj.

Nëse gjendja e asaj familje ende nuk është e sigurtë, kontrollojeni oborin, derën e pasme, etj.



5. Vendosni një afishe konfirmimi

Vendosni një afishe në derën e përparme në pajtim me gjendjen e konfirmuar.

Ngjyra me kod e afisheve:

● Nevojitet ndihmë/mbështetje ● Siguria e panjohur ● Siguria e konfirmuar; nuk ka nevojë për mbështetje

Aktivite të shpëtimit dhe ndihmës

- 1. Të kryhen aktivite të shpëtimit në bashkëpunim me banorët duke përdorur materiale dhe makineri për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive (kriko, sharra, shufra hekuri, etj.) për secilin bllok.**
- 2. Ofroni ndihmë (ndihmë të parë).**

Procedura e shpëtimit dhe ndihmës

1. Të kuptohen dëmet e fatkeqësisë

- (1) Të kontrollohen kushtet (përfshirë seriozitetin e plagëve) e njerëzve të ngecur në ndërtesat e rrënuara.
- (2) Të kontrollohen kushtet e ndërtesave të rrënuara dhe nëse çdo ndërtesë e rrënuar ka ndonjë hapësirë për të hyrë personeli i shpëtimit.
- (3) Të kontrollohen faktorët e rrezikut për ndonjë fatkeqësi dytësore.

2. Parandalimi i fatkeqësisë dytësore

- (1) Të menjahen pengesat me peshë të lehtë, si p.sh., blloqet prej druri, fletët e galvanizuara të hekurit, si dhe copëzat e qëlqit të thyer.
- (2) Kur menjohen pengesat që e rrethojnë një objekt të madh si p.sh. shtyllat, trare, etj., mbështeteni ose shtrëngojeni objektin e madh me litar që të mos lëviz ose rrëzohet objekti.
- (3) Le të jenë në gjendje gatishmërie bombolat e zjarrit dhe kovat e ujit për shkak të mundësisë së shpërthimit të zjarreve. Valvulat kryesore të gazit dhe çelësi elektrik të fiken sa më herët që është e mundur.

3. Shpëtimi i viktimave

- (1) Përdorni duart tuaja në vend të makinerisë pasi që të keni gërmuar afër viktimës.
- (2) Mos e tërhiqni jashtë me zor viktimën.

4. Ndihma e parë

Nëse viktimë ka gjakderdhje, shtypeni plagën me garzë të pastër, etj.

Aktivite të zjarrfikjes

- 1. Kryeni zjarrfikje fillestare duke përdorur një pompë të vogël elektrike për tankun e ujit, si dhe pajisje të tjera në dispozicion për zjarrfikje për secilin bllok (ose asociacioni lokal i banorëve).**
- 2. Zbuloni vendin ku ka filluar zjarri dhe dërgoni personel për zjarrfikje.**

Aktivite për zjarrfikje

1. Përzgjedhja e ujit për zjarrfikje

- (1) Përzgjedhni ujë për zjarrfikje pranë origjinës së zjarrit. Kushtoni vëmendje drejtimit të erës dhe përdorni ujin që gjendet në drejtim të kundërt të erës nëse era është e fortë.
- (2) Kur merrni ujë për zjarrfikje nga ndonjë lum, hudhni një site në drejtim të rrjedhjes së ujit dhe mbajeni të zhytyr.
- (3) Kushtoni vëmendje intervalit vertikal ndërmjet pompës dhe sipërfaqes së ujit.

2. Si të zgjatni zorrën

- (1) Të parandaloni thyerjen, përdredhjen ose zvarritjen e saj, zorra duhet të lakohet me lak më të madh tek qoshet e ndonjë rruge ose ndërtese.
- (2) Zorrët duhet sigurt të lidhen së bashku që të parandalohet rrjedhja e ujit.

3. Kur të spërkatet me ujë

- (1) Filloni të spërkatni me ujë pas pranimit të sinjalit 'Në Regull' nga personeli në krye të zgjatjes së zorrës dhe mbajtjes së grykës së zorrës.
- (2) Rubineti duhet të hapet gradualisht duke konsideruar zbrapsjen së ujit tek gryka.

Mbështetje për personat e rrezikuar gjatë evakuimit

Mbështeteni evakuimin e njerëzve të rrezikuar që kanë nevojë të evakohen në strehimore.

Çështje kryesore gjatë mbështetjes për evakuim

1. Të moshuarit që jetojnë vetëm

Komunikimi i shpejtë dhe udhëzimet për evakuim, konfirmimi i sigurisë së tyre, si dhe të kuptuarit e gjendjes së tyre janë të domosdoshme.

2. Personat që dergjin dhe kanë nevojë për kujdes mjekësor dhe të moshuarit

Karroca, barela dhe pajisje të tjera plotësuese mund të nevojiten gjatë evakuimit të tyre.

3. Personat me sëmundje psikike

Nevojitet konfirmimi i sigurisë, gjendjes së tyre si dhe udhëzime për evakuim.

4. Personat me dëmtim të shikimit

Janë të nevojshme shpjegime dhe komunikim i duhur, si dhe udhëzime për evakuim.

5. Personat me dëmtim të dëgjimit

Janë të nevojshme vegla ndihmëse për dëgjim, si dhe komunikimi dhe shpjegimi me përdorim të gjuhës së shenjave, figurave dhe ilustrimeve.

6. Personat me vështirësi në të folurit

Është e nevojshme që të kuptohet gjendja e tyre me përdorim të gjuhës së shenjave dhe/ose shkrim të mesazheve.

7. Personat që përdorin ventilator mekanik në shtëpi

Është e nevojshme të sigurohet burim energjie tek strehimorja e evakuimit.

3. Përmbajtja e mbështetjes komunale për aktivitetet vullnetare për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive

Mbështetja komunale për aktivitetet vullnetare për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive është e rëndësishme për Organizatat vullnetare për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive që të veprojnë pa vështirësi.

Në qytetin Kobe, Byroja e zjarrfikësve angazhohet për mbështetjen e aktiviteteve të Organizatave vullnetare për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive ose ndryshe quhen Komunitete për mirëqenie të sigurtë gjatë fatkeqësive (BOKOMI). Ndërkohë, stacionet e zjarrfikësve që përbëjnë rreth 10 stacione në nivel të qytetit i inkurajojnë aktivitetet e përditshme të Organizatave vullnetare për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive që të bashkëpunojnë me organizata të tjera të ngjashme në këtë fushë.

Ky kapitull paraqet përmbajtjet kryesore të mbështetjes së Byrojë së zjarrfikësve në qytetin Kobe që iu ofrohet aktiviteteve që bëhen nga Komunitetet për mirëqenie të sigurtë gjatë fatkeqësive. Shpresohet që të këshilloni këto informacione kur të themeloni ose mbështetni Organizatat për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive në vendin tuaj.

(1) Sigurimi i materialeve dhe makinerisë për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive Organizatave të sapoformuara

Pas themelimit të organizatës së re BOKOMI, qyteti Kobe siguron materiale dhe makineri për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive, të cilat i ka zgjedhur komuniteti nga 54 artikuj, përfshirë një depo për materiale dhe makineri, një pompë të vogël elektrike, kriko, shufër hekuri (panxhë) dhe një sharrë.

Materialet dhe makineria e siguruar për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive magazinohen në një depo për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive të ngritur në ndonjë park ose shkollë të komunitetit, dhe të cilat përdoren edhe gjatë stërvitjeve emergjente rutinore edhe kur ndodh një fatkeqësi në të vërtetë. Çelësin e derës së depose e ruan një organizatë anëtare që jeton aty pranë dhe dera hapet çdoherë kur përdoren materialet apo makineria.

(2) Subvencione për një pjesë të kostos së aktivitetit

Edhe pse BOKOMI-t, në parim, janë organizata vullnetare, qyteti Kobe iu siguron subvencione për një pjesë të kostos së aktiviteteve të tyre.

Subvencionet vlejnjë për dy lloje të kostos si vijon. Një here në vit, pranohen aplikacione për subvencione dhe akordohen subvencione. (Vlerat e subvencioneve janë që në v.2015.)

1) Koston për menaxhment dhe aktivitete (\140,000/në vit për çdo BOKOMI)

Koston për aktivitete të zakonshme dhe përditësimin e materialeve dhe makinerisë

2) Koston për aktivitete të bazuara në propozime (\200,000/në vit për çdo BOKOMI plani i të cilëve është aprovuar)

Kosto për aktivitete pionere ose të orinetuara kah komuniteti të propozuara veç e veç nga çdo BOKOMI dhe të aprovuara si projekte të denjë për subvencione të veçanta.

Kostoja për aktivitete të bazuara në propozime subvencionohet në bazë të aplikimeve. Planet e aktiviteteve me të cilat aplikohet shqyrtohen një herë në vitë nga Byroja e zjarrfikësve për të përcaktuar se cili do të subvencionohet.

(3) Trajnimi i liderëve civil për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive

Në tërmetin e madh Hanshin-Awaji në vitin 1995, zjarrfikja fillestare dhe aktivitetet e shpëtimit bëhenin nga qytetarët, përfshirë sidomos aktivitete të organizuara për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive në komunitetet ku ishin prezent liderë për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive.

Në bazë të kësaj përvoje, qyteti Kobe realizon “trajnime dedikuar liderëve për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive” çdo vit tek çdo stacion i zjarrfikësve për të ofruar mundësi mësimin e roleve gjatë një fatkeqësie dhe si të japin udhëzime gjatë stërvitjeve emergjente të llojllojshme. Deri më sot janë trajnuar rreth 20,000 liderë (2015).

<Kurikula e trajnimit (Shembull)>

- Trajnimi në klasë: plani i Organizatës vullnetare për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive, stërvitjet emergjente si dhe masat tjera për reduktim të rrezikut
- Trajnimi praktik: stërvitja për komunikim, stërvitja për zjarrfikje, stërvitja për shpëtim dhe ndihmë (transportimi dhe ndihma e parë për të plagosurit), loja e përfytyrimit të fatkeqësisë (DIG; stërvitja emergjente e thjeshtësuar me përdorim të hartës), kontrollimi i strehimoreve për evakuim, kontrollimi i rezervave emergjente, takimi për vetëvlerësim.

(4) Mbështetja për aktivitetet e komunitetit për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive nëpërmjet Sistemit për caktimin e zjarrfikësve për çdo zonë

Në prill të vitit 2007, qyteti Kobe futi një “sistem për caktimin e zjarrfikësve në çdo zonë” në përpjekje për të mbështetur aktivitetet e Komuniteteve për mirëqenie të sigurtë gjatë fatkeqësive. Ky sistem synon ndërtimin e marrëdhënieve ndërmjet banorëve dhe Qytetit dhe ofron mbështetje adekuate për nevojat lokale duke caktuar zjarrfikës me përvojë të madhe në terren për çdo Komunitet për mirëqenie të sigurtë gjatë fatkeqësive.

Nëse zyrtari i caktuar mungon në stacionin e zjarrfikësve për shkak të punës në terren, atëherë kërkesës së Komunitetit do t'i përgjigjet zyrtari asistent.

Orari vjetor i stacionit të zjarrfikësve (Shembull)

Aktiviteti	Muaji	Pr.	Maj	Qer	Korr	Gus	Sht.	Tet	Nën	Dhj	Jan.	Shk	Mar
Udhëzime për hartimin e planit vjetor												○	○
Punë byrokratike rreth subvencioneve		○	○	○	○							○	○
Trajnim për liderët civil për red. të rrez.gjatë fatkeqësive													○
Udhëzime gjatë stërvitjeve, ligjeratave				○	○		○	○	○	○	○		○
Takim me përf. të BOKOMI				○			○			○			
Ngjarjet e BOKOMI-t në zonën e caktuar											○		
Takimi me personelin në krye të reduktimit të rrezikut gjatë fatkeqësive në stacion		○						○					
Trajnim për komunitetin në stacion		○											

(5) Përpilimi i Doracaku të referimit në Mars 2009, qyteti Kobe publikoi një doracak për promovim të aktiviteteve të Organizatave vullnetare për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive dhe e shpërndau tek gjithsej 191 BOKOMI në qytet.



“BOKOMI kujtesore”
Udhëzuesi i qytetit Kobe për aktivitetet e Organizatave vullnetare për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive

<Përmbajtja e doracakut (Shembull)>

- Hyrje në meny të stërvitjeve të llojllojshme (ky udhëzues përmban disa meny të caktuara stërvitjesh.)
- Formulari për subvencione, formate/udhëzime për punë byrokratike
- Si të përdoren dhe mirëmbahen materialet dhe makineria për reduktim të rrezikut gjatë fatkq.
- Fletëpalosje mostra rreth aktiviteteve

(Referenca 1) Formulari për aktivitetet e Komuniteteve për mirëqenie të sigurtë gjatë fatkq. Kur kryhet një stërvitje, BOKOMI që e organizon stërvitjen dorëzon paraprakisht një njoftim për aktivitetin deri te stacioni më i afërt i zjarrfikësve. Ky proces mundëson që zyrtari në krye të detyrës të kuptojë aktivitetet vullnetare për red. të rrez. gjatë fatkq në komunitet dhe të përshtat orarin e tij/saj për të vizituar lokalitetin e stërvitjes.

Njoftimi për aktivitetin i Komunitetit për mirëqenie të sigurtë gjatë fatkeqësive

Shefit ose Stacionit të Zjarrfikësve

Emri i organizatës:

Emri i dorëzuesit të njoftimit:

Numri i telefonit (Shtëpi):

Numri i telefonit (Celular):

Prolonguar deri më 20 korrik në rast të rreshjeve të shiut

Data dhe koha e aktivitetit të mbajtur	19 (E shtunë) korrik 2014 11:00–13:00			
Nr. i pjesëmarrësve	140 (përfshirë 90 studentë dhe nxënës)			
Lokacioni i aktivitetit	Shkolla fillore Tsurukabuto (2-10-1 Tsurukabuto, Nada Ward)			
Shtirirja e aktivitetit	<input checked="" type="checkbox"/> Tërë komuniteti <input type="checkbox"/> Blloku (shtirirja më e vogël)			
Hollësi për aktivitetin	<input checked="" type="checkbox"/> Stërvitje për fatkeqësi <input type="checkbox"/> takim/takim i përgjithshëm <input type="checkbox"/> Leksion rreth red. të rrez. gj.fatkeq <input type="checkbox"/> Të tjera ()			
Iniciativa për edukim preventive të fatkeqësive	<input type="checkbox"/> Implementimi i edukimit preventive të fatkeqësive <input type="checkbox"/> Edukim preventive nga cunamit dedikuar qytetarëve			
Iniciativa për mbështetjen e njerëzve që kanë nevojë për ndihmë gjatë emergjencave	<input type="checkbox"/> Trajnim për mbështetje gjatë evakuimit për njerëzit që kanë nevojë për ndihmë			
	<input type="checkbox"/> Lidhur me foshnjat <input type="checkbox"/> Trajnim i përbashkët me organizatat e mirëqenies sociale <input type="checkbox"/> Mbështetje për shtetasit jo-japonez			
Detalet nga implementimi (vendosni shenjë tek kutia)	Stërvitje gjithëpërfshirëse	<input checked="" type="checkbox"/> Stërvitje gjithëpërfshirëse (detajet në shtojcë)		
	Trajnim për zjarrfikje	<input checked="" type="checkbox"/> Pompë portative <input checked="" type="checkbox"/> Bombolë gazi zjarrfikës <input checked="" type="checkbox"/> Kovë për zjarrfikje		
		<input checked="" type="checkbox"/> Të tjera (Përmbajtja: stendë për furnizim të përkohshëm me ujë)		
	Ndihmë të parë	<input type="checkbox"/> Seminar për t'u kualifikuar për teknik mjekësor civil (EMT) (Reanimim kardiopulmonar/AED/trajtim të plagëve/të tjera)		
		<input type="checkbox"/> Lidhur me reanimimin kardiopulmonar (frymëmarrje artificiale-CPR)		
		<input type="checkbox"/> Lidhur me ndihmën e parë <input type="checkbox"/> Të tjera ()		
	Pajisjet	<input type="checkbox"/> Manovrim	<input type="checkbox"/> Shpjegim	<input type="checkbox"/> Punë me litar
	Seminar për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive	<input type="checkbox"/> Seminar <input type="checkbox"/> Video <input type="checkbox"/> Të tjera		
		<input type="checkbox"/> Pranimit i turave studentore nga prefekturat tjera (përf. pjesëmarrës për trajnim JICA)		
	Komunikimi i informacioneve	<input type="checkbox"/> Grumbullim informatash <input type="checkbox"/> Përhapje informatash <input type="checkbox"/> Lojë për përfytyrim të fatkeqësive (DIG)		
Lidhur me evakuimin	<input type="checkbox"/> Udhëzime për evakuim <input type="checkbox"/> Të tjera (Hollësi:)			
Të tjera	<input type="checkbox"/> Aktivitete tjera (Hollësi:)			
Kërkesë për huamarrje/implementim (vendosni shenjë tek kutia.)	<input checked="" type="checkbox"/> Bombola uji për zjarrfikje (20 njësi) <input type="checkbox"/> Zorrë për ujë (copë.) <input type="checkbox"/> Kova kanavacë (copë)			
	<input checked="" type="checkbox"/> Gryka (të llojit për spërkatje 1 copë.)			
	<input checked="" type="checkbox"/> Bombola uji për zjarrfikje ((2 njësi) <input type="checkbox"/> Strehë nga tymi <input type="checkbox"/> Eksperiment zjarri me tempura <input type="checkbox"/> AED për trajnim			
	<input type="checkbox"/> Manekin për transportim me barelë (manekina) <input type="checkbox"/> Tank uji për brigadën me kova <input type="checkbox"/> Broshurë () <input checked="" type="checkbox"/> Të tjera Caqe për lëshim të ujit me përdorim të pompave të vogla elektrike (2 caqe) Tank ujë të thjeshtë që qëndron vetvetiu (2-ton) 1 njësi			
Data e huazimit të pajisjes: 18 (e premte) korrik Data e kthimit: 19 (e shtunë) korrik	Emri i personit që e pranoi pajisjen:			
Emri i punonjësit tek stacioni i zjarrfikësve që e pranoi njoftimin:	Seksioni ose ekipi në krye të lokalitetit: Seksioni Ekipi			
Emri i korpusit të zjarrfikjes që e pranoi njoftimin:	Togu ose numri i personave në krye të lokalitetit:			

Shënim	1	Mbikëqyrja nga ana e personelit zjarrikës mund të anulohet për shkak të fatkeqësisë ose rrethanave të tjera.
	2	Dërgimi i kamionëve të zjarrfikjes do të lejohet vetëm nëse nuk I pengon detyrat e reagimit ndaj fatkeqësive.
	3	Trajnimi realizohet duke pasur parasysh menaxhimin e sigurisë.
	4	Plotësojeni seksionin “Iniciativa për edukim preventiv gjatë fatkeqësive” nëse do të marrin pjesë nxënës nën moshën 18 vjeçare në aktivitetin për edukim preventiv gjatë fatkeqësive: Vendosni shenjë tek kutia “udhëzime nga lideri” për ndonjë aktivitet të drejtuar nga lideri civil për preventivë të fatkeqësive, si dhe “Edukimin preventiv për cunami për qytetarët” për aktivitetin lidhur me ngritjen e vetëdijes rreth evakuimit nga cunami për qytetarë dhe fëmijë. (Mundet më shumë përgjigje.)
	5	Vendosni shenjë mbi “Iniciativa për mbështetjen e njerëzve që kanë nevojë për ndihmë në raste emergjente” nëse trajnimi ose iniciativa synon njerëzit që kanë nevojë për ndihmë gjatë ndonjë fatkeqësie, përfshirë të moshuarit, personat me aftësi të kufizuar, të huajtë dhe foshnjat.

(Referenca 2) Lista e materialeve dhe makinerisë të siguruara për BOKOMI-n e sapoformuar

Pompë e vogël elektrike për zjarrfikje	Doreza
Zorrë për zjarrfikje dhe elemente ndihmëse (grykë, morsetë, etj.)	Doreza lëkure
Bombolë zjarri për stërvipte	Shirit në krah
Bombolë për fikjen e zjarrit (pluhur/lëng)	Xhaketë me zinxhirë
Kovë kanavacë	Elektrik dore
Kuti mobile për zjarrfikje	Megafon tranzistor
Tank të thjeshtë uji të vetëqëndrueshëm	Megafon për stërvipte PR
Tavë vaji për stërvipte me zjarr	Depo (në pesë madhësi)
Lopatë	Fletë për rikuperim
Panxhë hekuri	Gjenerator për dorë
Kamaqe që paloset	Transiver
Kamaqe	Faksimil për dorë
Sëpatë	Shkallë dopio
Çekiç	Karrocë dore
Kriko të rëndomtë	Uniçikletë
Kazmë	Veturë që i paloset pjesa e prapme
Hapëse për shishe	Shkallë me dy këmbë (gjithashtu përdoret edhe si shkallë)
Barelë që paloset	Rrotkë për kabllo
Pajisje hidraulike për thyerje të betonit	Prozhektor (dritë)
Vegël dore për copëtim të betonit	Kutia e ndihmës së pare (për 20 persona)
Grep tavani	Rezervuar plastike (për ujë të pijshëm)
Litar për shpëtim	Rrum druri (prej lisi)
Rrip sigurie për operacione shpëtimit	
Fasha	
Çikrik	
Sharrë elektrike me zinxhir	
Helmetë	

**Programet e
komunitetit për stërvitje
emergjente**

Përpilimi i planit vjetor të ngjarjeve

Kur organizohen stërvitje emergjente është e rëndësishme të nxiten sa më shumë banorë lokal që është e mundur që të marrin pjesë në ngjarje. Krijimi i një plani do të lehtësonte punën për informimin e banorëve rreth datave të stërvitjeve, si dhe njëkohësisht mund të bëhen parapërgatitje në mënyrë të planifikuar.

1. Procesi i krijimit të planit vjetor të ngjarjeve

Realizimi i stërvitjeve emergjente duhet të diskutohet në takimet e liderëve lokal (nga asociacionet e banorëve, etj.) si dhe në takimet e realizuara mes banorëve. Zyrtarët qeveritarë përkatës duhet të ftohen në këto takime që të kërkohet ndihmë prej tyre. Informacionet e nevojshme për caktimin e datave të stërvitjes duhet të sigurohen para se të mbahen diskutimet. Prandaj, duhet të identifikohen datat, përfshirë dhe ngjarjet tjera që nuk kanë të bëjnë me aktivitetet për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive.

(1) Shënoni të gjitha ngjarjet që iu vijnë ndër mend së bashku me datat për ato ngjarje.

(i) Ngjarje lidhur me reduktimin e rrezikut gjatë fatkeqësive

Stërvitje emergjente (stërvitje kundër zjarrit, stërvitje për shpëtim, trajnim për ndihmë të parë, punëtori për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive, etj.), patrullime, etj.

(ii) Ngjarje të tjera

Takime dhe ngjarje që nuk kanë të bëjnë me reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive

(2) Rënditni ngjarjet e identifikuar në mënyrë kronologjike dhe krijoni një plan të përafërt vjetor ngjarjesh.

(3) Gjatë takimeve diskutoni për çdo ngjarje në hollësi dhe krijoni një draft plan vjetor të ngjarjeve, i cili përfshin datat përkatëse (si p.sh., datat e takimeve parapërgatitore për çdo ngjarje dhe datat alternative të caktuara për ngjarjet në rast të rreshjeve të shiut, etj.)

(4) Draft planin prezantoheni para banorëve lokal dhe merrni vendim për një plan zyrtar përfshirë mendimet e të gjithë banorëve.

2. Zbatimi i planit vjetor të ngjarjeve

(1) Stërvitjet emergjente

Stërvitjet emergjente kërkojnë pajisje, materiale dhe personel. Detyrat në vijim duhet të kryhen duke i përfillur datat në dispozicion dhe duke u bazuar në planin vjetor të ngjarjeve.

(i) Krijoni një listë të gjërave që duhet të përgatiten dhe kontrolloni çfarë duhet bërë.

(ii) Prioritizoni dhe bëni përgatitje për gjërat që janë thelbësore së pari për stërvitjet.

Bërja e përgatitjeve para kohe është çelësi i suksesit.

[Bashkëpunimi] Identifikoni para kohe se ku duhet të huazohen pajisjet dhe materialet dhe identifikoni se cilat organizata qeveritare mund t'ju ndihmojnë në kryerjen e aktiviteteve.

(Pajisje dhe materiale: _____)

(Përkrahja qeveritare: _____)

- * Për aktivitetet e lehta, më së miri është të synohet përfundimi i kontaktimeve dhe bërja e përgatitjeve së paku një muaj para ngjarjes.
 - * Për detajet, në shumicën e rasteve, nuk mund të vendoset deri para se të ndodh ngjarja. Pasiqë të identifikohen detajet, tentoni t'ua komunikoni gojarisht informacionet banorëve dhe kontaktoni organizatat qeveritare duke filluar me ato që mund të kontaktohen drejtëpërdrejtë.
- (2) Gjërat kryesore që duhet të planifikohen
- (i) Procedura e stërvitjes (data, koha dhe përmbajtja e stërvitjes)
 - (ii) Personeli (nga komuniteti, korpuset vullnetare kundër zjarrit, stacioni i zjarrfikësve, etj.)
 - (iii) Pajisjet dhe materialet e nevojshme për stërvitjen
 - (iv) Vendndodhja e stërvitjes
 - (v) Të tjera (plan alternativ në rast të rreshjeve të shiut, etj.)

(3) Të tjera

Nëse datat për ngjarjet e shumëfishta përputhen në një ditë, atëherë do të duhet të realizohet ngjarja me prioritet më të lartë.

[Metoda detajore për krijim të planit të ngjarjeve (Shembull)]

Hapi i 1-rë: Shënimi i të gjitha ngjarjeve të planifikuara sipas kategorisë

(i) Ngjarjet lidhur me stërvitjet emergjente			
• Stërvitje			
Stërvitja e 1-rë	Kah fundi i qershorit (fundjavë), stërvitje për zjarrfikje		
Stërvitja e 2-të	Kah mesi i tetorit (ditë punë), trajnim për ndihmë të parë		
Stërvitja e 3-të	Në janar (fundjavë), stërvitje emergjente me tërë komunitetin		
• Patrullë për parandalim të zjarrit			
Patrulla e 1-rë	Kah gushti		
* datat duhen dakorduar me stacionet për zjarrfikje, etj.			
(ii) Ngjarje të tjera			
Lloji	Emri	Data	Shënim
Takime	Takim me përfaqësues të komunitetit	2 Prill (ditë punë)	Salla e komunës
	Takim përgatitor me qeverinë	15 maj (ditë punë)	Salla e komunës
Ngjarje me komunitetin	Dita e sportit	5 nënt. 5 (ditë punë)	Stadiumi XX
	Koncert për Krishtlindje	22 dhjetor (ditë punë)	Salla XX
Ligjerata, etj.	Ligjerata për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive	15 janar (ditë punë)	Salla XX
		Kah mesi i marsit (ditë punë)	Salla e zjarrfikësve
Të tjera	Pastrim vullnetarë në komunitet	7 tetor (ditë punë)	Parku XX

HAPI I 2-të)

Hapi i 2-të: Rënditja e ngjarjeve në mënyrë kronologjike

Data	Emri	Shënime
2 prill (ditë pune)	Takim me përfaqësues të komunitetit	Salla e komunës
Kah fundi i qershorit (ditë pune)	<u>Stërviçja e 1-rë [stërviçje kundër zjarrit]</u>	*Kah fundi i korrikut nëse bie shi
Në gusht	<u>Patrullim për parandalim të zjarrit</u>	-
7 tetor (ditë pune)	Pastrim vullnetar në komunitet	Parku XX
Kah mesi i tetorit (ditë pune)	<u>Stërviçja e 2-të [trajnim për ndihmë të parë]</u>	*Shikoni një video për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive nëse bie shi
5 nëntor (ditë pune)	Dita e sportit	Stadiumi XX
22 dhjetor (ditë pune)	Aheng	Salla XX
11 janar (ditë pune)	<u>Stërviçja e 3-të [Stërviçje emergjente me tërë komunitetin]</u>	*Një javë më pas nëse bie shi

Shënoni ngjarjen shtesë këtu

- Linja të zbrazëta duhet lënë ndërmjet ngjarjeve kështu që kur planifikohen ngjarje të reja, ato mund të futen ndërmjet linjave përkatëse.
- Ngjarjet lidhur me stërviçjet emergjente duhet të jenë qartazi të shënuara duke i nënvizuar ose përdorur stilolapsa me ngjyra.

Shembull) 25-31 dhjetor Patrullim për parandalim të zjarrit me rastin e fundvitit

Si të realizoni një stërvitje emergjente

Është vështirë të marrësh veprime të përshtatshme kur papritur duhet të përballlemi me ndonjë fatkeqësi. Prandaj, është e rëndësishme që të përgatitemi për fatkeqësitë duke përsëritur rregullisht stërvitjet adekuate emergjente.

1. Çështjet në të cilat duhet përqendruar gjatë planifikimit të një stërvitjeje emergjente

Stërvitja emergjente duhet përqendruar në dy çështjet në vijim. (1) A është e dobishme kur ndodh fatkeqësia? (2) A mund të përfitojnë njohuri dhe shkathtësi pjesëmarrësit për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive? Gjithashtu është e rëndësishme të krijohet një Plan për stërvitje paraprakisht dhe të këshillohet me organizatat përkatëse qeveritare me qëllim të realizimit të stërvitjes efikase brenda kohës së kufizuar.



2. Çështje konsiderimi gjatë krijimit të planit për stërvitje

(1) Çfarë është skenari?

Vendosni nëse do të realizoni stërvitje me shtrirje specifike rajonale siç është stërvitja për cunami, përmbajtje ose rrëshqitje të dheut, ose stërvitje e dobishme për çdo rajon siç është stërvitja në rast zjarri.

(2) Çfarë stërvitje është?

Pasiqë të vendoset rreth skenarit të stërvitjes, përcaktoni përmbajtjen e stërvitjes si p.sh., “stërvitja për grumbullim të informacioneve dhe transmetim të informacioneve,” “stërvitje në rast zjarri,” “stërvitje evakuimi,” “stërvitje për shpëtim,” “stërvitje për sigurim të ushqimit dhe ujit,” “lojë për përfytyrim të fatkeqësisë (DIG),” “trajnim për ndihmë të parë,” etj.

(3) Vendimi për datën

Shmangeni mbajtjen e stërvitjes në mes të verës, mes të dimrit, etj. që të marrin pjesë sa më shumë njerëz në stërvitje. Një mënyrë për të siguruar sa më shumë pjesëmarrës është të realizoni stërvitjen duke përdorur rastin kur kryhen aktivitete për pastrim të komunitetit ose ndonjë ngjarje sportive.

Bëni që orët e stërvitjes të mos jenë shumë të gjata për pjesëmarrësit edhe pse koha e nevojshme varet nga numri i pjesëmarrësve dhe përmbajtja e stërvitjes.

Shembull plani (Rasti i Kobes)

Plan implementimi për stërvitje emergjente	
Emri i organizatës	Komuniteti për mirëqenie të sigurtë gjatë fatkeqësive XX
Personi në krye të stërvitjes	Taro SUZUKI (078 325 8510)
Kontakt personi	Hanako TOYOTA (078 325 8525)
Data	E diel, 17 janar, 2009 10 : 00-12 : 00
Lokacioni	Sheshi i lojërave tek shkolla fillore Honda 6-5-1 Kano-cho, Chuo-ku
Nr. i pjesëmarrësve	Rreth 300
Mbështetja nga stacioni i zjarrfikësve	Kërkesa: udhëzime nga personeli i stacionit të zjarrfikësve
Përmbajtja	<ul style="list-style-type: none"> • Manovrimi me bombola gazi zjarrfikës • Brigada me kova • Spërkatja me ujë nga një hidrant kundër zjarri • Manovrimi me pompë të vogël • Zjarri i shkaktuar nga tiganosja e thellë
Shënim	Kërkesa: sigurim të makinës për zjarrfikje

(4) Numri i pjesëmarrësve

Vendosni rreth numrit të pjesëmarrësve duke i konsideruar orët e stërvitjes, lokacionin, përmbajtjen e stërvitjes, etj.

(5) Plani alternativ në rast të rreshjeve të shiut

Vendosi para kohe për atë nëse stërvitja do të realizohet, anulohet ose shtyhet në rast të rreshjeve të shiut. Diskutoni para kohe për një plan alternative i cili mund të realizohet në rast të rreshjeve të shiut (ndonjë video prezantim për parandalim të zjarrit, ligjeratë për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive, etj.).

(6) Vendimi për lokacionin

Përcaktohuni për një lokacion që është i përshtatshëm për përmbajtjen e stërvitjes dhe numrin e pjesëmarrësve. Parku ose oborri i ndonjë shkolle është i përshtatshëm për stërvitje terreni. Sigurohuni parakohe se si ta përdorni hapësirën sepse ndoshta do të duhet të keni leje ose të shpallni njoftim tek ndonjë administrator. etj., për të përdorur atë hapësirë.

(7) Bashkërendimi me organizatat qeveritare

Kërkoni mbështetje nga organizatat përkatëse qeveritare si p.sh., stacionet e zjarrfikësve, para se të realizoni një stërvitje. Në veçanti, këshillohuni paraprakisht me organizatat qeveritare nëse keni nevojë për udhëzime nga personeli qeveritar rreth ndonjë stërvitjeje, dërgim të makinës zjarrikëse, etj., ose keni nevojë të huazoni materiale dhe pajisje. Përmbajtjen e konsultimit përfshijeni në planin e stërvitjes.

[Bashkëpunimi me grupe të llojllojshme]

Krahas organizatave qeveritare siç janë zyrat e qytetit dhe stacionet e zjarrfikësve, ekzistojnë edhe organizata tjera me të cilat mund të bashkëpunoni me aktivitetet e juaja, përfshirë organizatat jofitimprurëse, OJQ-të, Kryqi i Kuq (Gjysmë hëna e kuqe) dhe organizata tjera vullnetare lokale. Rekomandohet që të kërkoni bashkëpunimin dhe ndihmën e këtyre organizatave në zonën tuaj.

(8) Parandalimi i aksidenteve

Merrni të gjitha masat e duhura për sigurinë e pjesëmarrësve me qëllim të parandalimit të aksidenteve gjatë realizimit të stërvitjeve.

Në veçanti, kërkoni nga organizatat qeveritare si p.sh., stacionet e zjarrfikësve të udhëzojnë dhe kujdesen për operacionet e rrezikshme siç janë stërvitjet me përdorimin e karburantit. Nëse ndodh ndonjë aksident, së pari merruni me aksidentin (ndihma e parë, etj.) dhe merrni masa adekuate.

Këshilla për këtë program

- ☆ Mbani kontakt të afërt me organizatat qeveritare të cilat mund t'ju ofrojnë ndihmë dhe të realizojnë ndonjë stërvitje në komunitetin tuaj lokal.
- ☆ Kërkoni ndihmë nga qeveria qysh në fazën e krijimit të planit të stërvitjeve.
- ☆ Identifikoni çfarë programe stërvitjeje mund të realizohen.
- ☆ Trajtoni banorët të cilët mund të përfshihen në aktivitete në cilësi të liderëve kështu që banorët do të jenë në gjendje të mbrojnë qytetin për veten e tyre në të ardhmen.
- ☆ Të jeni të përgatitur për emergjenca duke shpërndarë materiale dhe pajisje për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive duke shfrytëzuar ndihmën qeveritare.

Pajisjet dhe materialet për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive









- Cfarë materialesh dhe pajisjesh nevojiten? -

Duke nxjerrë mësim nga Tërmeti i madh i ashtuq. Hanshin-Awaji. Qyteti Kobe iu shpërndau Komuniteteve pajisje dhe materiale për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive.

Kjo pjesë i shpjegon llojet kryesore të pajisjeve dhe materialeve për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive.

1. Llojet kryesore të pajisjeve dhe materialeve

Përdorimi	Emri	Përshkrimi	Fotografia
Shpëtim	Vegël portative për thyerje të betonit	Kjo vegël dërrmon betonin duke përdorur fuqinë e reaksionit duke e futur peshën në dorashkë. Tehe të ndryshme janë në dispozicion për përdorim të ndryshëm.	
Shpëtim	Grepi kundër zjarrit	Përdoret për të thyer tavane prej hekurit të galvanizuar, dyshemeteë, etj. Gjithashtu përdoret për të larguar mbetjet në formë të dërrasës.	
Shpëtim	Parzmore për operacione shpëtimi	Përdoret për të ofruar siguri gjatë operacioneve në lartësi. Operatori e vë rripin rreth belit të tij/saj dhe e ngjit litarin e sigurisë në një pjesë të forte të ndërtesës, etj.	
Shpëtim	Çikrik portativ	Përdoret në kombinim me një litar për të lëvizur gjësende që nuk mund të lëvizin nga njerëzit, si dhe për të shtrënguar litarët. Operatori duhet të jetë mirë i informuar se si ta përdor këtë me qëllim të përdorimit të tij të duhur.	
Shpëtim	Sharrë elektrike me zinxhir	Përdoret për prerjen e drunjve, etj. Është e rëndësishme që kjo pajisje të mirëmbahet rregullisht ndryshe nuk do të punojë në raste emergjente.	
Shpëtim	Lopatë	Është e rëndësishme për largim të dheut, etj. Është e rëndësishme për mbushjen e thasëve me rërë.	
Shpëtim	Qysqi	Përdoret për të hapur dyer dhe grila, si dhe për ngritur objekte duke përdorur parimin e levës.	

Shpëtim	Sharrë e palosshme	Sharra e palosshme është e dobishme për të mbajtur me vete. Gjithashtu është e dobishme kur operohet nëpër vende të ngushta për shkak të elasticitetit të saj.	
Shpëtim	Sharrë	Është e përshtatshme për prerjen e pjesëve të mëdha të drurit sepse ka thikë më të gjatë se sa sharra portative.	
Shpëtim	Sëpatë	Tehu i thikës përdoret për të thyer dërrasa, etj., ndërsa pjesa e mbrapme me majë përdoret për të thyer muret prej llaçi.	
Shpëtim	Çekiç	Është i përshtatshëm për thyerjen e mureve të tullave. Nevojitet kujdes gjatë përdorimit sepse është i rëndë.	
Shpëtim	Kriko portativ	Përdoret për të ngritur objekte të rënda dhe për të zgjerruar hapësira. Mund të përdoret vetëm aty ku dyshemeja është e fortë (e ngurtë).	
Shpëtim	Kazmë	Përdoret për të gërmuar sipërfaqet e ngurta dhe për të bërë vrima nëpër mure, etj.	
Shpëtim	Darë për hekur	Përdoret për prerjen e çelikut të përforcuar në beton të përforcuar dhe mure të tullave.	
Shpëtim	Shtypës hidraulik betoni	Mund të shtyp mure betoni, etj. Mund të shtyp mure me trashësi deri në 25 cm.	
Transportim	Barelë e palosshme	Përdoret për bartjen e të plagosurve, etj. Mund të paloset dhe lihet menjëherë kur nuk përdoret.	

Zjarrfikje	Pompë elektrike portative	Uji nga burime natyrore siç janë lumenjtë ose pellgjet, si dhe çisternat me ujë mund të spërkatet me këtë pompë. Kjo mund të përdoret në kombinim me tank uji portativ gjatë stërvitjeve.	
Zjarrfikje	Bombolë gazi zjarrfikës për zjarr të klasifikuar A, B dhe C	Është bombolë tipike për zjarrfikje që mund të përdoret për lëndët djegëse, Vajra dhe pajisje elektrike. Mund të ripërdoret me rimbushjen e bombolës me pluhur pas përdorimit.	
Zjarrfikje	Bombolë për zjarrfikje kundër kimikateve të lëngshme	Është bombolë zjarrfikës për përdorim shtëpiak. Nuk e bllokun shikimin sepse nuk është e mbushur me pluhur. Kimikatet e lëngshme mund të spërkatet disa here sepse mund të ndizet dhe fiket.	
Zjarrfikje	Kovë kanavace	Është kovë kanavace e përbalueshme ndaj ujit. Lehtësisht mund të magazinohet dhe përdoret për shkak të peshës së lehtë, etj.	
Zjarrfikje	Rezervuar uji portativ (vetëqëndrueshëm)	Porositet në madhësi të ndryshme. Rezervuari më i madh mund të merr 1.000 litra ujë. Përdoret si burim uji për brigadat me kova, etj.	
Stërvitje në rast zjarri	Tigan vaji për përdorim gjatë stërvitjeve në rast zjarri	Mund të përdoret duke e mbushur me ujë, karburant ose kerozinë dhe duke e ndezur zjarrin për qëllime stërvitjeje. Mos e mbushni me më shumë përmbajtje se sa është e lejuar sipas madhësisë së tiganit.	
Stërvitje në rast zjarri	Bombolë uji zjarrfikës për stërvitje në rast zjarri	Është bombolë zjarrfikës për stërvitje që spërkat ujë. Përdoret për të mësuar se sit ë manovrohet një bombolë e vërtetë gazi zjarrfikës. Mund të përdoret me futjen e ujit dhe ajrit të ngjeshur në të.	

Qyteti Kobe siguroi materiale dhe pajisje për çdo BOKOMI (Organizatë vullnetare për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive) pasiçë iu tregoi banorëve një listë të materialeve dhe pajisjeve të sipërpërmendura dhe i pyeti të zgjedhin për atë se çfarë kanë nevojë, gjatë themelimit të organizatës.

Banorët duhet të kenë mundësi të diskutojnë mes veti se çfarë pajisjesh dhe materialesh iu nevojiten për komunitetin e tyre.

* Në qytetin Kobe, pajisjet dhe materialet magazinohen nëpër depo të parqeve lokale, etj.

2. Mirëmbajtja

Pajisjet dhe materialet duhet të mirëmbahen rregullisht. Mirëmbani siç duhet që të mund të përdoren në raste emergjente.

Gjithashtu është ide e mirë të ushtroni të manovroni me pajisjet dhe materialet gjatë mirëmbajtjes së tyre.

3. Metodat e mirëmbajtjes

(1) Pajisjet dhe materialet për operacione shpëtimi

- (i) Sëpatat, tokmaqet, sharrat, lopatat, qysqitë, çekiçët, darat për hekur, etj.
Largoni lagështinë pas përdorimit që të menjaroni ndryshkjen e pjesëve metalike dhe kalbjen e dorezave. Mprehni tehat.
Aplikoni lubrifikant tek pjesët e lëvizshme.

(2) Pajisjet dhe materialet për zjarrfikje

- (i) Pompat elektrike, etj.
Hapeni valvulën e kullimit të pompës elektrike që të derdhet plotësisht uji para magazinimit. Kujdesuni që të shpërlani brendësinë e pompës me ujë të freskët nëse është përdorur ujë deti.
Kontrolloni karburantin, vajin dhe vakumin e pompës, rimbusheni me karburant dhe vaj deri në nivelin e duhur, e pastaj tërhiqeni starterin (motorinon) disa herë.
Gjatë magazinimit të pompave menjaroni vendet me lagështi. Gjatë stinës së ftohtë, merrni masa për të parandaluar ngrirjen pas përdorimit.

Shënim: Bëni test të ndezjes së bashku me praktikimin e tyre së paku një herë në muaj.

- (ii) Zorrat, tubat e thitjes, kovat kanavace, etj.
Kulloni ujin nga zorret dhe tubat e thitjes para se t'i magazinoni.
Pas përdorimit, thani mirë para magazinimit.

Këshilla për këtë program

- ☆ Disa pompa elektrike portative, gjeneratorë energjie, etj. përdorin “lëndë djegëse të përzier (përzierje të karburantit dhe vajit).” Çdo model përdor një përzierje specifike (si p.sh., “25:1”), dhe prandaj kontrolloni mirë udhëzimet. Sigurohuni të përdorni sasinë e saktë kur e përziëni vetë lëndën djegëse.
- ☆ Gjithmonë kontrolloni pajisjet dhe materialet para dhe pas përdorimit. Në veçanti, pompat elektrike portative dhe gjeneratorët e energjisë mund të ruhen në gjendje të mirë duke i vënë në punë. Bëni test të ndezjes rregullisht.
- ☆ Hiqni bateritë nga pajisjet dhe magazinoni pas përdorimit, nëse keni pajisje që punojnë në bateri.
- ☆ Këto pajisje dhe materiale për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive janë të dobishme vetëm nëse mund të përdoren në raste emergjente. Prandaj, është e rëndësishme të kontrollohen rregullisht që të shihet nëse janë në gjendje funksionale. Njëkohësisht derisa i kontrolloni mund të ushtroni t'i manovroni.

Trajnimi me përdorimin e “Bombolave zjarrfikës me ujë për stërvitjen kundër zjarrit”

Kjo pjesë e shpjegon trajnimin për përdorimin e bombolave zjarrfikës me ujë gjatë stërvitjeve kundër zjarrit. Ky trajnim mund të kryhet me nxënës nëse përshtatet në mënyrë të drejtë.

1. Qëllimi

Pjesëmarrësit mësojnë të përdorin bombolat me ujë kundër zjarrit, të cilat mund të përdoren rrishtazi, duke i përdorur ato njësoj sikur bombolat e vërteta të gazit zjarrfikës.

2. Pajisjet dhe materialet e nevojshme

(Artikulli)	(Sasia)
Bombolë ujë zjarrfikës për stërvitje	10 (varet nga numri i pjesëmarrësve)
Kompresor ajri	1
Rrotkë kabloje (kabëll i gjatë)	1
Rezervuar uji (ose ujë rubineti)	1
Bombolë gazi zjarrfikës standard	1 (nëse ka)
Caqe për të ushtruar me bombolat e ujit	1 komplet

Këshilla për këtë program

☆ Objekte të ndryshme mund të përdoren si caqe. Pjesëmarrësit mund të ushtrojnë si t’i përdorin bombolat dhe njëkohësisht të argëtohen nëse caqet janë të projektuara që të gjitha të goditen në një periudhë spërkatjeje.

3. Trajnim duke përdorur lojëra për nxënësit

Caqet mund të projektohen në mënyrë që nxënësit të përjetojnë një simulim zjarrfikjeje e njëkohësisht të kënaqen me lojën.

- (1) **Shishe PET me një sasi të vogël uji në to**
Numri i shisheve që mund të goditen me një periudhë spërkatjeje është 8 ose 9.
Pjesëmarrësit luajnë një lojë ku ata do të duhet t’i godasin të gjitha shishet e renditura, etj.
- (2) **Rrëzimi i topave duke i goditur me ujë**
Pjesëmarrësit luajnë një lojë ku ata do të duhet të spërkasin një top të madhësisë së basketit dhe ta rrëzojnë atë.
- (3) **Të tjera**
Përdorimi i caqeve që rrotullohen ose bien kur goditen me ujë mund të bëjnë stërvitjen argëtuese edhe për të rriturit edhe për fëmijët.



4. Procedurat

(1) Sqarimet preliminare

Shpjegoni mekanizmin e bombolave gaz zjarfikës, si të përdoren, karakteristikat e tyre, etj., duke përdorur një bombolë gazi zjarfikës standard (nëse është në dispozicion) të siguruar nga stacionet e zjarfikësve ose organizatat tjera. Gjithashtu, shpjegoni dallimin ndërmjet bombolës që përdoret për stërvitje dhe bombolave të vërteta zjarfikëse.

(2) Përgatitja

★ Përgatitja e bombolave të ujit për zjarfikje

Përgatitni numrin e nevojshëm të bombolave të ujit për zjarfikje. Nëse mund të siguroni një bombolë për secilin pjesëmarrës, mund t'i mbushni me ujë paraprakisht, kështu që nuk do të duhet të sillni kompresor ajri tek lokacioni ditën e trajnimit.

★ Përgatitja e caqeve

[Shishe PET]

- Përgatitni paraprakisht shishe boshe PET (mundësisht shishe prej 1.5 l).
- Mbusheni një çerek të secilës shishe dhe vendosni kapakun.
- Vendosni numrin e nevojshëm të shisheve në një sipërfaqe të arsyeshme të lartë.

[Caqe tjera]

- Vetë ju mund të bëni caqe tjera interesante. Gjithashtu mund të kontaktoni stacionin e zjarfikësve ose ndonjë organizatë tjetër qeveritare sepse ato mund të kenë caqe të gatshme që mund të përdoren gjatë stërvitjes.

(3) Realizimi i stërvitjes

Pjesëmarrësit do të ushtrorjnë zjarfikjen me rradhë. Kërkoni komente për stërvitjen prej personelit të stacionit të zjarfikësve në fund të stërvitjes.

Këshilla për këtë program

- ☆ Në rast të ndonjë zjarri të vërtetë, nëse zjarri përhapet në tavan, ndërprisni fikjen e zjarrit me bombola (zjarfikja fillestare) dhe në vend të kësaj përdorni hidrantët brenda godinës, etj., ose evakuoni menjëherë banorët dhe thirrni stacionin e zjarfikësve.

Çështje që duhet të përfshihen në bisedimet me pjesëmarrësit

- ☆ Kërkoni nga pjesëmarrësit të kontrollojnë se ku janë të vendosur bombolat gaz zjarfikës në shtëpinë dhe komunitetin e tyre.
- ☆ Kërkoni të kontrollojnë llojet e bombolave zjarfikës të vendosur në shtëpitë e tyre (pluhur, kimikate të lëngshme, etj.).

Stërvitjet me përdorim të “Bombolave të pluhurit”

Duke përjetuar simulime reale të zjarrfikjes me përdorim të zjarrit të vërtetë dhe bombolave të vërteta (bombola të pluhurit), pjesëmarrësit mund të mësojnë si t'i përdorin pajisjet për çdo emergjencë.

1. Qëllimi

Pjesëmarrësit mësojnë si të luftojnë zjarrin gjatë emergjencave duke praktikuar zjarrfikjen me përdorim të zjarrit të vërtetë dhe bombolave të pluhurit.

2. Numri i nevojshëm i personelit

 (Në rast të pranisë së 30 pjesëmarrësve)

4-5 persona

Shënim: Kërkoni udhëzime prej personelit zjarrfikës sepse është operacion i rrezikshëm. Këshillohuni paraprakisht me stacionet e zjarrfikjes, etj., nëse dëshironi të keni praninë e tyre.

3. Pajisjet dhe materialet e nevojshme

 (Në rast të pranisë së 30 pjesëmarrësve)

Shënim: Stacionet e zjarrfikësve dhe organizatat tjera qeveritare mund të kenë në dispozicion një pjesë të pajisjeve. Huazoni prej tyre çfarëdo që të kenë në dispozicion për realizimin e stërvitjes.

(Artikulli)

Bombolë pluhuri kundër zjarrit

(Sasia)

5-6

Tigan për vaj

1

Kerozinë

2 L

Benzinë

1 L

Çakmak

1

Llambë me bateri

1

Bombolë gazi zjarrfikës standard (nëse kanë)

1

4. Plani

Vini një tigan vaji në qendër të parkut. Spërkatni me bombolë pluhuri nga një pozitë 5-6 metra në drejtim të kundërt të erës. Lëvizni dorashkën për spërkatje sikur fshini me fshesë për të fikur zjarrin. Gradualisht afrohuni caktat ashtu sikur zjarri pakësohet, pastaj fikeni zjarrin plotësisht.

5. Procedurat

(1) Sqarimet preliminare

Pjesëmarrësit mësojnë për mekanizmin dhe përdorimin e bombolave kundër zjarrit duke e parë një model standard të bombolës për zjarrfikje (foto) ose duke e përjetuar përdorimin e bombolave zjarrfikës me aplikim të bombolave të ujit për qëllime stërvitjeje, para se të filloni të përdorni bombolat e pluhurit.



Kujdes!

Kontrolloni pamjen e jashtme të bombolës së pluhurit për zjarrfikje. Ato me ndryshk në trupin e tyre mund të shpërthejnë për shkak të presionit të brendshëm kur të shtypni levën dhe të shkaktojnë aksident serioz. Mos i përdorni nëse gjeni ndryshk në trupin e tyre.




(2) Përgatitja

- Përgatitni disa bombola zjarrfikës sipas projektimit të stërvitjes.
- Tregoni paraprakisht të gjithëve rreth lokalitet se stërvitja do të fillojë dhe se pluhuri mund të shpërndahet përreth lokalitetit gjatë realizimit të stërvitjes.

Vini ujë në tigan vaji në lartësi 2-3 cm nga shtrati (për të parandaluar djegien)

- Vini kerozinë në tigan. Sasia e duhur është rreth 100 cc, edhe pse varet nga madhësia e tiganit.
- Shtoni një sasi të vogël benzinë që të ndizet zjarri (shtoni benzinë menjëherë para se të ndizni zjarrin.)



(3) Realizimi i stërvitjes

- Pjesëmarrësit ushtrojnë zjarrfikjen me rradhë.
- Pas spërkatjes me pluhur disa herë, ndezja e sërishme bëhet e vështirë sepse agjensët e fikjes fillojnë të akumulohen në tigan. Largoni agjensët prej tiganit me rrjetë, etj., dhe shtoni sërish një sasi të benzinës, që të mund të ndizet zjarri lehtësisht.

(4) Të tjera

Hidhni siç duhet mbetjet e vajit të përdorur gjatë stërvitjes.



Afroheni bombolën zjarrfikës pranë zjarrit dhe pastaj tërhiqni mbërtheckën e sigurisë me gisht vertikalisht.

Lirojeni zorrën dhe synoni me grykën tek burimi i zjarrit.

Mbajeni fortë levën për të spërkatur (për të fikur zjarrin lëvizni grykën e zorrës ashtu sikur fshini me fshesë).

Këshilla për këtë program

- ☆ Në përgjithësi, shkalla e zjarrit që mund të luftohet gjatë zjarrfikjes fillestare është derisa zjarri të përhapet në tavan. Nëse ndodh kjo, mos tentoni zjarrfikje fillestare të rrezikshme, evakuoni banorët menjëherë dhe pastaj thirrni organizatën e zjarrfikësve për ndihmë.

Çështje që duhet të përfshihen në bisedime me pjesëmarrësit

- ☆ Bombolat zjarrfikës me kimikate të lëngshme janë efektive kur tiganët e vajit i kaplon zjarri.
- ☆ Rekomandohet që bombolat zjarrfikës të vendosen në hyrje të shtëpive (për të parandaluar ndryshkun).
- ☆ Kërkoni prej pjesëmarrësve të kontrollojnë nëse janë vendosur bombola zjarrfikës në komunitetin e tyre.

Trajnimi për brigadën me kova

Ky trajnim është projektuar për të mësuar metodat e zjarrfikjes, të cilat mund të realizohen nga banorët vendas para se të arrijë makina e zjarrfikjes në vendngjarje. Kjo pjesë i sqaron metodat e brigadës së kovave dhe rënditjen në rradhë të njerëzve, të cilët e zbatuan këtë metodë në shumë zjarrfikje fillestare në shumë lokalitete gjatë tërmetit të madh të ashtuq. Hanshin-Awaji.

1. Qëllimi

Pjesëmarrësit mësojnë për brigadat me kova si një metodë e zjarrfikjes fillestare në ato raste ku nuk janë në dispozicion pompa uji portative, etj. Pjesëmarrësit gjithashtu mund të kuptojnë rëndësinë e bashkëpunimit gjatë katastrofave nëpërmjet këtij programi, si dhe të mësojnë rreth metodave të zjarrfikjes.

2. Pajisjet dhe materialet e nevojshme

(Artikulli)

Burim uji (pishinë, rezervuar uji që paloset, etj.)
Cak për brigadat e kovave

Karroçë për të vendosur cakun

Konteiner për mbajtjen e ujit (kovë, etj.)

(Sasia)

1


1 komplet

(2 komplete kur mbahen gara)

1 komplet

(2 komplete kur mbahen gara)

Shumë (10 se më tepër)



[Shembull themelor]

3. Metodatat e llojlojshme të trajnimit

(1) Garrat

Dy ekiye të ndara në dy brigada me kova njëkohësisht realizojnë gara. Vendosni dy kova të mëdha plastike mbi karrocat, siç është treguar diagramin më lartë. Ekipi i parë që do e mbush kovën më të madhe është fituesi.

Kujdes nga aksidentet dhe lëndimet sepse metoda e garimit ka anën negative, për shembull, pjesëmarrësit bëhen të pakujdesshëm për atë se çfarë po bëjnë dhe e harrojnë sigurinë e të tjerëve, edhe pse mund ta bëjë trajnimin shumë argëtues.

(2) Llojet tjera

Çdo gjë që mund të mbajë ujë mund të përdoret si konteiner, krahas kovave, siç janë legenët, shportat e mbeturinave dhe qeset.

Në fakt, të gjitha gjësendet që mund të mbanin ujë u përdoren gjatë zjarrfikjes në termëtin e madh të ashtuq. Hanshin-Awaji. Rekomandohet të përdoren një llojlojshmëri e gjësendeve në mënyrë që pjesëmarrësit të kuptojnë se mund të përdoren shumë produkte amvisërie për të realizuar brigadat me kova.

Gjatë trajnimit të brigadave me kova, të gjithë pjesëmarrësit bashkëpunojnë për të bartur ujin deri tek caku. Prandaj, programi i trajnimit i ndihmon pjesëmarrësit të mësojnë rëndësinë e ndihmës dhe bashkëpunimit të ndërsjellë.

Për këtë arsye, është ide e mirë të lejohen edhe fëmijët të marrin pjesë në trajnim.



4. Rreshtime të ndryshme të brigadave

Ekzistojnë lloje të ndryshme të rreshtimeve, secila prej tyre ka përparësitë dhe mangësitë. Përzgjidhni një rënditje të pështatshme sipas numrit të pjesëmarrësve dhe llojit të pjesëmarrësve (pjesëmarrës me përvojë dhe pa përvojë).


(1) Rreshtimi në një rradhë

Kjo është e pështatshme kur ka një numër të vogël pjesëmarrësish.

Pjesëmarrësit qëndrojnë të rreshtuar në distance 1.5 metra dhe i kalojnë kovat nga njëri tek tjetri, nga burimi i ujit deri tek burimi i zjarrit.

Rreth një e pesta e njëzve të rreshtuar kanë për detyrë t'i kthejnë kovat e zbrazëta tek burimi i ujit. Mangësia e kësaj metode është se njerëzit nuk mund të shohin se çfarë po ndodh prapa tyre.

Nëse është e nevojshme, caktoni njerëz që do të kujdesen për sigurinë e pjesëmarrësve (për shembull kur formohet një rresht i këtillë matanë rrugës).




(2) Vendosja në rresht kur njerëzit janë të përballur me njëri tjetrin

Kjo është një metodë e modifikuar e të rreshtuarit në një rradhë.

Njerëzit qëndrojnë në një rradhë. Çdo numër tek kthehet 180 shkallë kështu që kthehen kah drejtimi i njerëzve me numër çift. Njerëzit me numër tek bëjnë dy hapa prapa. Kjo mundëson që të mbulohen boshllëqet ndërmjet njerëzve. Pastaj ata mund të shohin nëse ekziston ndonjë rrezik prapa njerëzve të cilët i kanë përpara.


Mangësia e këtij sistemi është se nevojitet më shumë kohë për të renditur njerëzit në pozicionet e tyre.



(3) Rreshtimi në dy rradhë

Kjo është metodë e përshtatshme kur ka më shumë pjesëmarrës.

Njerëzit e njëres rradhë i kalojnë kovat me ujë, ndërsa njerëzit e rradhës tjetër i kalojnë kovat e zbrazëta tek burimi i ujit. Dy rradhët qëndrojnë të rreshtuar duke ia kthyer shpinën njëri tjetrit, kështu që e realizojnë një brigadë kovash duke u kujdesur për shpinën e njëri tjetrit (nëse përballen me njëri tjetrin, do të jetë vështirë të kujdesen për sigurinë e tyre sepse e bllokojnë pamjen e njëri tjetrit). Distanca ndërmjet njëri tjetrit është rreth 1 metre. Nëse nuk ka njerëz të mjaftueshëm, caktoni anëtarë në distancë 1 metre në rradhën e dërgimit të ujit dhe anëtarët e tjerë në rradhën e kthimit të kovave të zbrazëta.



(Shënim) Distanca shërben si udhëzues i përafërt.

Këshilla për këtë program

- ☆ Brigadat e kovave kanë sukses vetëm nëse njerëzit bashkëpunojnë me njëri tjetrin. Është ide e mirë që t'i lejoni pjesëmarrësit të provojnë ushtrimin pa mos iu dhënë fillimisht udhëzime, që të mund të përjetojnë rëndësinë e përgatitjes dhe bashkëpunimit nëpërmjet përvojës së tyre. Të jesh pjesë e brigadës së kovave është punë e vështirë, prandaj kini kujdes nga lëndimet dhe mos lejoni që fëmijët dhe të moshuarit të mundohen për së tepërmi.



Stërvitje shpëtimi

Nuk ka nevojë të thuhet se operacionet e shpëtimit kanë prioritet kur ndodh ndonjë fatkeqësi.

Some rescue methods are explained in this section.

1. Qëllimi

Në vendndodhjen e një fatkeqësie të madhe siç është tërmeti, nevojiten operacione të shpejta shpëtimi. Prandaj, pjesëmarrësit do të mësojnë sesi t'i përdorin pajisjet dhe si të realizojnë operacione shpëtimi me qëllim të jenë të përgatitur për emergjenca.

2. Numri i nevojshëm i personelit

(Në rast se ka rreth 30 pjesëmarrës)

4-5 personel

3. Pajisjet dhe materialet e nevojshme

(Në rast se ka rreth 30 pjesëmarrës)

(Artikulli)

(Sasia)

Sharrë

5

Qysqi

5

Kriko

5

Darë për prerje të hekurit


5

Çekiç

5

Dru në formë katrori (së paku 10 cm i trashë)

5




4. Plani

Me skenarin duke pasur një person të ngecur ose që gjendet nën rrënojat e ndonjë shtëpie, etj., stërvitja e shpëtimit realizohet duke përdorur pajisje siç është sharra ose qysqia.

5. Procedurat

(1) Shpjegimet preliminare

Sqaroni emrat e çdo pajisjeje dhe materiali, si dhe përdorimin dhe manovrimin e tyre.



(2) Përgatitja

- Përgatitni sasinë e nevojshme të pajisjeve dhe materialeve që duhet të përdoren gjatë stërvitjes.
- Vendosni një manikin (kukull), etj., i cili duhet të shpëtohet nën copat e drunjve.


(3) Realizimi i stërvitjes

Është e vështirë të realizohet një stërvitje e plotë shpëtimi. Prandaj, ushtrimi duhet të kufizohet vetëm në ngritjen dhe prerjen e drunjve në formë katrori, etj., duke përdorur pajisjet dhe materialet, por pasiqë të jepen sqarime për operacionin e shpëtimit.

(i) Sqarime sesi të krijohet një hyrje në çati.

(Si të bëhet një hyrje në çati)

- Në rast se shtëpia është e ndërtuar me kornizë druri, hyrja bëhet duke i larguar tjegullat dhe duke i prerë ose thyer trerët.




- Në rast se çatia është e ndërtuar me çelik të galvanizuar, shufrat e hekurit tërhiqen duke e futur qysqinë në nyjet e shufrave të hekurit të galvanizuar. Pastaj, dërrasat e çatisë priten ose thehen përgjatë traut.
- Në rast se çatia është e mbuluar me pllaka betoni, largohen pllakat duke i thyer me çekiç, etj., e pastaj dërrasat e çatisë priten ose thehen përgjatë traut.

[Çështje që duhen konsideruar për operacionin]

- ☆ Kur veproni mbi çati, caktoni personel sigurie në anën tjetër të çatisë, si dhe kujdesuni për sigurinë tuaj me përdorim të litarëve, etj. Kontrolloni qëndrueshmërinë e çatisë kur ecni mbi të që të mos shembet nën këmbët tuaja. Kontrolloni hapat tuaja që të siguroheni mos rrëzoheni.
- ☆ Bërtisni me zë dhe kontrolloni që mos ketë asnjë njeri poshtë kur të hidhni mbetjet e çatisë në tokë.
- ☆ Gjatë stërvitjes, kujdes nga lëndimet trupore siç janë prerjet e duarve dhe këmbëve.

(ii) Sqarime sesi të shpëtohet një njeri.



(Metoda e shpëtimit)

- Folni me personin e bllokuar në shtëpi që ta qetësoni dhe të merrni informacione për gjendjen brenda shtëpisë.
- Përdorni një kriko ose levë për të ngritur mbetjet të cilat e kanë mbuluar personin.
- Mbështetni mbetjet e ngritura duke futur një copëz druri në formë katrori, etj., në boshllëkun e krijuar.
- Largoni ose copëtoni mbetjet, duke filluar me pjesën më të lehtë.

[Çështje që duhe konsideruar për operacionin]

- ☆ Kur i largoni ose i copëtoni mbetjet, punoni me kujdes me qëllim të parandalimit të rrëzimit të mbetjeve të tjera më lartë.
- ☆ Kur përdorni dru në formë katrori, etj., si mbështetës ose levë, përcaktohuni për drurin më të trashë i cili nuk ka të çara, etj.

Çështje që duhet përfshirë në bisedime me pjesëmarrësit

- ☆ Lutni pjesëmarrësit të kontrollojnë nëse ka mallra në shtëpi të cilat mund të përdoren për operacione humanitare, etj..
- ☆ Veglat për zdrukhtari dhe krikot brenda automjeteve mund të jenë të dobishme.



Trajnimi për lidhjen e nyjës së litarit

Litarët janë shumë vegla të dobishme gjatë emergjencave. Litarët mund të përdoren për qëllime të ndryshme dhe kur përdoren metoda të ndryshme të lidhjes së nyjeve. Kjo pjesë i shpjegon metodat e ndryshme të lidhjes së nyjeve të litarëve.

1. Qëllimi

Pjesëmarrësit mësojnë metoda të lidhjes së nyjeve të litarit për të shpëtuar njerëz nga shtëpi të rrënuara, etj., gjatë fatkeqësive. Të mësuarit e teknikave të shfrytëzimit të litarëve mund të jetë e dobishme në jetën e përditshme, por dhe gjatë emergjencave.

2. Numri i nevojshëm i

(Në rast se ka rreth 30 pjesëmarrës)

4-5 personel

3. Pajisjet dhe materialet e nevojshme

Litarë (një për çdo pjesëmarrës)

4. Përmbajtja e trajnimit

Ekzistojnë metoda të llojllojshme të lidhjes së nyjeve të litarëve të përshtatshme për qëllime të ndryshme, përfshirë lidhjen e litarëve të trashësisë së njëjtë, si dhe lidhjen e litarëve të trashësisë së ndryshme dhe litarëve të përbërë nga materiale të ndryshme. Gjithashtu ka edhe metoda të përshtatshme për lidhjen e nyjeve të litarëve tek ndonjë objekt ose trup njeriu që të mund të ngriten ose zbriten poshtë ose litarët mund të tërhiqen horizontalisht ose të varen nga lart poshtë.

(1) Procedurat

- (i) Përgatituni për sesionin e trajnimit duke iu shpërndarë litarë pjesëmarrësve. Nëse pjesëmarrësit janë të ndarë në grupe, çdo grup duhet të ketë 10 pjesëmarrës më së shumti dhe një instruktor të caktuar për çdo grup.
- (ii) Shpjegoni përdorimin e litarëve.
 - Litarët përdoren për të shpëtuar jetë. Mos i përdorni në mënyrë të shkujdesur.
 - Mos i mbështillni litarët rreth qafës ose lëkundni rreth e përçark (ky paralajmërim vlen enkas për fëmijët).
- (iii) Jepni udhëzime për çdo metodë të lidhjes së nyjeve të litarëve dhe lutni pjesëmarrësit të provojnë të lidhin një nyje.
- (iv) Mundësoni pjesëmarrësve të shohin shembuj të lidhjes së nyjeve aty ku është e mundur (si p.sh., zbritja e një qeseje/torbë).


Këshilla për këtë program

- ☆ Litarët e zakonshëm që përdoren nga zjarrfikësit profesionistë mund të ngrejne peshë maksimale deri në 3 tonë (rritja e numrit të nyjeve do të zvogëlojë fuqinë e litarit në masë të madhe).
- ☆ Madje dhe një dëmtim i vogël i litarit do të zvogëlojë fuqinë e tij në mënyrë të konsiderueshme sepse litari fillon të këputet nga pjesa e dëmtuar. Tregoni pjesëmarrësve t'i përdorin me kujdes litarët sepse ato përdoren për të shpëtuar jetë.




Metodat kryesore të lidhjes së nyjeve të litarëve

Nyja damar




- Kjo metodë përdoret për lidhjen e litarëve që kanë trashësi të njëjtë.
- Nyja lehtësisht mund të zgjidhet duke i tërhequr pjesët konkrete të nyjes. Prandaj, përdoret nga ekipet e ndihmës së pare për të lidhur fashim trekëndor, etj.
- Nyja hark është verzion i modifikuar i nyjes damar.

Kapje karafil




- Kjo metodë njihet si metodë e shpejtë për lidhjen e litarit tek ndonjë objekt. Përdoret nga ekipet e zjarrfikësve për të parandaluar rrëshqitjen e zorrëve të ujit.
- Përdoret për lidhjen e litarëve në çdo lloj objekti.

Nyja hark



- Kjo metodë përdoret për të formuar një lak. Përdoret nga shpëtimtarët për të krijuar litar shpëtimi për veten e tyre, etj., gjatë fatkeqësive.
- Mund të përdoret për të lidhur litarin tek ndonjë objekt fiks si p.sh. pemë.

Nyja 'prusik'



- Kjo është metodë e shpejtë për lidhjen e litarit tek ndonjë objekt.
- Kjo metodë përdoret në situata të ngjashme sikur edhe kapjet karafil dhe hark, por është metodë më e përshtatshme për lidhjen e litarit tek ndonjë objekt delikat sepse kjo nyje nuk bëhet aq e fortë sesa kapja karafil dhe gjysëm hark.

Stërvitjet për evakuim

Kjo pjesë i shpjegon procedurat për stërvitjet e evakuimit, procedurat e stërvitjeve për organizimin dhe menaxhimin e lokaliteteve të evakuimit, stërvitjeve për akomodim emergjent tek lokalitetet e evakuimit, etj.

1. Qëllimi

Përgatitjet për situata emergjente, realizimi i stërvitjeve për evakuim për të mundësuar evakuimin e sigurtë të vendasve, si dhe stërvitjet për organizimin dhe menaxhimin e lokaliteteve të evakuimit do të sigurojnë komunitetin si dhe do t'ju ofrojnë mundësi vendasve të njihen me njëri tjetrin.

Komunikim të rregullt me ato që kanë nevojë për ndihmë për të identifikuar itineraret e evakuimit dhe llojet e transportit të përshtatshëm për njerëzit me probleme të ndryshme shëndetësore. Këto informacione do të jenë të dobishme gjatë një emergjence.

Duke realizuar stërvitje evakuimi në zonën lokale, mund të kuptohen dhe identifikohen problemet e itinerarëve të përshtatshme për transportim, distancat, koha e nevojshme dhe numri i nevojshëm i ndihmësve.

2. Numri i nevojshëm i personelit

Të gjithë pjesëmarrësit do të jenë në cilësi të personelit, përveç atyre që do të kenë rolin e njerëzve që kanë nevojë për ndihmë dhe të evakuohen.

3. Pajisjet dhe materialet e nevojshme

- Për transportim të të evakuarëve: barela, karroca për invalidë, karroca dore/karroca biçiklete, batanije, etj.
- Kutë për ofrim të ndihmës së parë, AED (defribilator automatik)
- Për menaxhim me lokalitetin e evakuimit: listë me emrat e të evakuarve, vegla për të shkruar, etj.
- Për stërvitje akomodimi në rast të emergjencave: mbulesa (batanije, etj), kutë kartoni, vegla dhe përbërës për gatim të ushqimit, racione emergjente, ujë (në shishe PET), etj.
- Leje për përdorim të rrugëve (kur kryeni stërvitje për zjarrfikje, evakuim, operacione humanitare, etj., në rrugë, do të duhet të kërkonit leje nga shefi i stacionit policor për përdorim të rrugëve të caktuara, etj.)

4. Përmbajtja e stërvitjes

- (1) **Stërvitjet për evakuim** (menaxhohet nga Ekipi për udhëzim gjatë evakuimeve, Ndihmësve për ato që kanë nevojë për ndihmë, Ekipi për shpëtim, Ekipi humanitar, etj.)

Duke simuluar një skenar të fatkeqësisë, kontaktoni me përfaqësues të çdo blloku duke përdorur një 'pëmë' të telefonatave emergjente. Konfirmojeni sigurinë e amvisërive bllok

pas blloku dhe shënori “u konfirmua” në listë. Realizoni operacione shpëtimi aty ku paraqitet nevoja. Mblidheni tek pika e përkoshme e evakuimit, kontrolloni anëtarët e grupit dhe pastaj vazhdoni për tek lokaliteti i evakuimit.

- (2) **Krijimi i lokalitetit për evakuim** (menaxhohet nga Ekipi i shtabit, Ekipi për lokalitetin e evakuimit, Ekipi për furnizim me ushqime humanitare, etj.)

Pas stërvitjes së evakuimit, mblidheni tek lokaliteti i evakuimit. Tek lokaliteti i evakuimit, grumbulloni informacione, organizojeni lokalitetin dhe përgatituni të gatuarit ushqime humanitare.

- (3) **Stërvitja për akomodim emergjent** (menaxhohet nga Ekipi i shtabit, Ekipi për lokalitetin e evakuimit, Ekipi për furnizim me ushqime humanitare, etj.)

Është e dëshirueshme që vendasit të marrin pjesë si familje, por gjithashtu është mirë që fëmijët të marrin pjesë pa prindërit e tyre si pjesë përbërëse e edukimit shkollor gjatë fatkeqësive. Pasiqë pjesëmarrësit të përjetojnë kushtet e parehatshme të jetesës me ushqime, ujë, shtretër dhe hapësirë të kufizuar, pyeteni të mendojnë se çfarë mund të bëhet për ta përballuar këtë gjendje.


Gjatë stërvitjes mund të përfshihen edhe lojëra dhe ushtrime të lehta në mënyrë që pjesëmarrësit të argëtohen gjatë stërvitjes. Gjithashtu, gjatë kësaj stërvitjeje, mund të realizohet një bisedë në temë reduktimi i rrezikut gjatë fatkeqësive (si për shembull një bisedë rreth ndonjë përjetim tërmeti), stërvitje në rast zjarri, etj.

- (4) **Masat për ata që kanë nevojë për ndihmë**

Njerëzit që kanë nevojë për ndihmë pritët që zakonisht të evakohen me ndihmën e anëtarëve të familjes së tyre. Pajisjet e transportit (siç janë karrocet për invalidë) gjithashtu duhet të përgatiten nga secila familje. Në rast se evakuimi nuk mund të kryhet nga vetë familjet, atëherë ndihma duhet të vjen nga Komuniteti.

Kuptoni kushtet e atyre që kanë nevojë për ndihmë nëpërmjet bashkëveprimit të përditshëm dhe konsideroni se çfarë lloji transporti do të jetë i nevojshëm në rast të emergjencave (kamionë dhe vetura mund të përdoren varësisht nga kushtet e rrugës, mirëpo automjetet nuk mund të përdoren në rast se janë të bllokuara rrugët gjatë tërmeteve).

Diagrami skematik i stërvitjeve



5. Procedurat (Nga planifikimi tek takimi i shqyrtimit)

(1) Takimi parapërgatitor (Krijimi i planit)

Çfarë lloje të fatkeqësive duhet të merren parasysh?

Cilat zona duhet të evakuohen kur të ndodh fatkeqësia?

A janë të regjistruar njerëzit që kanë nevojë për ndihmë? Ku jetojnë njerëzit që kanë nevojë për ndihmë?

Cilat rrugë duhet të përdoren për evakuim? (Cilat rrugë janë të sigurta?)

Kush e ngrit dhe e menaxhon lokalitetin për evakuim? (Banorët apo organizatë qeveritare?)

Kujt i drejtoheni për përkrahje? (Shih (iii))

Çfarë programesh duhet të përfshihen në stërvitjen për akomodim emergjent?

Shënim: Lutni organizatat bashkëpunuese, etj., të marrin pjesë në takim.

(2) Caktimi i roleve

Ekipi i shtabit, ekipi për udhëzime evakuimi, ndihmës për njerëzit që kanë nevojë për ndihmë (transport), ekipi për furnizim me ushqim humanitar, ekipi për lokalitetin e evakuimit, ekipi i shpëtimit, ekipi humanitar, etj.

(3) Kërkimi për mbështetje (bashkëpunimi është thelbësor me qëllim të realizimit të stërvitjeve si një komunitet i tërë.)

Shkollat si lokalitete evakuimi (Shtete të ndryshme kanë lokalitete të ndryshme të caktuara si lokalitete evakuimi.)

Grupet e rezidentëve, siç janë asociacionet e rezidentëve

Organizatrat qeveritare

Policia, shërbimi zjarrfikës, ushtria (Lutni organizatat qeveritare në krye të menaxhimit të fatkeqësive të marrin pjesë në stërvitjet.)

Organizatat për të rinj, asociacionet e grave, korpusi vullnetar zjarrfikës, etj.

(Nevojiten shumë duar edhe për të realizuar stërvitjen edhe për situata emergjente.)

Organizatrat vullnetare, Organizatat jo fitimprurëse, Kryqi i Kuq (Gjysmëhëna e Kuqe), etj.

(4) Realizimi i stërvitjeve

Realizoni stërvitjet në përputhje me planin.

Gjatë stërvitjeve për evakuim, disa njerëz arrijnë herët e disa vonë tek lokaliteti i evakuimit.

Prandaj, planifikoni programet që mund të organizohen derisa i pritni të arrijnë të gjithë.

Gjatë një stërvitjeje për akomodim emergjent ku marrin pjesë fëmijë, kushtoni vëmendje të posaçme sigurisë së tyre dhe sigurohuni që të jeni në kontakt me prindërit e tyre në do kohë.

(5) Takimet rishikuese

Takimet rishikuese dhe krijimi i fletëve të shqyrtimit (destinuar për të identifikuar problemet) janë elemente të nevojshme për stërvitjet. Krijoni fletë rishikuese për çdo person i cili ka nevojë për ndihmë, nëse është e mundur.

Është me rëndësi të shkëmbeni me secilin çështjet që duhet të përmirësohen .

Këshilla për këtë program

- ☆ Mund të filloni të identifikoni problemet e llojllojshme siç i përsëritni stërvitjet e evakuimit.
- ☆ Duke u bazuar në përvojën e stërvitjeve të kaluara, realizoni stërvitje së paku një here në vit.

Çështje që duhet të përfshihen në bisedimet me pjesëmarrësit

- ☆ Secili mund të ketë rolin e “atyre të kanë nevojë për ndihmë” gjatë një fatkeqësie.
Lutni njerëzit të jenë të gatshëm për emergjenca duke i rregulluar mobiljet, etj. Le ta dinë se komunikimi me fqinjët gjatë jetës së përditshme është i rëndësishëm.
- ☆ Fryma e mbështetjes së ndërsjellë është posaçërisht e rëndësishme në situata të vështira.

Stërvitjet për përhapje të informacioneve

Përgatitja për emergjenca

Kjo pjesë i shpjegon procedurat për krijimin e ‘pëmës telefonike’ emergjente dhe stërvitjeve për përhapjen e informacioneve me qëllim të përcjelljes së informacioneve tek vendasit rreth ndodhisë së ndonjë emergjence, si dhe evakuimit të tyre.

1. Qëllimi

Stërvitja për trasmetimin e informacioneve synon grumbullimin e informacioneve të sakta si p.sh., situatën tek zona e fatkeqësisë, informacione rreth rrezeqeve, gjendjen e evakuimit të vendasve, etj., si dhe përcjelljen me kohë të atyre informacioneve tek vendasit.

2. Numri i nevojshëm i personelit

2-3 personel (nëse stërvitja përfshin vetëm komunikim telefonik)


3. Pajisjet dhe materialet e nevojshme

Kopje të diagramit të ‘pëmës telefonike emergjente’ (një kopje për çdo pjesëmarrës), telefona (mundësisht celularë), si dhe harta e bllokut të qytetit (1 kopje)

4. Procedurat

(1) Banorët do të zhvillojnë diskutime për të krijuar një ‘pëmë telefonike emergjente’.

(Shembull)



- * Kontrolloni lokacionin e shtëpisë/ve së rradhës që duhet të kontaktohet në hartën e banorëve, etj. (Kjo është e dobishme për ato situata që kërkojnë vizita prej dere në derë për transmetim të informacioneve.)
- * Personat e fundit në pemën telefonike do t'ia raportojnë përsëri informacionin e transmetuar dhe kohën kur e kanë pranuar informacionin shefit të bllokut, etj.
- * Diskutoni paraprakisht rregullat e sipërpërmendura dhe rregullat e tjera të nevojshme.

(2) Vendosni rreth përmbajtjes së përafërt të informacioneve që duhet të grumbullohen.

Adresën e zonës së fatkeqësisë, cakun, gjendjen tek lokaliteti, numrin e personave të plagosur, seriozitetin e plagëve, problemet e pritshme në të ardhmen e afërt, masat aktuale, personin që e raportoi fatkeqësinë, numrin e njerëzve tek lokaliteti i evakuimit, gjendja e evakuimit, etj.

- * Mos harroni të merrni shënime kur grumbulloni informacione.
- * Planifikoni metoda të tjera për transmetim të informacioneve të cilat nuk mbështeten në telefona (radio, ecje, përdorim të personelit për transmetim të informacioneve, etj.) duke i konsideruar zonat ku telefonat nuk mund të përdoren ose nuk mund të krijohet lidhja për shkak të vështirësive që i ka krijuar fatkeqësia.
- * Tentoni të grumbulloni informacione për njerëzit, për shembull, cilët kategori njerëzish janë në telashe, përveç statusit të fatkeqësisë.

Mirëpo, trajtimi i informacioneve personale kërkon kujdes të madh. Diskutoni parakohe se kush duhet t'i shoh ato informacione.

5. Metoda për stërvitjen e transmetimit të informacioneve

- (1) Jepni informacionet për simulimin. (P.sh., një këshillë evakuimi ishte lëshuar për Bllokun ○○ dhe Bllokun XX në ora XX: XX, pasi që ekziston rrezik nga rrëshqitja e shpateve të lumit XX për shkak të rreshjeve të mëdha të shiut. Ata që jetojnë afër zonës së rrezikuar këshillohen të evakohen te shkolla fillore XX.)
- (2) Transmetojini informacionet duke e përdorur pemën telefonike emergjente në zonën tuaj. Nëse personi që është pranë jush në pemën telefonike nuk i është përgjigjur telefonatës (sepse ai/ajo nuk ka qene në shtëpi, etj.), telefononi personit pranë atij personi në pemën telefonike dhe tregoni atij/asaj se personi tjetër ishte i paarritshëm. Këto informacione pastaj duhet t'i transmetohen personit të fundit.
- (3) Kontrolloni sa me saktësi është transmetuar informacioni për simulimin. Në rastin e shembullit të sipërpërmendur të pemës telefonike emergjente, personat e fundit në pemën telefonike do t'ia raportojnë përsëri shefit të bllokut informacionet e pranuar, kohën kur e kanë pranuar telefonatën, si dhe informacionet për njerëzit që ishin të paarritshëm.

- (4) Shefat e blloqeve do t'i raportojnë rregullisht përfaqësuesit të komunitetit (çdo 10-20 minuta) numrin e njerëzve të kontaktuar dhe emrat e njerëzve që nuk ishin të arritshëm.
- (5) Ndërpritni ushtrimin kur të mbarojë koha (koha e mbarimit duhet të caktohet para kohe). Përfaqësuesi i komunitetit do t'i grumbulloj rezultatet, do t'i prezantoj rezultate në një datë të mëvonshme dhe do të diskutoj me banorët nëse ka ndonjë çështje që duhet përmirësuar.

Këshilla për këtë program

- ☆ Nëse ekzistojnë media lokale në komunitetin tuaj, si p.sh., radio stacion ose TV lokale, ato mund të përdoren si mjete për transmetim të informacioneve rreth fatkeqësisë.
Organizoni një rast për grupet e banorëve, organizatat qeveritare dhe mediat të diskutojnë së bashku mënyrat e bashkëpunimit të tyre.



Çështje që duhet përfshirë në bisedimet me pjesëmarrësit

Në raste të emergjencave, njerëzit mund të mos e kuptojnë situatën në të cilën gjenden, dhe në kombinim me psikologjinë njerëzore e cila nuk dëshiron të njihet rrezikun derisa rreziku është pranë tyre, ata mund të bindin veten e tyre se nuk është asgjë serioze.

Kjo gjendje shpirtërore në fjalorin akademik njihet si “paragjykim i normalitetit”. Do të jetë e rëndësishme për ju si anëtarë të organizatave vullnetare për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive që të mundësoni siguri për komunitetin e t’ju transmetoni banorëve informacione të sakta rreth situatave të rrezikshme.

Më poshtë është dhënë një listë e çështjeve që duhet të kemi parasysh lidhur me grumbullimin dhe transmetimin e informacioneve të sakta. Ju lutemi shpërndajeni këtë me pjesëmarrësit e stërvitjes si informacione që duhet të shfrytëzohen gjatë emergjencave.

1. Konfirmoni faktet dhe raportojini në kohë të duhur.
2. Ndani informacionet me organizatat përkatëse për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive, si p.sh., komunat dhe shërbimet e zjarrfikësve.
3. Transmetojini informacionet duke përdorur fjalë të thjeshta dhe mos përdorni fjalë të vështira.
4. Informacionet tentoni t’i jepni jo vetëm gojarisht por edhe në formë të shkruar (një shënim).
5. Luteni pranuesin e informacionit të përsëris përmbajtjen me qëllim të transmetimit të saktë të informacionit.
6. Mesazhet gjatë emergjencave shpesh herë përfshijnë numra. Të jeni sidomos të kujdesshëm kur transmetoni informacione që përmbajnë numra.
7. Reporting that there are no particular problems is also important information.



Harta e sigurisë në komunitet

Kjo pjesë e sqaron të ecurit nëpër qytet për të hulumtuar gjësendet që duhen përfshirë në një hartë sigurie dhe si të krijohet një hartë.

1. Qëllimi

Pjesëmarrësit ecin nëpër qytet të hulumtojnë se ku janë të vendosura objektet për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive në komunitetin e tyre dhe të krijojnë një hartë sigurie, e cila mund të përdoret gjatë emergjencave.

2. Numri i nevojshëm i pjesëmarrësve

10 ose më shumë (numri i pjesëmarrësve i pakufizuar)

3. Pajisjet dhe materialet e nevojshme

Letër ose hartë bazë (mundësisht)	1 për çdo grup dhe 1 për verzionin final
Vegla për shkrim	1 për çdo pjesëmarrës (nëse nuk është e mundur, një komplet për çdo grup)

[Shënim]

Në thelb, numri i pjesëmarrësve është i pakufizuar. Rekomandohet që pjesëmarrësit të ndahen në grupe, nëse ka shumë pjesëmarrës.

Më mirë të jenë më shumë pjesëmarrës që t'i gjejnë lokalitetet e rrezikshme, etj., nga kënde dhe pikëvështrime të ndryshme.

4. “Hulumtimi i qytetit”

- (1) Lutni pjesëmarrësit të takohen në një vend të caktuar. Vendosni se cilat rrugë dhe cilat zona t'i hulumtoni. Nëse pjesëmarrësit janë të ndarë në grupe, caktoni role për çdo anëtar të secilit grup (personi që nxjerr fotografi, personi që i plotëson informacionet në hartë, personi që e kontrollon sigurinë e pjesëmarrësve, etj.). Shpërndani pjesëmarrësve copa letre (harta baze) dhe vegla për shkrim që informacionet të shënohen dhe të përpilohen më vonë.



- (2) Pasiqë të gjithë të jenë gati, filloni të hulumtoni zonën. Mos u ngutni vështroni zonën nga kënde dhe pikëvështrime të ndryshme
Shënim: Ju lutemi shihni “Këshillat për këtë program” më poshtë.



- (3) Pas përfundimit të hulumtimit të zonës, bëni përmbledhje të informacioneve që paraprakisht i keni shënuar për çdo lloj artikulli.

Nëse hulumtimi është bërë në grupe, mund të kërkonit nga secili grup t'ua prezantojnë gjetjet e tyre pjesëmarrësve të tjerë.



- (4) Në fund, grumbulloni informacionet e hulumtuara dhe kompletojeni hartën.

Këshilla për këtë program

☆ Më poshtë janë dhënë disa artikuj që duhet kontrolluar gjatë hulumtimit të qytetit.

- Depo për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive, pishina, hidrante uji, çisterna zjarri, etj. (gjëra të dobishme)
- Amvisëri që posedojnë radio, altoparlantë të instaluar jashtë shtëpisë, tabela paralajmërimi, etj. (vende ku njerëzit mund të fitojnë informacione)
- Supermarkete, pika karburanti, tualete, etj. (vende të dobishme)
- Spitale, klinika, farmaci, vende ku janë instaluar AED, stacione të zjarrfikësve, të policisë, etj.
- Lokalitete për evakuim, shkolla, parqe, vende të hapura, parkime për automjete, etj.
- Objekte dhe lokalitete të rrezikshme (përfshirë dhe pikat e zeza të aksidenteve)
- Vende dhe gjëra të tjera të dobishme (kërkoni nga pjesëmarrësit të mendojnë për gjëra dhe vende të tjera të dobishme).

Shënim: Rekomandohet që të grumbullohen informacionet e nevojshme edhe nga fëmijët dhe të moshuarit.

5. Krijimi dhe distribuimi i një harte

- (1) Pasiqë pjesëmarrësit t'i sjellin informacionet e grumbulluara dhe pas futjes së informacioneve të nevojshme në një hartë bazë, ajo hartë shtypet dhe iu shpërndahen kopje njerëzve të zonës, si dhe ngjiten nëpër vende të dukshme në zonë.

Ndarja e informacioneve me vendasit mund të ofrojë një mundësi për vendasit që të kuptojnë sesi mund të përdoren gjësendet e dobishme të komunitetit të tyre dhe çfarë kundërmasa mund të merren për lokalitetet e rrezikshme në përputhje me rrezikun.

Natyrisht, vendasit mund të marrin masa duke i përdorur informacionet në hartë kur ndodh një fatkeqësi e madhe.

(2) Harta nuk është e dobishme nëse zona e mbuluar me hartën është shumë e vogël ose shumë e madhe.

Në përgjithësi, rekomandohet krijimi i një hartë për një zonë që mbulohet me lokalitetin për evakuim (një zonë shkolle në rastin e qytetit Kobe) sepse do të jetë hartë e dobishme gjatë evakuimit.

(3) Rekomandohet që vendasit të ecin nëpër qytet së bashku për të përditësuar hartën një herë në vit. Kjo do të ngrit vetëdijen e vendasve për reduktimin e rrezikut gjatë fatkeqësive.

[Shënime]

Përveç krijimit të hartës së sigurisë të zonës lokale, gjithashtu është ide e mirë të krijoni një hartë sigurie edhe për kompleksin e shkollës ose ndonjë kompleksi të madh të ndërtesave të banimit.

Nëse pjesëtarët e komunitetit në moshë të ndryshme (prej te fëmijët deri tek pleqtë) mund të marrin pjesë në aktivitete, atëherë harta që do të rezultojë do të ketë informacione të llojllojshme në të sepse zona mund të vështrohet nga pikëpamje të ndryshme.

Çështje që duhet të përfshihen në bisedimet me pjesëmarrësit

- ☆ Kërkoni nga pjesëmarrësit të zhvillojnë biseda me anëtarët e familjeve të tyre rreth lokaliteteve të rrezikshme në zonën lokal, si dhe për reduktimin e rrezikut gjatë fatkeqësive në shtëpi.
- ☆ Secila familje duhet të diskutojë në vete rrugën dhe lokacionin për evakuim që të jenë të gatshëm për emergjenca.



Harta e sigurisë në komunitet

(Kolona për referime) Hartat e qytetit Kobe për vendet e rrezikut në rast të cunamit

Qyteti Kobe, në bashkëpunim me Komunitetet për mirëqenie të sigurtë gjatë fatkeqësive (BOKOMI), punon në drejtim të përpilimit të hartave për vendet e rrezikut në rast të cunamit që e mbulojnë tërë zonën e qytetit.

Për shembull, si masë kundër përmbytjeve, përgatitja e hartave të cunamit që nuk i tregojnë vetëm lokalitetet e strehimoreve për evakuim me ngjyrë të rëndomtë duke u bazuar në thellësinë e parashikuar të përmbytjeve, por gjithashtu të tregohet edhe sjellja gjatë evakuimit që është e përshtatshme për karakteristikat lokale që është efikase për vetëdijësimin e vendasve ndaj rreziqeve nga përmbytjet në baza ditore, si dhe iu mundëson të sillen në mënyrë korrekte gjatë evakuimit nga ndonjë fatkeqësi e cunamit.

Integrimi (1) i informacioneve themelore për rreziqet nga përmbytjet duke u bazuar në përvojën historike të fatkeqësive dhe kushteve gjeografike me (2) informacionet për evakuim që gjenden për lokalitetet e evakuimit dhe ato të rrezikshme do të shpie drejt krijimit të hartave mjaft praktike për ballafaqim me cunamit lidhur me sjelljen gjatë evakuimit që rekomandohet në kohën e fatkeqësisë.

<Hapat gjatë një serie punëtorish për krijimin e hartave
për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive>

Punëtorja	Programi	Çështje që duhen kontrolluar
E para (përgatitja e draft hartës)	1. Sqarime për rreziqet e fatkeqësive lokale Fatkeqësitë në të kaluarën dhe shkalla e dëmeve • Rreziqet e pritshme nga fatkeqësitë e veçorive gjeografike	Sqarime historike dhe arkeologjike të evidentuara për fatkeqësitë lokale.
	2. Punëtorja për krijimin e draft hartës • Grupimi i banorëve sipas bllokut • Shtimi i informacioneve të nevojshme në hartë 1) Kontrollimi i zonave të kontrolluara nga dëmet e cunamit dhe shënimi i tyre në hartë 2) Kontrollimi i shtëpive të banorëve	Banorët bëhen të vetëdijshëm për herë të parë kur vetë i shënojnë zonat e rrezikshme në vend që t'ia lënë këtë punë Qytetit.

	<p>dhe shënimi i tyre në hartë</p> <p>3) Shënimi i lokaliteteve të evakuimit në hartë</p> <p>4) Rishikimi i rrugëve të evakuimit</p> <p>5) Parashikimi i rreziqeve të mundshme nëpër rrugë gjatë evakuimit</p>	
	<p>3. Prezantimi i përmbajtjeve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Prezantimi nga ana e bllokut të komunitetit 	<p>Kontrolloni me kujdes mospërputhshmëritë e rëndësisë së fakteve ndërmjet vendasve dhe Qytetit.</p>
<p>E dyta (Të ecurit nëpër qytet, rishikimi i draft hartave)</p>	<p>1. Të ecurit nëpër qytet me draft hartën e përpiluar në punëtorinë e parë për të kontrolluar nëse duhet të shtohen informacione të tjera rreth fatkeqësive.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Informacione gjeografike (rrafshinat, shpatet, etj.) • Lokacione për të cilat duhet paralajmëruar gjatë evakuimit • Pikat e verbëra • Rreziqe nga përmbytjet • Vende me gjasa të ketë rrëshqitje dheu 	<ul style="list-style-type: none"> • Kontrolloni lokacione që mund të pengojnë evakuimin gjatë fatkeqësive (p.sh., zonat nën ndonjë mbikalim, kalime nëntokësore, urra, kalime hekurudhore, rrugë të ngushta, etj). • Mos ju ikin informacione të hollësishme për të cilat kanë njohuri vetëm vendasit (p.sh. hendeqe që mund të dalin nga shtrati i tyre gjatë rreshjeve të mëdha të shiut).
	<p>2. Në hartë shtohen informacionet e fituara nga shëtitja nëpër qytet.</p>	<p>Së pari, nëpërmjet një sesioni të ‘shkëmbimit të ideve’, shkruani të gjitha informacionet e fituara. Pastaj, zgjedhni informacione që duhet shtuar në hartë.</p>
	<p>3. Prezantimi i përmbajtjeve; rishikim të draft hartës</p>	<p>Kontrolloni me kujdes mospërputhshmëritë e rëndësisë së fakteve ndërmjet vendasve dhe Qytetit.</p>
<p>Zyrtarët e qytetit të ngarkuar për këtë fushë e përgatisin dhe shtypin hartën duke u bazuar në rezultatet e punëtorisë së parë dhe të dytë, dhe e sjellin hartën në punëtorinë e tretë.</p>		

E treta (Kontrollimi i verzionit final të hartës së shtypur, korrigjime)	1. Kontrolli i fundit i përmbajtjeve	Është me rëndësi që të krijohet një hartë tërheqëse për syrin dhe i përshtatshëm që vendasit të fitojnë informacione.
	2. Prezantimi i përmbajtjeve	Mbyllni serinë e punëtorive duke u bërë thirrje banorëve: 1) Të njoftojnë familjet e tyre me hartën e kompletuar; and 2) Të kyejnë stërvipte në shtëpitë e tyre dhe në komunitet duke e përdorur hartën e kompletuar.

Pasiqë të kompletohet harta për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive, tentoni të përdorni hartën aktuale gjatë stërvipteve.

Si shembull, faqja e mëposhtme paraqet një hartë të krijuar në punëtoritë e sipërpërmendur. Sa për informacione, kontrolloni si janë reflektuar pikëpamjet e vendasve në hartë.

< Pjesëmarrës në punëtorinë e organizuar në Kobe >



Wakamiya District Disaster-Safe Welfare Community Tsunami Hazard Map

Head North beyond

Keep away from Myohoji River. Avoid using a JR underpass if possible.

Legends

Height above sea level / a.s.l. (annual mean level at low and high tide, altitude)	Public phone
Disaster reduction machinery and materials storage	Emergency tsunami shelter
Outdoor speaker for disaster management radio system	Conv. store
Crossing	Volunteer fire corps base
Underground passage	Underpass
Overpass	

Tsunami alerting line

The maximum tsunami height in Suma Ward is estimated at 3.6 meters. The pale blue zone indicates the area of land not higher than 3.6 meters above sea level.

Tsunami damage controlled area (provisional): Pale blue zone

- * To ensure greater safety, this hazard map is built based on the tsunami damage controlled area (provisional) set by Hyogo Prefecture in Oct 2011, though it published a simulated Nankai Trough mega quake tsunami inundation map in Feb 2014.
- * Note that tsunami damage may expand beyond the area border depending on earthquake scale and other conditions.



Evacuation Routes from JR Line during Evacuation



The first tsunami is expected to arrive about 85 minutes after the earthquake occurs.
A series of tsunamis will come in succession!

Stërvitje të kontrollit të përmbytjeve – Të jeni të përgatitur për përmbytje

Ekzistojnë fatkeqësi të tjera përveç tërmeteve. Kjo pjesë jep sqarime sesi të veprohet në rast të përmbytjeve dhe tajfunëve, si dhe për metodat e stërvitjeve për kontroll të përmbytjeve.

1. Krijimi i hartës së rrezikut

Kur krijoni një “hartë rreziku” që u shpjegua në Programin 11, identifikoni lokalitetet që janë të ndieshme ndaj fatkeqësive të ujit në zonën lokale (lokalitete të ndieshme ndaj rrëshqitjes së dheut, rrugë të ndieshme ndaj përmbytjeve, lumenj, si dhe lokalitete të tjera që janë të ndieshme ndaj llojeve të tjera të përmbytjeve gjatë rreshjeve të mëdha të shiut).

Kushtoni vëmendje parashikimit të motit dhe informacioneve për tërmete në radio, etj. dhe evakuohuni menjëherë sapo të ndjeni se është e rrezikshme që të rrini.

Realizimi i stërvitjeve të rregullta duke u bazuar në Programin 9 “Stërvitje për evakuim” dhe Programin 10 “Stërvitje për transmetim të informacioneve” do ju ndihmojë të ruani qetësinë kur të ndodh ndonjë fatkeqësi.

Këshilla për këtë program

- ☆ Mund të krijoni një “hartë rreziku nga përmbytjet” enkas për situata të përmbytjeve, që përfshin vendet e mundshme kur mund të ketë rrëshqitje të shpateve ose përmbytje të lumenjve, lokalitete të tjera të ndieshme ndaj përmbytjeve, lokalitete evakuimi në kodër, etj.
- ☆ Kushtoni vëmendje informacioneve në radio, etj., si p.sh. paralajmërimet për motin dhe informacionet për tërmete. Përgatitni “kuti emergjente” të cilat mund t’i merrni me vete në raste të emergjencave.

2. Realizimi i stërvitjes për kontroll të përmbytjeve

(1) Qëllimi i aktiviteteve për kontroll të përmbytjeve

Aktivitetet për kontroll të përmbytjeve të realizuara nga banorët e komunitetit dhe korpuset vullnetare zjarrfikëse kryhen me qëllim të parandalimit të përmbytjeve dhe zbutjes së dëmeve të shkaktuara nga rrjedhjet e ujit dhe rrënimi i shpateve, duke përdorur metoda të ndryshme për kontroll të përmbytjeve. Është e rëndësishme të jemi mirë të përgatitur, të përfitojmë shkathësi dhe mbledhim informacione rreth aktiviteteve për kontroll të përmbytjeve para se të ndodh ndonjë fatkeqësi.

(2) Realizimi i stërvitjes për kontroll të përmytjeve

Kur realizoni një stërvitje për kontroll të përmytjeve, pranoni udhëzime nga personeli qeveritar, si p.sh., shërbimit zjarrfikës dhe pjesëtarët e korpusit vullnetarë zjarrfikës, si dhe nxitni sa më shumë banorë që është e mundur të marrin pjesë në stërvitje.

(3) Përmytja e stërvitjes

- (i) Vështrimi (nivelet e ujit, rreshjet, shpejtësinë e erës)
- (ii) Raportimi (mobilizimi i korpusit vullnetar zjarrfikës)
- (iii) Transporti (pajisjet dhe materialet, personeli)
- (iv) Metodrat e llojllojshme për kontroll të përmytjeve
- (v) Evakuimi (evakuimi i banorëve në zonat e rrezikut)

Këshilla për këtë program

Me realizimin e programeve të tjera si p.sh., “Stërvitjet për evakuim” dhe “Stërvitjet për transmetim të informacioneve” në kombinim me këtë program, stërvitja më mirë do të mund të simulojë një situatë të vërtetë fatkeqësie.

(4) Metodrat e llojllojshme për kontroll të përmytjeve

Ekzistojnë shumë metoda për kontroll të përmytjeve, të përshtatshme për lloje të ndryshme të përmytjeve (p.sh., rrjedhja e ujit nga toka, çarjet, shembja e digave, uji që del nga shtrati i lumenjve, etj.), kurse disa prej të cilave janë të vështira për t’u realizuar nga joprofesionistët. Në përgjithësi, mund të krijohen dhe palohen thasë rëre për të parandaluar ujin që del nga shtrati ose nga shembja e digave.

Pranoni udhëzime nga agjencitë e specializuara si për shembull nga organizatat e shërbimit zjarrfikës dhe ushtria.



Palosja e thasëve të rërës

(Palosni thasët me rërë dhe forconi me hu hekuri)



Si të ngulet një hu

(Vendosni dorezën e lopatës në hu)



Palosja e thasëve të rërës me pëlhurë të gomuar
(Përhapeni vertikalisht pëlhurën në anën lumenit, thasët si në foton më lartë)



Palosja e thasëve në formë “të enës së shtypur”
(Rrethojeni pjesën që rrjedh në tokë me Kurse e thasë rëre)

[Metoda të thjeshta për kontroll të përmytjeve]

Këto metoda mund të zbatohen në fazën fillestare të përmytjes kur nivelet e ujit janë ende të ulëta, duke përdorur materiale të qasshme në shtëpi.

- (1) Mbushni qeset me ujë, vendosni qeset në kuti kartoni dhe mbështillni me pëlhurë të gomuar.
- (2) Konteinerët plastik mbështillni me pëlhurë të gomuar.
- (3) Një metodë e thjeshtë për kontroll të përmytjeve me përdorim të mbjellësve



Qeseja me ujë

(5) Përgatitja për stërvitjen

Ekzistojnë shumë lloje të materialeve dhe pajisjeve që përdoren për kontroll të përmytjeve.

Kontrolloni nëse i keni të gjitha pajisjet dhe materialet përfshirë tokmakë të mëdhenj druri, sharra, lopata, sëpata, pëlhurë të gomuar, hu druri, litarë, etj. Mësoni si t'i përdorni në kohëra normale.

(6) Si të krijoni një thes rëre


A. Pajisjet dhe materialet e nevojshme



Thasë boshe



Lopata



Shufra hekuri, hu druri



Çekiçë,
Tokmakë të
mëdhenj druri

B. Si të krijoni një thes rëre

- Mbusheni thesin me truall, 6-7 lopata (30-40 kg).



Mbusheni thesin me truall dhe pastaj tërhiqeni perin në grykë.



Kapeni perin me një gisht që të formoni një lak. Rrotullojeni perin rreth grykës së thesit 2-3 herë. Vendojeni perin brenda lakut dhe tërhiqeni që të shtrëngohet.



C. Si të ngritni një thes rëre



Vendosni thesin në prehër.



Vendosni thesin në shpatulla...



...Pastaj, çoheni në këmbë.

- Mund të përdorni dhe karroce dore për bartjen e thasëve.

Shënim: Kujdes mos e lëndoni shpinën, etj., kur i ngritni gjësendet e rënda.

Çështje që duhet të përfshihen në bisedimet me pjesëmarrësit

Identifikoni zona të ndieshme ndaj përmbytjeve, etj., që të jeni të gatshëm për fatkeqësinë.

Diskutoni me anëtarët e familjes se ku gjendet lokaliteti për evakuim, cilët rrugë duhet të përshkohen për të arritur atje, etj.

Nëse jeni pranë detit kur të godet ndonjë tërmet, menjëherë evakuohuni në vende më të larta.



Realizimi i stërvitjeve në kombinim me aktivitetet e komunitetit

Duke realizuar aktivitete për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive në kombinim me aktivitetet e tjera të komunitetit, pritet që shumë njerëz do të marrin pjesë në aktivitete, ndërsa kjo do të ngrit vetëdijen e më shumë njerëzve në komunitet rreth reduktimit të rrezikut gjatë fatkeqësive.

1. Qëllimi

Nëpërmjet integrit të elementeve të aktiviteteve për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive në aktivitetet e tjera të komunitetit, një numër i madh njerëzish do të kenë mundësi të mësojnë rreth reduktimit të rrezikut gjatë fatkeqësive.

Kur është e mundur të realizohen aktivitete të pavarura për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive, atëherë përdorimi i aktiviteteve të tjera të komunitetit do të zvogëlojë kohën që duhet për planifikim dhe mjetet financiare.

2. Numri i nevojshëm i pjesëmarrësve

Numri i pjesëmarrësve mund të përshtatet sipas përmbajtjes së aktivitetit.

3. Pajisjet dhe materialet e nevojshme

Pajisjet dhe materialet e nevojshme duhet të organizohen sipas përmbajtjes së aktivitetit.

4. Shembuj të bashkëpunimit

(1) Integrimi në aktivitete të mirëqenies

- Integroni aktivitetet për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive në takimet e të moshuarve në komunitet, për shembull, ofrimin e informacioneve rreth reduktimit të rrezikut gjatë fatkeqësive (ligjerata për reduktimin e rrezikut gjatë fatkeqësive si p.sh., një bisedë rreth ndonjë tërmeti që ka ndodhur në të kaluarën, informacione lidhur me sistemet e alarmit të zjarrit, si të përforcohen mobiljet, etj.).
- Duke i shfrytëzuar aktivitetet vullnetare aty ku takohen banorët vendas (si p.sh. dasma dhe pastrim kanalesh), do të jetë e mundur të realizohet stërvitje emergjente ose të ofrohen informacione rreth reduktimit të rrezikut gjatë fatkeqësive. Kjo do të mundësojë në shancë për ata që nuk mund të marrin pjesë në aktivitetet për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive që të mësojnë më shumë për reduktimin e rreziqeve gjatë fatkeqësive.

Aktivitete të mirëqenies

+

Aktivitete për reduktim të rreziqeve gjatë fatkeqësive

(2) Integrimi në ngjarjet e komunitetit

- Ofroni informacione ose realizoni një stërvitje emergjente gjatë ngjarjeve të komunitetit si p.sh., festivale verore, festival muzikor ose aheng për Krishtlindje.
- Krijoni një kabinë për një lojë ku do të gjuhen caqet me përdorim të bombolave të ujit gjatë një festivali në komunitet.
- Ngritni vetëdijen e njerëzve duke realizuar një stërvitje kundër zjarrit ose një brigade me kova gjatë gjysmës së parë të ndonjë loje futbolli, etj.

Ngjarjet në
komunitet

+

Aktivite për reduktim të
rreziqeve gjatë fatkeqësive

5. Procedurat

- (1) Diskutoni rreth ngjarjeve dhe aktiviteteve në të cilat mund të integrohen aktivitetet për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive.
- (2) Kontaktoni me organizatorët e aktiviteteve dhe ngjarjeve dhe këshillohuni rreth bashkërendimit të aktiviteteve.
- (3) Kërkoni këshilla nga stacioni i zjarrfikësve rreth programeve të trajnimit që janë të përshtatshme për situatën e dhënë.
- (4) Realizoni aktivitetet për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive.

* Shembuj nga Japonia (KOBE)

- (1) Realizoni një lojë që i integron elementet e aktiviteteve për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive si pjesë përbërëse të ditës së sportit në ndonjë shkollë.



- (2) Realizoni programe për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive gjatë ndonjë festivali veror në komunitet.



Këshilla për këtë program

- ☆ Ekzistojnë ngjarje për të cilat organizatat nuk mund të sigurojnë përkrahje si pjesë përbërëse të detyrave të tyre (si p.sh., dërgimin e kamionit zjarrfikës ose personelit qeveritar) varësisht nga përmbajtja dhe qëllimi i ngjarjeve. Nëse nevojitet ndihmë nga organizatat qeveritare, atëherë këshillohuni me ata rreth përmbajtjes së ngjarjes, etj., gjatë fazës së planifikimit.
- ☆ Integrimi i aktiviteteve për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive në ngjarjet e komunitetit, të cilat tërheqin shumë njerëz, mund të ofrojë mundësi për komunitetin t'i përmirësojë aftësitë rreth reduktimit të rrezikut gjatë fatkeqësive. Diskutoni se çfarë aktivitete mund të realizohen në komunitet. Gjithashtu, këshillohuni me organizatat qeveritare që të zbuloni se çfarë përkrahje është në dispozicion.

Çështje që duhet të përfshihen në bisedimet me pjesëmarrësit

- ☆ Shumë aktivitete në komunitet janë sezonale. Ndoshta ekziston më shumë mundësi që pjesëmarrësit t'i kthejnë në shtëpi informacionet e mësuara, nëse mund të ofroni informacione lidhur me fatkeqësi që ndodhin në stinë të caktuara.

[P.sh.]

- Pranverë: Bisedime rreth zjarreve në pyje (lidhur me përdorimin e skarës në pyje)
- Verë-vjeshtë: Furtuna dhe dëme nga përmytjet (lidhur me stinën me rreshje shiu dhe tajfunët), aksidente në relacion me ujin (lidhur me pushimet verore)
- Dimër: Bisedime rreth zjarreve (lidhur me ajrin e thatë)

**Programet edukative
shkollore rreth fatkeqësive
(përshkrimi / referenca)**

- * Ky është një shembull i një plani të një shkolle fillore në Japoni.
- * Ju lutemi krijoni një plan në pajtim me rrethanat e çdo shteti.

Shembull i një plani shkollor për menaxhim të fatkeqësive

Shkolla fillore XX

1. Qëllimi

Ky plan synon evakuimin e sigurtë të nxënësve dhe minimizon viktimat duke parashikuar masa që duhet të ndërmerren gjatë tërmeteve ose shpërthimit të zjarrit.


2. Masa që duhet të merren në rast të zjarrit

(1) Veprimet e zbuluesit të zjarrit

- Kur të zbuloni një zjarr, **mos ngurroni dhe lajmërojeni njerëzit rreth juve për këtë zjarr.**
Përdorni alarmin e zjarrit (alarmet e zjarrit me sustë që shtypen), etj. për të lajmëruar njerëzit.
Përdorni metoda të përshtatshme për të njoftuar nxënësit (sidomos nxënësit që kanë nevojë për vëmendje të posaçme) **duke konsideruar mundësinë e panikut.**
- Lajmërojini drejtorin (nëndrejtorin nëse drejtori mungon).** (Nëse është e nevojshme, zbuluesi duhet të njoftojë zjarrfikësit.)
- Jepni udhëzime dhe drejtime për evakuim duke e vënë në rend të parë sigurinë e nxënësve.
- Nëse është e mundur zjarrfikja fillestare, **kryeni zjarrfikje fillestare** duke i përdorur pajisjet më të afërta për zjarrfikje si p.sh., bombolat gaz zjarrfikës, hidrantin e brendshëm kundër zjarrit, etj.
- Drejtori i shkollës (nëndrejtori nëse drejtori mungon) udhëzon për krijimin e një organizate për vetëmbrojtje nga zjarri dhe i cakton detyrat si në vijim.**

(2) Organizata për vetëmbrojtje nga zjarri duhet formuar në rast të zjarrit

Kur shpërthen zjarri, detyrat vijuese i caktohen personelit me nismë të drejtorit të shkollës dhe çdo anëtar personeli do të ndërmerre veprime në përputhshmëri me ato detyra.



(i) Drejtori, nëndrejtori i shkollës

Lajmërojnë shërbimin zjarrfikës dhe kontaktojnë organizatat përkatëse

- Lajmërojnë saktësisht shërbimin zjarrfikës lidhur me informacionet e fituara nga Ekipi për grumbullim të informacioneve.
- I përcjellin siç duhet ndryshimet e situatës.
- Realizojnë raportim të duhur para Bordit të arsimit dhe organizatave përkatëse të jashtme.

Përmbatja e raportimit

1. Dëshiroj të raportoj një zjarr.
2. Shkolla fillore _____.
3. Adresa është _____ Qyteti, _____.
- Raportoni për artikujt e mëposhtëm --
4. Vendin ku pret personi udhëzues
5. Vendin ku ka filluar zjarri
6. Shtrirjen e zjarrit
7. Nëse ka të plagosur ose jo, nëse ka, gjendja e të plagosurve
8. Gjendja e evakuimit
9. Gjendja e zjarrfikjes fillestare

Kontaktet relevante

Nr.	Organizata	Numri i telefonit
1	Bordi i arsimit	
2		
3		
4		
5		
6		
7		
8		
9		
10		

Komanda e përgjithshme

- **Njoftoni për zjarrin** duke përdorur sistemin publik të adresimit të shkollave, etj.
- Që të mos krijohet panik, **konsideroni me kujdes paraprakisht si t'i njoftoni nxënësit për zjarrin**, dhe **vendosni kopje të lajmërimeve** pranë telefonave dhe sistemit publik të adresimit.
- **Jepni udhëzimet e nevojshme** duke përdorur sistemin publik të adresimit të shkollave, etj.
- Që të **parandalohet paniku**, nëse ndizet sistemi automatik i alarmit të zjarrit, jepni lajmërim për tërë shkollën/lajmërim emergjent (pasiqë të keni konsideruar me kujdes përmbajtjen e lajmërimit) në pajtueshmëri me situatën, për shembull, të njoftohen nxënësit se alarmi u aktivizua dhe se personeli i shkollës po kontrollon nëse ka zjarr apo jo.
- Pasiqë nxënësit dhe personeli të kenë arritur në vend të sigurtë si p.sh. tek oborri i shkollës, **Ekipi për grumbullim të informacioneve dhe Ekipi për udhëzime gjatë evakuimeve** i numërojnë nxënësit dhe personelin e shkollës. Gjithashtu, udhëzoni mësuesit **ta thonë me zë emrin e tyre (që të mësohen gabime)** me qëllim të **kontrollimit nëse dikush nuk ka arritur të largohet**. (Kujdestarët → Mësuesit në krye të klasave për çdo vit → Nëndrejtori → Drejtori)
- **Informoni ekipet zjarrfikëse** lidhur me informacionet e grumbulluara të sakta, kur të mbërrinë te shkolla.

Lokacioni i panelit të kontrollit për sistemin automatik të alarmit të zjarrit	Ndërtesa	Kati	vendi

(ii) Ekipi për grumbullim të informacioneve

Identifikimi dhe lajmërimi i informatave për zjarrin

- Kur ju lajmërojnë për një zjarr, zbuloni hollësitë për atë zjarr (lokacionin, shtrirjen, nëse ka të plagosur ose jo, etj.) dhe lajmërojeni drejtorin (nëndrejtorin nëse drejtori mungon).
- Grumbulloni informacione ashtu siç ndryshon gjendja e zjarrit dhe lajmërojeni drejtorin (nëndrejtorin nëse drejtori mungon).
- **Kujdesuni për sigurinë tuaj** kur grumbulloni informacione. Grumbulloni informacione nga një pozitë e sigurtë dhe **menjëherë evakuoheni nëse bëhet e rrezikshme për të qëndruar aty**.

Kontrollimi i gjendjes së evakuimit

- Kur të fillojë evakuimi, grumbulloni informacione për gjendjen e evakuimit (numrin e të evakuarve dhe informacione për të plagosurit) dhe lajmërojeni drejtorin (nëndrejtorin nëse drejtori mungon).
- Pasiqë të përfundojë evakuimi, **verifikojeni numrin e njerëzve (duke u siguruar të mos bëhen gabime)**. Pastaj, njoftojeni drejtorin (nëndrejtorin nëse drejtori mungon) për përfundimin e evakuimit, si dhe për informacione të tjera të nevojshme si p.sh., gjendjen e ndonjë të plagosuri.

(iii) Ekipi për zjarrfikje fillestare

- Mos u frikësoni dhe **merrni masa qetësisht**.
- **Realizoni zjarrfikje fillestare** duke i përdorur pajisjet më të afërta për zjarrfikje si p.sh., bombola të gazit zjarrfikës, kova uji, hidrantet e brendshme të ujit, etj.
- Gjithmonë të kryhet në çifte zjarrfikja fillestare. Gjithmonë të keni parasysh rrugët e evakuimit kur i kryeni aktivitetet dhe **evakuohuni menjëherë nëse bëhet shumë e rrezikshme të qëndroni sesa të vazhdoni të tentoni ta fikni zjarrin në kushte të rrezikshme**.
- Realizoni rregullisht stërvitje që të mësoni si të përdoren pajisjet e zjarrfikjes në mënyrë që zjarrfikja fillestare të jetë efikase në rast të një zjarri.

[Lokacionet e pajisjeve për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive]

Emri i pajisjes	Ndërtesa	Kati	Vendndodhja	Sasia	Drejtohet nga
Bombolë gazi zjarrfikës					

Emri i pajisjes	Ndërtesa	Kati	Vendndodhja	Sasia	Drejtohet nga
Hidrant i brendshëm ujit					

Emri i pajisjes	Ndërtesa	Kati	Vendndodhja	Sasia	Drejtohet nga
Të tjera (sistemi automatik i alarmit të zjarrit, dera në rast zjarri, etj.)					

(iv) Ekipi për udhëzime gjatë evakuimit

- Kur ju informojnë për një zjarr, vendosni menjëherë për rrugët më të mira të evakuimit dhe evakuoni nxënësit në një vend të sigurtë si p.sh., sheshin e lojërave, duke përdorur bilbila polici dhe duke dhënë udhëzime me zë të lartë.
- Në parim, rënditja e udhëzimeve për evakuim duhet të jetë si në vijim: **i) udhëzime horizontale; ii) udhëzime tatëpjetë; dhe iii) drejt udhëzimeve përpjetë.**
- Evakuimi i nxënësve në klasat e ulta duhet të jetë në rend të parë.
- **Që të mos ketë panik, konsideroni me kujdes së si t'i lajmëroni nxënësit për zjarrin e filluar.**
- Sqaroni nxënësve sesi të evakuohen (të dalin në rreshta, përdorimi i façoletave, rruga e evakuimit, etj.) para se të fillojë evakuimi.
- Në parim, çdo anëtar personeli i shkollës duhet të kujdeset për çdo **nxënës i/e cili/cila ka nevojë për vëmendje të posaçme** gjatë evakuimit.

(v) Ekipi për shpëtim

- Siguron informacione për ato që nuk kanë mundur të evakohen, në bashkëpunim me **Ekipin për grumbullim të informacioneve**.
- Nëse ka njerëz të paevakuar, identifikon numrin e njerëzve, etj., sa më saktë që mundën dhe pastaj bënë operacione shpëtimi në çifte.
- Kur bëhen operacionet e shpëtimit, jepni prioritet më të lartë sigurisë suaj. Kufizoni aktivitetet për punë shtesë për **Ekipin e udhëzimeve gjatë evakuimit dhe mos tentoni të kryeni operacione shpëtimi deri në atë masë sa që të rrezikoni sigurinë tuaj**.
- Nëse të gjithë janë evakuar me sukses, **realizoni evakuimin e mallrave të rëndësishme**.

(vi) Ekipi për ndihmë

- Siguron informacione për të plagosurit në bashkëpunim me **Ekipin për grumbullim të informacioneve dhe Ekipin e shpëtimit**.
- Nëse ka të plagosur, **i transportojnë ata në vend të sigurtë dhe iu ofrojnë ndihmë të parë**.
- Kur arrihet ekipi për ndihmë të parë, shpjegon gjendjen e të plagosurve dhe dorëzohet punën tuaj.

(vii) Të tjera

- **Çdo ekip duhet të merr veprime në mënyrë fleksibile në përputhje me situatën**, edhe pse, në parim, duhet t'i kryejnë detyrat e caktuara siç u shpjegua më lartë.

3. Masat që duhet të merren në rast tërmeti

Kur ndodh një tërmet, merrni masa në mënyrë fleksibile duke u bazuar në përmbajtjen e shpjeguar më poshtë.

Masat që duhet të merren janë të parashikuara për katër llojet e skenareve në vijim: kur ndodh tërmet (i) gjatë orëve të mësimit; (ii) para fillimit të mësimit, gjatë pushimeve ose pas mësimit; (iii) gjatë rrugës për në shkollë dhe kthimit në shtëpi; dhe (iv) gjatë udhëtimit në terren.

(i) Gjatë orëve të mësimit (brenda shkollës: personeli i shkollës dhe nxënësit gjenden në një vend.)

Gjendja	Veprimet e personelit të shkollës	Veprimet e nxënësve
Ndodhja e një tërmeti	Udhëzime për tërë shkollën (Drejtori dhe nëndrejtori)	[Për të gjitha lokacionet] <ul style="list-style-type: none"> Ndërpritni bisedën dhe dëgjojeni mësuesin. Largohuni nga vende që mund të shemben dhe vende nga të cilat mund të bien objekte. Mbulojeni kokën tuaj me ndonjë libër, çantë, etj. dhe prisni që të qetësohen dridhjet.
	Mundësim të sigurisë së nxënësve dhe dhënie të udhëzimeve (kujdestarët e klasave)	[Në klasë] <ul style="list-style-type: none"> Zvarrituni nën bankë dhe mbani këmbët e bankës. [Korridore dhe shkallë] <ul style="list-style-type: none"> Lëvizni drejt qendrës dhe strukeni. [Sheshi i lojërave] <ul style="list-style-type: none"> Largohuni nga ndërtesat dhe nga pajisjet tek sheshi i lojërave, grumbullohuni në qendër dhe strukuni. [Palestër] <ul style="list-style-type: none"> Që të shmangët rreziku i lëndimeve nga objektet që bien si p.sh., poçe elektrik, largohuni menjëherë nga muret, grumbullohuni në qendër dhe strukuni. [Pishina] <ul style="list-style-type: none"> Lëvizni tek këndet e pishinës dhe mbahuni tek ato. (Mësuesit nuk duhet t'i nxitojnë nxënësit të dalin nga pishina.) Kur qetësohet dridhja e objekteve, dilni nga pishina. Mbathni sandale, mbrojeni trupin me peshqir banjoje dhe përgatituni për evakuim. [Klasat me destinime të veçanta] <ul style="list-style-type: none"> Nëse gjatë ndodhjes së tërmetit në klasën e ekonomisë, të shkencës, etj., përdoret zjarr, shmangeni rrezikun dhe fikeni zjarrin nëse është e mundur.

Gjendja	Veprimet e personelit të shkollës	Veprimet e nxënësve
Pas qetësimit të dridhjeve	<p>Udhëzime për tërë shkollën (Drejtori dhe nëndrejtori)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Merrni vendim për t’u evakuar në një vend jashtë ndërtesave të shkollës dhe jepni udhëzime për evakuim. <p>Njoftimi i zjarrfikësve dhe policisë (Drejtori dhe nëndrejtori)</p> <p>Numrat e telefonit në rast emergjence</p> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; margin: 5px 0;"> <p>Numrat e telefonit të zjarrfikësve dhe policisë Zjarrfikësit: Policia:</p> </div> <p>Mundësimi i sigurisë së rrugës së evakuimit (kujdestarët e klasave)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kontrolloni sigurinë e nxënësve, vendosni për rrugën e evakuimit. - Prini nxënësit gjatë evakuimit (merrni listën e emrave të nxënësve) <p>Mundësimi i sigurisë pas evakuimit (kujdestarët e klasave)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kontrolloni numrin e nxënësve dhe sigurinë e nxënësve, pastaj shkruani një raport. - Kërkoni për nxënës të humbur dhe shpëtojini. - Identifikoni nxënësit e lënduar dhe ofrojuuni ndihmë të parë. - Kontaktoni prindërit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Filloni evakuimin (tek sheshi i lojërave) duke i zbatuar udhëzimet. • Mbrojeni kokën (me libra, çanta, etj.) gjatë evakuimit. • Evakuoeheni duke zbatuar “katër parime” (mos u shtyni, mos vraponi, mos bisedoni dhe mos u ktheni prapa). • Kujdes nga vendet me materiale të rrezikshme kur kaloni përtej tyre ose shmangni ato vende. • Rreshtohuni tek lokaliteti i evakuimit (sheshi i lojërave). • Uluni qetësisht dhe prisni udhëzime.

(ii) Para fillimit të mësimit, gjatë pushimeve ose pas mësimit (brenda shkollës: Personeli i shkollës dhe nxënësit gjenden në vende të ndryshme.)

Gjendja	Veprimet e personelit të shkollës	Veprimet e nxënësve
Gjatë ndodhjes së tërmetit	<p>Udhëzime për tërë shkollën (Drejtori dhe nëndrejtori)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prisni tek lokaliteti derisa të qetësohen dridhjet. <p>Mundësimi i sigurisë së nxënësve dhe dhënia e udhëzimeve (kujdestarët e klasave)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëzime për sigurinë <ul style="list-style-type: none"> • Udhëzoni nxënësit të mbrojnë kokat. • Udhëzoni nxënësit të largohen nga dritaret dhe muret. - Kontrolloni sigurinë e nxënësve (numëroni) dhe sigurinë e zonës përreth. - Qetësoni nxënësit. 	<p>[Brenda ndërtesave]</p> <ul style="list-style-type: none"> • Derisa toka dridhet, mbuloni kokat (me libër, çantë, etj.), qëndroni të qetë dhe prisni të qetësohen dridhjet. <p>Shënim: Shih “Veprimet e nxënësve” në pjesën “Gjatë orëve të mësimit”.</p>

Gjendja	Veprimet e personelit të shkollës	Veprimet e nxënësve
Pas qetësimit të dridhjeve	<p>Udhëzime për tërë shkollën (Drejtori dhe nëndrejtori)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Merrni vendim për t’u evakuar në një vend jashtë ndërtesave të shkollës dhe jepni udhëzime për evakuim. <p>Njoftimi i zjarrfikësve dhe policisë (Drejtori dhe nëndrejtori)</p> <p>Numrat e telefonit në rast emergjence</p> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; margin: 5px 0;"> <p>Numrat e telefonit të zjarrfikësve dhe policisë Zjarrfikësit: Policia:</p> </div> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; margin: 5px 0;"> <p>Mësuesit shpërndahen dhe e mundësojnë sigurinë e nxënësve, i udhëzojnë dhe prijnë nxënësit gjatë evakuimit tek sheshi i lojërave.</p> </div> <p>Sigurimi i rrugës së evakuimit (kujdestarët e klasave)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kontrolloni sigurinë e nxënësve, vendosni për rrugën e evakuimit. - Prini nxënësit gjatë evakuimit (merrni listën e emrave të nxënësve) <p>Siguria pas evakuimit (kujdestarët e klasave)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kontrolloni numrin e nxënësve dhe sigurinë e tyre, pastaj bëni një raport. - Kërkoni për nxënës të humbur dhe shpëtojini. - Identifikoni nxënësit e lënduar dhe ofrojuni ndihmë të parë. - Kontaktoni prindërit. 	<p>[Për të gjitha lokacionet]</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kujdes nga objektet që bien dhe objektet që shemben. • Kontrolloni sigurinë e zonës përreth. • Largohuni nga muret dhe dritareve prej qelqi. • Dëgjoni lajmërimet nëpërmjet sistemit të adresimit të shkollës dhe qëndroni të qetë. • Filloni evakuimin duke i zbatuar udhëzimet e mësuesit më të afërt pranë juve. • Mbrojeni kokën (me libra, çanta, etj.) gjatë evakuimit. • Evakuoheni duke i zbatuar “katër parimet” (mos u shtyni, mos vraponi, mos bisedoni dhe mos u ktheni prapa). • Rreshtohuni tek zona e evakuimit (sheshi i lojërave). • Uluni qetësisht dhe prisni udhëzime.

(iii) Gjatë rrugës për në shkollë dhe kthimit nga shkolla (jashtë shkollës)

Gjendja	Veprimet e personelit të shkollës	Veprimet e nxënësve
Gjatë ndodhjes së tërmetit	<p>Udhëzime për nxënësit në shkollë (Drejtori, nëndrejtori)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prisni derisa të qetësohen dridhjet. 	<ul style="list-style-type: none"> • Mbulojeni kokën derisa dridhet toka (me libra, çanta, etj.), qëndroni palëvizur dhe prisni që të qetësohen dridhjet.

Gjendja	Veprimet e personelit të shkollës	Veprimet e nxënësve
After the shaking subsides	<p>I tërë personeli shkollor</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kontrolloni dhe kujdesuni për sigurinë e nxënësve në shkollë. - Kontrolloni sigurinë e nxënësve nëpër rrugët që i përdorin nxënësit për të udhëtuar në shkollë. - Kontrolloni sigurinë e nxënësve tek zona e evakuimit. • Nxënësit, siguria e të cilëve është verifikuar tek lokacionet e sipërpërmendur, duhet t'iu dorëzohen prindërve të tyre. • Nxënësit, prindërit e të cilëve nuk kanë qenë të arritshëm, duhet të kenë kujdesin e personelit në shkollë. • Nxënësit duhet të strehohen në objekte të komunitetit nëse është e mundur. Tentoni të ruani adresën dhe numrat e kontaktit për zonat në të cilat janë evakuar nxënësit. - Kontrolloni sigurinë e nxënësve në shtëpitë e tyre. - Grumbulloni dhe kontrolloni informacionet rreth sigurisë së nxënësve. - Kërkoni nxënësit siguria e të cilëve nuk është verifikuar, dhe informoni zjarrfikësit dhe policinë. - Merrni masa për lehtësimin e ankthit të nxënësve të cilët ende janë në shkollë. - Kontakttoni prindërit. 	<p>[Nxënësit në shkollë]</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kujdes nga objektet që bien dhe objektet që shemben. • Kontrolloni sigurinë e zonës përreth. • Largohuni nga muret e ndërtesave dhe dritaret e qelqit. • Dëgjoni lajmërimet që shpallen nëpërmjet sistemit publik të adresimit në shkollë dhe rrini të qetë. • Filloni evakuimin duke i zbatuar udhëzimet e mësuesit më të afërt pranë juve. • Mbrojeni kokën (me libra, çanta, etj.) gjatë evakuimit. • Evakuoheni duke i zbatuar “katër parimet” (mos u shtyni, mos vraponi, mos bisedoni, mos u ktheni prapa). • Rreshtohuni tek zona e evakuimit (sheshi i lojërave). • Uluni qetësisht dhe prisni udhëzime. <p>[Nxënësit nëpër rrugët që përdoren për të udhëtuar në shkollë]</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pasiqë qetësohen dridhjet, largohuni nga zona e evakuimit dhe kthehuni në shtëpi. • Nëse evakuimi nuk është i mundur, prisni në vend derisa të arrijnë prindërit, personeli shkollor dhe anëtarët e komunitetit. • Në zonat bregdetare, evakuoheni në vende më të larta si masë paraprake kundër cunamit. • Në zonat që ka mundësi të ketë rrëshqitje të dheut dhe rënie të shkëmbijve, largohuni në një vend të sigurt.


(iv) Gjatë udhëtimit në terren (jashta shkollës)

Veprimet e personelit të shkollës	Veprimet e nxënësve
<p>Personeli shoqërues</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prisni tek vendi derisa të qetësohen dridhjet. - Nëse jeni në autobus ose tren, zbatoni udhëzimet e ekuipazhit. - Bazuar në rrugët e evakuimit të objekteve dhe zonat e identifikuara të evakuimit gjatë një hulumtimi paraprak, prini nxënësit tek zona e evakuimit. - Kujdes nga fatkeqësitë dytësore si p.sh., cunami, shkëmbinj të bien dhe rrëshqitje të dheut. - Numëroni nxënësit dhe kontrolloni nëse ka të lënduar. - Ofroni trajtim emergjent. - Grumbulloni informacione si p.sh., për shkallën e fatkeqësisë, dëmet dhe gjendjen e lëndimeve. - Kontaktoni shkollën, lajmëroni për situatën dhe pranoni udhëzime. - Shfrytëzoni metoda të ndryshme të komunikimit (media) nëse nuk mund të kryhen thirrje telefonike. - Kujdesuni për nxënësit për lehtësimin e ankthit të tyre. 	<p>[Jashtë shkollës]</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbroni veten duke u larguar nga vendet që mund të shemben ose vendet që mund të kenë objekte që bien, etj. • Strukuni dhe mbrojeni kokën. <p>[Në shkollë]</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbroni veten duke u larguar nga vendet që mund të shemben ose vendet që mund të kenë objekte që bien, etj • Mbrojeni kokën. • Ruajeni qetësinë dhe evakuoheni nga ndërtesa. <p>[Në autobus ose tren]</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zbatoni udhëzimet e ekuipazhit dhe ruajeni qetësinë.
<p>Personeli në shkollë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lajmëron Bordin e arsimit për situatën. - Lajmëron prindërit për situatën. - Pranon udhëzime nga Bordi i arsimit dhe i bashkërendit punët siç duhet, si p.sh., kërkim të ndihmës nga organizatat publike lokale. 	

(v) Themelimi i shtabit të shkollës në raste tërmeti

Kur ndodh ose ka gjasa të ndodh një fatkeqësi tërmeti, themelohet një shtab me qëllim të garantimit të sigurisë së nxënësve, realizimit të evakuimit të shpejtë dhe minimizimit të lëndimeve trupore.

Në vijim është paraqitur diagrami i shtabit.



(vi) Rolet e shtabit të shkollës në rast tërmeti

Grumbullimi i informacioneve për dëmet

- Kontrollon statusin e dëmeve brenda shkollës.
Kontrollon nëse ka shpërthyer ndonjë zjarr dhe identifikoni dëmet e ndërtesave të shkollës, gazin, energjinë elektrike, ujin, telefonin, etj.
- Nxjerrja e fotografi.
Nxirrni fotografi të dëmeve.
- Merrni masa kundër depove të materialeve të rrezikshme duke e ndaluar hyrjen.
- Kuptojeni situatën në shkollë dhe zonën e shkollës, si dhe situatën e përgjithshme lidhur me fatkeqësinë.
Grumbulloni informacione rreth dëmeve të përgjithshme të shkaktuara nga fatkeqësia.

Menaxhimi i nxënësve që janë evakuar nga ndërtesat e shkollës

- Merrni masa për të lehtësuar ankthin e nxënësve që janë evakuar tek sheshi i lojërave, etj., dhe kontrolloni sigurinë e tyre.

Bëni që nxënësit të ndihen të sigurtë dhe mbani në vëzhgim që të mos ikin dikund vetë, duke i rreshtuar dhe duke e bërë të mundur të shikoni lehtësisht të gjithë nxënësit madje me një numër të vogël mësuesish.

Shefi i shtabit merr vendim për veprimet që duhet të merren pas evakuimit të ndërtesave të shkollës.

Verifikimi i informacioneve për sigurinë e nxënësve

- Verifikoni informacionet për sigurinë e nxënësve.
Çdo kujdestar klase, etj. mbledh informacione për sigurinë e nxënësve duke zbatuar metodë të përshtatshme për situatën dhe i **identifikon nxënësit që nuk janë të verifikuar**.
- Kontaktoni organizatat relevante.
Nëse ka nxënës, siguria e të cilëve nuk është verifikuar, kontaktoni prindërit, zjarrfikësit, policinë, etj.

Komunikimi me palët jashtë shkollës

Përgjegjuni pyetjeve të mediave, prindërve dhe faqesit (të gjitha këto pyetje duhet të trajtohen nga një person i posaçëm).

Komunikimi me organizatat relevante

Përpiloni raportet e nevojshme për Bordin e arsimit dhe shkollat fqinje.

Asistimi i organizimit dhe menaxhimit të zonës së evakuimit

Nëse shkolla përdoret si zonë evakuimi për komunitetin, ndihmoni në menaxhimin e zonës së evakuimit në bashkëpunim me organizatat tjera qeveritare, etj.

Shëmbull i Planit Shkollor Vjetor për DPE (DAF) (Programi edukativ për fatkeqësi) (Shkolla fillore XX)

Qëllimi edukativ i shkollës	Nxjtia e fëmijëve pse të tentojnë të përmirësojnë veten	Nxënësin të cilin synon ta krijoj arsimi	Fëmijë me pasuri të fuqishme fizike dhe psikike në gjendje për të mësuar
Qëllimet e Drejtorisë së arsimit fillor (DAF)	Mësoni çfarë mund të bëni për të mbrojtur jetën tuaj dhe atë të miqve. Trupi dhe mendja e fortë.	Mësoni të jeni mirënjohës dhe të dhembshëm.	

Periudha	Aktivitetet e drejtorisë	Kl e I-rë	Kl e II-të	Kl e III-të	Kl e IV-t	Kl e V-të	Kl e VI-të
Pr:	-Krijimi i planit vjetor për DAF	"Emergjencia! Çfarë duhet të bëni?" (Klasa e I-III) [Mësoni çfarë të bëni gjatë emergjencave]					
	-Stërvitje evakuimi (zjarr)	Mësimi rreth tërmeteve Vëll. 1					
	-Dita e vizitës së prindërve (skenari për tërmete)	[Çfarë ndodh kur godasin tërmetet]					
	-Stërvitje evakuimi me skenar të zjarrit	(Klasa I-III) [Përgatitja për stërvitje emergjente]					
Qer:	-Stërvitje për dorëzim-pranim të nxënësve	Mësimi rreth tërmeteve Vëll. 2					
	-Siguria e ujit	[Rëndësia e jetëve, mirëqenia e kafshëve] [Kuptimi ndërkombëtar]					
	-Trajnim emergjent për shpëtim të jetës	[Aktivitetet vullnetare]					
Kor:	-Inspektime në relacion me DAF	<i>Shënim: Programet edukative rreth fatkeqësive të përfshira në plan realizohen duke përdorur edhe përmbledhje të tjerë shtesë, etj. Ju lutemi shfrytëzoni përmbledhjet shtesë, etj., në vendin tuaj, kur realizoni edukimin rreth fatkeqësive në vendin tuaj.</i>					
	-Ligjeratë për reduktim të rrezikut gjatë fatk.	Trajtimet që mund ti bëni vetë					
	-Orë për parandalim të krimit	(Klasa I-III: edukatë shëndetësore, aktivitete klasore)					
	-Stërvitje evakuimi (kundër një individi të dyshimtë)	Mësimi rreth tërmeteve Vëll.3					
Dhj:	-Patrulla për kontroll të sigurisë në komunitet	[Shkëmbim në komunitet] [Aftësi për transmetim të informacioneve]					
	-Dita XX e qarkut për menaxhim me fatkeqësi	- Të bëjmë një hartë për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive dhe një çantë shpine emergjente					
Jan:	-Stërvitje evakuimi (tërmet)	Të gjithë nxënësit në shkollë ushtrojnë dhe e këndojnë së bashku këngën "Shiawase Hakoeru Youni (dëshirojmë të sjellim lumturi)" (një këngë e krijuar pas tërmetit). (Shënim: Janari është muaji kur ndodhi tërmeti i madh Hanshin-Awaji.)					
	-Inspektim i DAF pajisjeve në shkollë	Mësimi rreth tërmeteve Vëll. 4					
Mar:	-Stërvitje emergjente me komunitetin	[Fatkeqësi natyrore] [Fitim të njohurive, të kuptuarit]					
		[Reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive] [Fitim të njohurive, të kuptuarit]					

Shënim: Kjo është një mostër e planit edukativ gjatë fatkeqësive për një shkollë fillore në Qytetin Kobe, Japoni. Kur të bëni plane për shkollat në vendin tuaj, ju lutemi bëni ato sipas rrethanave të vendit tuaj.

Vizatimi i përfytyrimit tuaj të tërmetit

Mësoni leksione të fituara nga tërmeti

3

Përshkrimi i programit

Nxënësit bëjnë një vizatim të asaj se çfarë do t'i ndodhte qytetit nëse do të ndodhte një tërmet. Së pari, lërimi të bëjnë një vizatim pa mos iu dhënë asnjë informacion. Pastaj, jepuni informacione për tërmete nëpërmjet, fotografive, videove, etj. Në fund do ta krahasojnë vizatimin e tyre me realitetin, si dhe do t'i thellojnë njohuritë e tyre për tërmetet.

Qëllimi

Nxënësit do të kenë një imazh më të detajuar dhe më realistik për tërmetet.

Klasa	Lloji i mësimi	Vendi	Kohëzgjatja	Numri i nxënësve
E 1-rë, e 2-të	Leksion	Shkollë	1 orë akademike	1 klasë

Content

[Hyrje]

- (1) Nëse vendi juaj ka përjetuar tërmet, shpjegojeni situatën e asaj kohe.
Shënim: Nëse vendi juaj nuk ka përjetuar tërmet shpesh, atëherë këtë program mund ta realizoni për lloje të fatkeqësive, si p.sh., erupsim vullkani, ciklon, etj.



[Vizatimi]

- (2) Lërimi nxënësit të vizatojnë lirshëm përfytyrimin e një tërmeti.



[Prezantimi i vizatimeve]

- (3) Nxënësit ia tregojnë njëri tjetrit vizatimet. Përveç kësaj, kërkoni nga disa prej nxënësve të prezantojnë vizatimet e tyre dhe të shpjegojnë se çfarë përfytyrimi kanë paraqitur në vizatimet e tyre.



[Krahasimi me fotografi dhe video aktuale të tërmeteve]

- (4) Demonstroni fotografi dhe video të tërmeteve aktuale. Kërkoni prej tyre të prezantojnë gjetjet e juaja përfshirë dhe atë se çfarë kanë ndierë kur i kanë krahasuar vizatimet e tyre me fotografitë dhe videot reale.



[Të tjera]





- (5) Ky program iu dedikohet nxënësve në klasa të ulëta, mirëpo mund ta realizoni edhe për çdo klasë dhe të krahasoni vizatimet e nxënësve.








Çështje të rëndësishme gjatë dhënies së udhëzimeve

Shumë nxënës mund ta kenë të vështirë të vizatojnë sepse nuk kanë njohuri fillestare për tërmete, mirëpo është e rëndësishme t'i nxitni të bëjnë vizatimin e tyre me ato pak njohuri që i kanë.

Bashkëpunimi me organizata të tjera		
Ky është një program i lehtë për t'u realizuar nga vetë personeli shkollor.		
Si mund të përfshihet Komuniteti lokal (Organizata për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive)		
(1) Nëse pjesëtarët e Komunitetit kanë përjetuar tërmete, ata mund të flasin për përvojat e tyre gjatë prezantimit të fotografive dhe videove relevante.		
(2) Kërkoni prej tyre të përgatisin fotografi dhe video të tërmeteve.		
Ndihmë nga personeli zjarrfikës dhe Korpusi vullnetar zjarrfikës		
Ata mund të flasin për përvojat e tyre me tërmetet dhe punën e tyre në situatë kur ndodhin tërmete gjatë prezantimit të fotografive dhe videove relevante.		
Pajisjet dhe materialet e nevojshme (Pjesët dhe sasi të nevojshme)		
Emri i pajisjes/materialit	Sasia	Mund të përgatitet nga
Fletë vizatimi, fletë e madhe vizatimi	Numri i pjesëmarrësve x 2	Shkolla
Ngjyra lapsi, lapsa dylli, bojëra, etj.	Sasia e nevojshme	Shkolla
Video dhe fotografi të tërmeteve, etj.	1	Shkolla
Pëlhurë ekrani (nëse ka)	1	Shkolla
Projektor (nëse ka)	1	Shkolla
DVD player (nëse ka)	1	Shkolla
Vërejtje	Ju lutemi përgatitni një pëlhurë ekrani dhe projektor, nëse nevojitet.	
"Suvenire" për t'i marrë në shtëpi		
Lërinë nxënësit të marrin në shtëpi vizatimet që i kanë bërë dhe t'i përdorin ato në bisedat me anëtarët e familjeve të tyre.		
Informacione shtesë për këtë program		
Vizatimet për tërmetet mund të përfshijnë skena të llojllojshme si p.sh., ndërtesa të dëmtuara, viktima të tërmeteve dhe cunamit.		
Duke i lënë nxënësit të bëjnë vizatimin e tyre me informacione të pakta në dispozicion, nëpërmjet këtij programi mësuesit mund të mësojnë se çfarë nënkuptojnë tërmetet për nxënësit.		
Mësimet e fituara nga tërmetet dhe fatkeqësitë e tjera që kanë të bëjnë me këtë program		
Pas tërmetit, tek zonat e evakuimit, nuk organizohenin aktivitete që të argëtohen nxënësit, prandaj nxënësit bëhenin më të trishtuar çdo ditë. Në këtë situatë, një program për vizatim mund të jetë shumë efikas. (Mirëpo, ndoshta ky program nuk është i përshtatshëm për nxënësit e atyre zonave të cilat kanë qenë seriozisht të goditura nga tërmetet.)		
Variacionet		
Përveç vizatimit të tërmeteve, është gjithashtu ide e mirë të lëni nxënësit të bëjnë vizatime me tema të "shtëpive të sigurta" dhe "Gjësëndeve emergjente që duhet të merren me vete gjatë evakuimit."		

Stërvitja për raportim emergjent			Nxënësit fitojnë njohuri	4
“Telefononi XXX në raste të lëndimeve ose zjarrit!” (Zëvendësoni XXX me numrat telefonik emergjent në shtetin tuaj.)				
Përshkrimi i programit				
Së pari, nxënësit e mësojnë rëndësinë e raportimit dhe metodën e raportimit. Pastaj, bëjnë telefonata emergjente duke i shikuar fotografitë e situatave që kërkojnë raportime emergjente.				
Qëllimi				
Nxënësit do të fitojnë njohuri të nevojshme që qetësisht të bëjnë telefonata gjatë emergjencave dhe të mësojnë rreth raportimit të duhur emergjent.				
Klasa	Lloji i mësimi	Vendi	Kohëzgjatja	Numri i nxënësve
III-VI	Leksion	Shkollë	20 min.	1 klasë
Përmbajtja				
[Shpjegim fillestar] (1) Shpjegoni llojet e situatave ku nevojitet raportim emergjent, ku lidhen thirrjet emergjente, me çfarë procedurash mobilizohen kamionët zjarrfikës, etj.				
[Shpjegime rreth përmbajtjes së raportimit] (2) Ligjeroni metoden e saktë të raportimit para se t’i lërnë nxënësit të bëjnë telefonata emergjente. <ul style="list-style-type: none"> • A është zjarr apo situatë emergjente mjekësore? (Shënim: Disa shtete kanë numra të ndryshme për zjarrfikësit dhe ndihmën e shpejtë.) • Ku ndodhet vendi (adresa)? • A ka ndonjë pike referimi pranë vendit (ndonjë ndërtesë të madhe, etj. si p.sh., spital, stacion hekurudhor ose supermarket)? • Përshkruani situatën (kur, ku, kush ka bërë çfarë duke përdorur çfarë, që ka çuar deri ku). 				
[Stërvitja e raportimit] (3) Realizoni një stërvitje raportimi me nxënësit. <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësve iu prezantohen fotografi që ilustrojnë situata të llojllojshme dhe mësojnë të bëjnë thirrje emergjente për çdo situatë. (Shih referencën për fotografitë relevante.) 				
[Përmbledhja dhe vlerësimi] (4) Bëni përmbledhje të çështjeve të rëndësishme për t’u mbajtur mend dhe vlerësoni çështjet e dobëta të rezultateve nga stërvitja e raportimit emergjent. (5) Ofroni shpjegime shtesë (shih Përshkrimin).				
Çështje të rëndësishme gjatë dhënies së udhëzimeve				
(1) Në këtë program, nxënësit do të bëjnë telefonata emergjente si pjesë e stërvitjes së tyre. Mirëpo, duhet dhe t’u theksoni se kur të ndodh ndonjë rast emergjent në realitet, ato duhet t’u raportohen të rriturve sa më herët që është e mundur.				
(2) Krijoni mostra raportimit dhe vendosni pranë telefonave në mënyrë që njerëzit të rrinë të qetë kur të bëjnë telefonatë emergjente (shih Përshkrimin).				

Bashkëpunimi me organizata tjera		
Programin mund ta realizoni në mënyrë më efektive nëse mund të fitoni ndihmë nga personeli i stacionit zjarrfikës për përgatitjen e pajisjeve dhe materialeve, si dhe për udhëzime se si të realizohet raportimi emergjent.		
Si mund të përfshihet Komuniteti lokal (Organizata për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive)		
Ata mund të kenë rolin e dhomës së kontrollit që iu përgjigjet telefonatave emergjente. Gjithashtu, mund të demonstrojnë se si bëhet raportimi.		
Ndihma nga zjarrfikësit dhe Korpusi vullnetar zjarrfikës		
Programin mund të bëni më efikas nëse kërkoni nga personeli zjarrfikës ose anëtarët e korpusit vullnetar të zjarrfikës të luajnë rolin e personelit të dhomës së kontrollit (ata që i pranojnë telefonatat).		
Pajisjet dhe materialet e nevojshme (Pjesët dhe sasi të nevojshme)		
Emri i pajisjes/materialit	Sasia	Mund të përgatitet nga
Telefon (mund të përdoret një i prishur ose lodër)	1	Zjarrfikësit, shkolla
Fotografi që ilustrojnë situata të ndryshme (shih Referencën)	4-5 fotografi	Zjarrfikësit, shkolla
Vërejtje		
"Suvenirë" për t'i marrë në shtëpi		
Kërkoni nga nxënësit të flasin me prindërit e tyre për atë që e kanë mësuar.		
Si mund të marrin pjesë prindërit		
(1) Nëse është e mundur, kërkoni që prindërit në fillim të demonstrojnë se si bëhet raportimi. (2) Duke kërkuar nga prindërit që të luajnë rolin e personelit të dhomës së kontrollit, ata mund të marrin pjesë në stërvitjen së bashku me nxënësit.		
Informacione shtesë rreth këtij programi		
Kur bëni një telefonatë emergjente në situatë reale, ekzistojnë raste kur njerëzit nuk mund të raportojnë siç duhet për shkak të panikut. Tentoni të rrini të qetë gjatë telefonatës emergjente.		
Variacionet		
Vizita e dhomës së kontrollit para ose pas stërvitjes do t'u ndihmojë nxënësve të kuptojnë çfarë kanë mësuar realisht.		
Komente të nxënësve që kanë marrë pjesë në program (në Japoni)		
<ul style="list-style-type: none"> • U pengova sepse ishte hera e parë që kisha bërë telefonatë emergjente. Mendoj se do të jetë shumë shqetësuese në situatë reale. • Më vjen mirë që isha në gjendje të bëj raportim të mirë. • Pyetem se çfarë do të ndodhte nëse do të kishte një telefonatë të rremë. • Kuptova se si të bëj telefonatë emergjente. • Mendoj se mund të zbatoj përvojën e sotme nëse ndodh ndonjë gjë. 		

Eksplorimi i shkollës për gjetjen e resurseve për reduktim të rreziqeve gjatë fatkeqësive			Nxënësit fitojnë njohuri	5
Përshkrimi i programit				
Nxënësit e eksplorojnë shkollën për gjetjen e pajisjeve për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive, dhe rezervave dhe pajisjeve emergjente të magazinuara për raste kur shkolla përdoret si zonë emergjente.				
Qëllimi				
Nxënësit do të mësojnë për resurset që përdoren për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive në shkollë dhe për rolin e shkollave si zonë evakuimi.				
Klasa	Lloji i mësimt	Vendi	Kohëzgjatja	Numri i nxënësve
III-VI	Leksion	Në shkollë	Periudha e parë	1 klasë
Përmbajtja				
[Shpjegime fillestare] (1) Shpjegoni llojet e resurseve të cilat mund të përdoren në emergjenca si p.sh., pajisjet për zjarrfikje, materialet dhe pajisje të tjera për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive, rezervat, etj.				
[Shpjegime rreth pajisjeve për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive] (2) Shpjegoni pajisjet për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive të magazinuara në shkollë si p.sh., bombolat e gazit zjarrfikës, hidrantet e ujit brenda shkollës, sistemin automatik për alarmim të zjarrit, daljet në raste zjarri, etj. (Shkolla të ndryshme posedojnë pajisje të ndryshme.)				
[Përgatitja për eksplorim] (3) Realizoni përgatitje për fillimin e eksplorimit. <ul style="list-style-type: none"> Nëse është e mundur, ndani pjesëmarrësit në grupe. Jepuni materiale para kohe për të plotësuar atë se çfarë kanë gjetur si p.sh., kopje të hartës së shkollës. 				
[Fillimi i eksplorimit] (4) Shpjegoni çështjet e rëndësishme që duhet të mbahen mend gjatë eksplorimit (shënime për menaxhim me sigurinë). (5) Secili grup e eksploron shkollën.				
[Prezantimi i gjetjeve] (6) Nxënësit e prezantojnë atë që e kanë zbuluar. <ul style="list-style-type: none"> Personeli shkollor duhet t'iu tregojë nxënësve për gjërat që nxënësit nuk i kanë gjetur. Diskutoni sendet që mund të jenë të nevojshme në emergjenca, nëse ka, krahas pajisjeve për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive. 				
Çështje të rëndësishme gjatë dhënies së udhëzimeve				
Secila shkollë ka pajisje të ndryshme. Personeli shkollor duhet t'i kontrollojë pajisjet para kohe. Shfrytëzoheni këtë rast të verifikoni çfarë posedon shkolla sepse personeli shkollor duhet të ketë njohuri për pajisjet e magazinuara në shkollë.				

Bashkëpunimi me organizata tjera		
Programi do të kishte më shumë kuptim nëse shërbimi i zjarrfikësve dhe prindërit do të ndihmonin me shpjegimet dhe menaxhimin e sigurisë.		
Si mund të përfshihet Komuniteti lokal (Organizata për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive)		
Programi do të ishte më efikas nëse anëtarët e komunitetit qëndrojnë pranë vendeve ku janë të vendosur pajisjet me qëllim të dhënies së shpjegimeve për nxënësit.		
Ndihma nga zjarrfikësit dhe Korpusi vullnetar zjarrfikës		
Ata japin sqarime rreth pajisjeve dhe udhëzime sesi të përdoren pajisjet.		
Pajisjet dhe materialet e nevojshme (Pjesët dhe sasi të nevojshme)		
Emri i pajisjes/materialit	Sasia	Mund të përgatitet nga
Hartë të shkollës	1 kopje për pjesëmarrës	Shkolla, zjarrfikësit
Vërejtje	Shkollat janë të caktuara si zona evakuimi varësit nga rajoni. Nëse shkolla është e caktuar si zonë evakuimi, shpjegojeni funksionin e shkollës në cilësi të zonës së evakuimit.	
"Suvenire" për t'i marrë në shtëpi		
Lërimi nxënësit të marrin në shtëpi letrën (shih Referencën) në të cilën i kanë shkruar rezultatet e aktivitetit "Eksplorimi i shkollës për gjetjen e resurseve për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive." Udhëzoni nxënësit t'ua sqarojnë prindërve të tyre funksionin e shkollës si zonë evakuimi për të cilën gjë mësuar nga ky program.		
Informacione shtesë rreth këtij programi		
Edhe pse nxënësit nuk do t'i përdornin pajisjet në realitet, ky program mund të jep mundësi për nxënësit të interesohen për reduktimin e rrezikut gjatë fatkeqësive nëpërmjet njohjes së pajisjeve për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive në shkollë dhe në komunitet. Programet gjithashtu mund të ofrojnë një mundësi për nxënësit dhe prindërit e tyre të bisedojnë rreth reduktimit të rrezikut gjatë fatkeqësive dhe gatishmërinë e tyre në shtëpi, nëpërmjet shkëmbimit të njohurive të tyre, që i kanë mësuar në shkollë, me prindërit e tyre.		
Mësime të fituara nga tërmetet të kaluara dhe fatkeqësi të tjera që kanë të bëjnë me këtë program		
Gjatë tërmetit të madh Hanshin-Awaji (që e goditi Koben), pati shumë vështirësi tek zonat e evakuimit (shkollat) dhe u nxorrën shumë mësime nga ajo përvojë. Rrjedhimisht, u magazinuan rezerva të ushqimit dhe batanie, si dhe u instaluan sisteme për furnizim me ujë, tualete të përkohshme, etj. në çdo shkollë të Kobes. Është me rëndësi të dihet për ekzistimin e këtyre rezervave dhe objekteve të tjera, mirëpo gjithashtu është e rëndësishme të fitohen njohuri dhe shkathtësi të nevojshme për përdorim efektiv të këtyre gjësive në emergjencë (nëpërmjet realizimit të stërvitjeve për zjarr, etj.)		
Variacionet		
Gjithashtu mund të organizoni gara se cili ekip do të gjej më shumë bombola gazi zjarrfikës. Pastaj, Programi 8 "Loja me gjuajtje në cak me bombola uji zjarrfikës" mund të realizohet duke e shfrytëzuar kohën e mbetur.		
Komente të nxënësve që kanë marrë pjesë në program (në Japoni)		
<ul style="list-style-type: none"> • Tani e di se sa bombola gazi zjarrfikës ka në shkollë. • Kishte dy bombola tek kuzhina e shkollës. Kjo është kështu sepse kuzhina e shkollës përmban rrezik. • Kishte oriz, biskota, ushqim të konservuar dhe ujë në rast të tërmetit. Më la përshtypje. • Pyetem nëse të gjithë mund të futen në palestër. Duhet të bëj aktivitete vullnetare. 		

Shëtitja nëpër qytet për të gjetur resurse për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive

Nxënësit fitojnë njohuri

6

Përshkrimi i programit

Nxënësit ecin nëpër qytet për të zbuluar vende të rrezikut dhe të mësojnë se ekzistojnë objekte të dobishme për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive në qytet, si p.sh. depo dhe materiale për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive, çisterna dhe pompa kundër zjarrit.

Qëllimi

Nxënësit do të mësojnë për nevojën dhe metodat e të qenurit të gatshëm gjatë fatkeqësive, të cilat janë të përshtatshme për qytetin e tyre.

Klasa	Lloji i mësimit	Vendi	Kohëzgjatja	Numri i nxënësve
III-VI	Leksion	Terren (brenda zonës së shkollës)	90 min.	1 klasë ose më shumë

Përmbajtja

[Përgatitja]

- Përgatitni kopje të hartës bazë për zonën shkollore. Nëse është e nevojshme, ndani në grupe pjesëmarrësit.
- Këshillohuni me komunitetin lokal dhe stacionin e zjarrfikësve, dhe hulumtoni para kohe resurset, pajisjet dhe objektet për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive në qytet.



[Shpjegime fillestare]

(1) Jepni sqarime për llojet e objekteve, pajisjeve dhe materialeve para se të filloni shëtitjen.



[Objektet dhe pajisjet për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive] Hidrante uji, depo për çisterna uji, shenja që tregojnë zonat e evakuimit (shenjat mund të gjenden edhe në shkollë), etj.

[Resurset për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive] Zonat e evakuimit, objektet afariste (supermarkete, fabrika, etj.) spitale, pellgje, lumenj, etj.

Diskutoni se çfarë lloje të rrezikut, resurseve, pajisjeve dhe objekteve për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive mund të konsiderohen para kohe, nëse lejton koha.



[Shëtitja në qytet]

(2) Nxënësit ecin nëpër qytet.



[Krijimi i hartës së sigurisë dhe prezantimi]





- (3) Nxënësit krijojnë hartë sigurie bazuar në hartat mbi të cilat nxënësit i fusin të dhënat që i kanë zbuluar.
- (4) Kur të kompletohet harta e sigurisë, nxënësit e prezantojnë atë. Pyetjet që kanë patur ndër mend t'i parashtrojnë gjatë shëtitjes, le t'i parashtrojnë gjatë prezantimeve.



Çështje të rëndësishme gjatë dhënies së udhëzimeve

- (1) Lërin nxënësit të mësojnë se ka shumë objekte të përgatitura në vende publike për raste emergjente.
- (2) Ekziston një numër i pakufizuar i resurseve për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive nëse njeriu e përdor imagjinatën. Mësuesit duhet të përdorin zgjuarsinë e tyre për t'i lënë nxënësit të gjejnë sa më shumë resurse për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive.

Bashkëpunimi me organizata tjera		
Ky aktivitet realizohet në terren më të gjerë. Prandaj, rekomandohet që shkolla ta realizojë këtë aktivitet në bashkëpunim me Komunitetin lokal (organizata për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësisë), prindërit, zjarrfikësit, etj.		
Si mund të përfshihet Komuniteti lokal (Organizata për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësisë)		
Kërkoni prej tyre të ecin në qytet me fëmijët ose le të presin tek objektet dhe të japin sqarime.		
Ndihmë nga zjarrfikësit dhe Korpusi vullnetar zjarrfikës		
Ata mund të japin sqarime për zonat e rrezikut, objektet për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive, pajisjet dhe resurset.		
Pajisjet dhe materialet e nevojshme (Pjesët dhe sasi të nevojshme)		
Emri i pajisjes/materialit	Sasia	Mund të përgatitet nga
Hartë (për të ecur nëpër qytet)	1 për çdo nxënës ose grup	Shkollë
Fletë vizatim të madh (për krijimin e hartës së sigurisë)	1 për grup	Shkollë
Marker (për krijimin e hartës)	1 komplet për grup	Shkollë
Letra ngjitëse (post-it) (për krijimin e hartës)	1 komplet për grup	Shkollë
Gazetë (për të vendosur mbi të fletë vizatimin)	1 komplet për grup	Shkollë
Vërejtje	Nëse nuk krijohet harta e sigurisë, atëherë programi mund të realizohet vetëm duke i përdorur hartat themelore dhe instrumentet për shkrim.	
"Suvenire" për t'i marrë në shtëpi		
Udhëzoni nxënësit t'i marrin me vete në shtëpi të dhënat që i kanë zbuluar gjatë ecjes nëpër qytet ("zonat e rrezikut," "pajisjet dhe objektet për red. të rrez. gjatë fatkeq.," "resurset për red. të rrez. gjatë fatkeq.," etj.) dhe t'ua përcjellin prindërve (shih Referencën).		
Informacione shtesë rreth këtij programi		
Përveç zonave të rrezikut lidhur me tërmetet dhe fatkeqësitë e tjera të mëdha, gjithashtu mund të përfshini të dhëna për zona rreziku që mund të përballen gjatë jetës së përditshme, si p.sh., pikat e zeza të trafikut, vende ku janë vërejtur njerëz të dyshimtë, shkëmbinj dhe rezervuare, në mënyrë që fëmijët të mësojnë nevojën për të patur kujdes nga rreziqet e jetës së përditshme.		
Variacionet		
Nëse informacionet lidhur me "lokalitetet historike në qytet" dhe "parandalimin e krimit" përfshihen në gjërat që duhet të gjenden gjatë shëtitjes në qytet, si dhe aktiviteti kryhet në bashkëpunim me komunitetin lokal (organizata për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive), atëherë shkolla do të thellojë bashkëpunimin me komunitetin.		
Çështje të rëndësishme		
(1) Kur nxënësit ecin nëpër qytet, nevojitet një numër i madh i të rriturve për menaxhim të sigurisë. (2) Mësoni nxënësit t'i respektojnë rregullat e trafikut dhe kujdesuni mos përballen me ndonjë rrezik.		
Komente të nxënësve që kanë marrë pjesë në program (në Japoni)		
<ul style="list-style-type: none"> • U befasova sepse ekzistonin aq shumë gjëra. - U habita kur e gjeta një rezervuar uji nën park. • Kishte helmetë dhe lopata në një depo pajisjesh. • Pyes veten se për çfarë përdoren tokmakët në deponë e pajisjeve. • Mendoj se do të jemi në rregull kur të godas ndonjë tërmet nëse mbajmë në mend atë që mësuam sot. 		

Evakuoheni sigurtë dhe qetë! (Stërvitja për evakuim)			Nxënësit fitojnë njohuri	7
Përshkrimi i programit				
Në shkolla, shumë njerëz përfshirë dhe nxënësit duhet të jenë në gjendje të evakohen shpejtë në rast të zjarrit ose tërmetit. Kjo aftësi testohet nëpërmjet stërvitjeve për evakuim që të sigurohemi se njerëzit mund të evakohen në mënyrë efektive gjatë emergjencave.				
Qëllimi				
Nxënësit do të fitojnë njohuri dhe shkathtësi për t'u evakuar në mënyrë të sigurtë nëpërmjet realizimit të një stërvitjeje në rast të emergjencës.				
Klasa	Lloji i mësimi	Vendi	Kohëzgjatja	Numri i nxënësve
Të gjithë	Stërvitje	Jashtë	20 min.	1 klasë ose tërë shkolla
Përmbajtja				
[Të mësuarit e metodës së saktë të evakuimit]				
(1) Nxënësit mësojnë metodën e saktë të evakuimit në rast të tërmetit dhe zjarrit para stërvitjes. (Jepni sqarime për metodën pas stërvitjes, nëse stërvitja duhet të realizohet pa paralajmërim.)				
[Shpallja e fillimit të stërvitjes]				
(2) Fillimi i stërvitjes shpallet me përdorimin e ziles dhe sistemin shkollor të adresimit publik. Fillimi gjithashtu mund të shpallet edhe me zë të lartë.				
[Fillimi i evakuimit]				
(3) Nxënësit fillojnë të evakohen në klasa duke i zbatuar udhëzimet e personelit shkollor. Realizojeni stërvitjen duke i respektuar rregullat vijuese "Mos u shtyni, mos vraponi, dhe mos flisni" me qëllim të parandalimit të aksidenteve (p.sh., të mos bien njëri mbi tjetrin) nga nxitimi i tepërt, megjithëse është e rëndësishme që të evakuoheni shpejtë.				
[Verifikimi i përfundimit të evakuimit]				
(4) Kur të gjithë të jenë evakuar te sheshi i lojërave, etj., personi shkollor i numëron nxënësit dhe i raporton drejtorit ose nëndrejtorit të shkollës me qëllim të kontrollimit nëse dikush nuk është evakuar. Mateni kohën që nevojitet për të përfunduar evakuimin.				
[Rezultatet e raportimit]				
(5) Kur të arrijnë ata që e kanë rolin e zjarrfikësve, drejtori ose nëndrejtori ua raporton situatën (si p.sh., zanafillën e zjarrit, përhapjen e zjarrit, nëse dikush nuk është evakuar, etj.) (6) Drejtori ose nëndrejtori (edhe personeli zjarrfikës, nëse janë aty) i shpallin rezultatet.				
Çështje të rëndësishme gjatë dhënies së udhëzimeve				
Bëjeni stërvitjen e evakuimit më efektive duke e realizuar në kombinim dhe me programe të tjera, etj.				

Bashkëpunimi me organizata tjera		
Ky program është e mundur të realizohet dhe vetëm me personelin e shkollës, mirëpo bashkëpunimi me Komunitetin lokal dhe stacionin e zjarrfikësve, si dhe shtimi i variacioneve mund ta avancojë programin edhe më tutje.		
Si mund të përfshihet Komuniteti lokal (Organizata për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive)		
(1) Ato mund të ndihmojnë me realizimin e programeve të tjera pas përfundimit të stërvitjes së evakuimit. (2) Mund të realizojnë një stërvitje për dorëzim-pranimin e nxënësve të prindërit pas përfundimit të stërvitjes së evakuimit.		
Ndihmë nga zjarrfikësit dhe Korpusi vullnetar zjarrfikës		
Kërkoni prej tyre të komentojnë për stërvitjen dhe të ndihmojnë me programet tjera, nëse ka programe të tilla.		
Pajisjet dhe materialet e nevojshme (Pjesët standard dhe sasi)		
Emri i pajisjes/materialit	Sasia	Mund të përgatitet nga
Megafon	1	Shkolla
Orë (kronometër)	1	Shkolla
Makinë për tym, kuti për tym, etj. (nëse ka)	1	Zjarrfikësit, etj.
Informacione shtesë për këtë program		
Me qëllim që njerëzit brenda të evakohen në mënyrë të sigurtë dhe qetë, ndërtesat e mëdha siç janë shkollat janë të pajisura me mjete të llojllojshme për zjarrfikje. Kontrolloni paraprakisht se çfarë mjeteesh janë në dispozicion (si .p.sh dyer kundër zjarrit, drita për dalje emergjente, sistemi automatik i alarmit, sistemi për shpallje emergjente, shkallë shpëtimi, sistem për thithjen e tymit, etj.) Rregullat themelore që duhet zbatuar nga nxënësit janë "Mos u shty, mos vrapo, mos flit."		
Mësimet e fituara nga tërmetet e mëhershme dhe fatkeqësitë e tjera lidhur me këtë program		
Parimi thelbësor në emergjenca është "mbrojtja e trupit dhe jetës tënde." Kjo është gjëja e parë që njerëzit duhet të bëjnë në emergjenca. Veçanërisht, kjo duhet të mësohet në arsim fillor pa asnjë përjashtim. Prandaj, është me rëndësi për nxënësit të mësojnë një metodë për mbrojtjen e vetes së tyre nëpërmjet stërvitjes së evakuimit.		
Variacionet		
(Për çdo skenar)		
Ndani pjesëmarrësit në grupe dhe caktoni një liderët e grupeve. Para se të fillohet me stërvitjen e evakuimit, lërin nxënësit t'i kontrollojnë dyert në rast zjarri, etj. dhe të mendojnë se cila rrugë është më e sigurtë për arratisje gjatë evakuimit. Pastaj, kërkoni që çdo grup të prezantojë konkluzionet e tyre.		
(Zjarre)		
Një mënyrë për të realizuar stërvitje evakuimi është të përdoret makina ose kutia për tym, të cilat prodhojnë tym të padëmshëm dhe pa aromë, me qëllim që pjesëmarrësit të përjetojnë evakuimin nëpër tym.		
(Tërmete)		
Para se të filloni me evakuimin, realizoni trajnim për nxënësit sesi të mbrojnë veten e tyre (zvarritja nën banka).		
Disa rrugë mund të jetë e pamundur të kapërcehen sidomos në rast të tërmeteve. Prandaj, ndalimi i qarkullimit në disa zona është mënyrë e mirë për të bërë stërvitjen efikase.		
Çështje të rëndësishme		
Një numër i madh njerëzish lëvizin njëkohësisht gjatë stërvitjeve. Zbatoni rregullat "Mos u shtyni, mos vraponi dhe mos flitni" dhe kujdeseni për veten tuaj që të parandaloni aksidentet (rrëzimet).		

Lojë me qitje në objektiv duke përdorur Bombola uji zjarrfikës

Nxënësit fitojnë shkathhtësi

8

Përshkrimi i programit

Nxënësit mësojnë si t'i përdorin bombolat e ujit dhe kënaqen me lojën duke realizuar qitje në objektiv.

Qëllimi

Nxënësit do të fitojnë njohuri dhe do të interesohen për reduktimin e rrezikut gjatë fatkeqësive nëpërmjet përdorimit të bombolave të ujit zjarrfikës në lojë.

Klasa	Lloji i mësimi	Vendi	Kohëzgjatja	Numri i nxënësve
III-VI	Trajnim praktik	Jashtë	20 min.	1 klasë

Përmbajtja

[Përgatitja]

- Përgatitni bombolat me ujë zjarrfikës dhe një kompresor (mund të përdoret çfarëdolloj bombe uji e dedikuar për stërvitje).
- Përgatitni caqet/objektivat.



[Krijimi i caqeve interesante]

Duke krijuar caqe interesante të llojllojshme, nxënësit do të mësojnë si të përdoren bombolat e gazit zjarrfikës (me ujë) dhe të argëtohen, për shembull, rrëzimin e topave, rrëzimin e paneleve, përdorimin e shisheve PET si caqe, etj.



[Shpjegime për përdorimin e bombolave të zjarrit]

- (1) Mësojini nxënësit për mekanizmin e bombolave të zjarrit dhe si t'i përdorin bombolat duke përdorur një model standard të bombolave, një bombolë të vërtetë zjarrfikës, etj.



[Fillimi i lojës]

- (2) Realizojeni lojën me qitje në objektiv. Gjeni mënyra për të bërë lojën interesante për nxënësit të cilët e presin rradhën e tyre që edhe ato të përqendrohen në këtë aktivitet.



[Shpjegime për çështjet që duhet mbajtur mend]






- (3) Shpjegojeni tërësisht dallimin ndërmjet bombolës së ujit që përdoret për stërvitje dhe bombolës së vërtetë me gaz zjarrfikës (si p.sh., kohën e nxjerrjes dhe distancën). Udhëzoni nxënësit që të kërkojnë ndihmë nga të rriturit pranë tyre në rast të shpërthimit të një zjarri të vërtetë sesa të rrezikojnë vetë të luftojnë me zjarrin.



Çështje të rëndësishme gjatë dhënies së udhëzimeve

- (1) Shpjegojeni tërësisht dallimin ndërmjet bombolës së ujit që përdoret për stërvitje dhe bombolës së vërtetë me gaz.
- (2) Udhëzoni nxënësit të njoftojnë menjëherë të rriturit pranë tyre nëse hasin në ndonjë zjarr të vërtetë.

Bashkëpunimi me organizata tjera		
Ky program kërkon ndihmën e zjarrfikësve ose organizatave të ngjashme lidhur me përgatitjen e pajisjeve dhe materialeve.		
Si mund të përfshihet Komuniteti lokal (Organizata për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive)		
Kërkoni nga Komuniteti lokal (organizata për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive) të jep shpjegime rreth përdorimit të bombolave zjarrfikës.		
Ndihmë nga zjarrfikësit dhe Korpusi vullnetar zjarrfikës		
Kërkoni prej tyre të përgatisin bombolat dhe caqet, si dhe të japin shpjegime të hollësishme rreth bombolave.		
Pajisjet dhe materialet e nevojshme (Pjesët dhe sasi të nevojshme)		
Emri i pajisjes/materialit	Sasia	Mund të përgatitet nga
Bombolë uji zjarrfikës për stërviçje	1 për 2-3 pjesëmarrës	Zjarrfikësit, etj.
Kompresor	1	Zjarrfikësit, etj.
Rezervuar uji (nuk duhet nëse uji merret direkt nga rubinetat)	1	Zjarrfikësit, etj.
Model standard i bombolës së gazit zjarrfikës (nëse ka)	1	Zjarrfikësit, etj.
Caqe për qitje me bombola uji	1	Zjarrfikësit, etj.
Vërejtje	Realizojeni programin në pajtim me rrethanat e vendit tuaj, nëse bombolat e gazit në vendit tuaj kanë metoda të tjera të përdorimit.	
"Suvenirë" për t'i marrë në shtëpi		
Shfrytëzoni këtë rast të kërkoni prej nxënësve të kontrollojnë nëse kanë bombola gazi zjarrfikës në shtëpitë dhe lagjen e tyre, çfarë lloji janë dhe ku janë të vendosura.		
Informacione shtesë për këtë program		
Më poshtë janë dhënë dallimet ndërmjet bombolës me ujë zjarrfikës dhe bombolës së vërtetë gazi zjarrfikës.		
<ul style="list-style-type: none"> • Përmbajtja (bombola e vërtetë është e mbushur me agjentë për zjarrfikje.) • Koha e nxjerrjes (rreth 30 sekonda për bombolën e ujit, kurse rreth 15 sekonda për bombolën e gazit zjarrfikës me pluhur) • Distanca e nxjerrjes (distanca efikase për bombolat e ujit është 8 metre, kurse distanca efikase për bombolën e gazit zjarrfikës me pluhur është rreth 2-3 metre.) 		
Variacionet		
Loja mund të organizohet në formë gare ku pjesëmarrësit do të ndahen në ekipe dhe çdo ekip garon me të tjerët për kohën më të shkurtër të nevojshme për të qëlluar të gjitha caqet. Kjo do t'ju mundësojë të gjithëve të përqendrohen në lojë sepse do të interesohen në kohën e ekipeve të tjera kur ato janë duke lozur.		
Komente të nxënësve që kanë marrë pjesë në program (në Japoni)		
<ul style="list-style-type: none"> • Loja kishte caqe interesante. • Dëshiroj prap të luaj. • Kuptova mirë sesi përdoren bombolat zjarrfikës. • Mendoj se mund të përdor një bombolë zjarrfikës kur të ketë një zjarr të vërtetë. • Më vjen mirë që dolëm kampione (në lojë garash). 		

Përjetimi i transportimit të një personi duke përdorur batanie			Nxënësit fitojnë shkathtësi	9
Përshkrimi i programit				
Nxënësit krijojnë një barelë të përkoshme duke përdorur objektet e përditshme si p.sh., shtizat e lavanderisë, shtiza të bambusë, batanie dhe e transportojnë një person. Gjithashtu mësojnë si t'i transportojnë të sëmurët dhe të lënduarit nëse koha lejon.				
Qëllimi				
Nxënësit do të mësojnë se objektet e përditshme mund të jenë të dobishme nëse krijohen mënyra të mira të përdorimit të tyre. Gjithashtu do të mësojnë për rëndësinë e ndihmës dhe bashkëpunimit të ndërsjellë.				
Klasa	Lloji i mësimit	Vendi	Kohëzgjatja	Numri i nxënësve
III-VI	Trajnim praktik	Indoors/outdoors	20 min.	1 klasë ose më shumë
Përmbajtja				
[Shpjegime për situata në rast tërmeti] (1) Jepni shpjegime se të plagosurit ishin të transportuar me metoda të ndryshme gjatë tërmetit të madh Hanshin-Awaji (duke përdorur batanie, dyer, tatami shtresa, etj.)				
[Shpjegime se si të krijohet një barelë] (2) Shpjegoni sesi të krijohet një barelë prej batanie (shih Referencën).				
[Krijimi i barelës] (3) Lërimi nxënësit të bëjnë një barelë prej batanie.				
[Transportimi i një personi] (4) Një pjesëmarrës luan rolin e personit të sëmurë/plagosur, i cili shtrihet mbi barelë, kurse të tjerët e bartin barelën. (Kujdesuni që mos bie personi që e transportoni. Është më e sigurtë që të bartni një 'kukull' për të realizuar trajnimin se sa të bartni një person, nëse ka kukull).				
[Komente dhe vlerësime] (5) Kërkoni nga nxënësit që luajtën rolin e personave të plagosur të komentojnë. (6) Lërimi nxënësit të luajnë rolin e të plagosurit/sëmurit (ata që barten me barelë) me rradhë kështu që të gjithë pjesëmarrësit të përjetojnë rolin.				
Çështje të rëndësishme gjatë dhënies së udhëzimeve				
Është e rëndësishme t'i mësoni nxënësit se çdo objekt i përditshëm mund të bëhet i dobishëm nëse përdoret në mënyrë të duhur duke iu treguar nxënësve disa shembuj të objekteve të përditshme, të cilat mund të përdoren për të krijuar barelë. (Për shembull, një person mund të bartet duke përdorur vetëm batanie ose barela mund të krijohet duke përdorur rroba dhe shtiza/shkopinj.)				

Bashkëpunimi me organizata tjera		
Rekomandohet që ky program të realizohet në bashkëpunim me Komunitetin lokal (Organizatën për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive) dhe zjarrfikësit në ato raste ku është vështirë për shkollën të përgatit materialet dhe pajisjet. Bashkëpunimi i tillë është poashtu i dobishëm sepse nevojitet një numër i madh i personelit për shpjegimet dhe menaxhim të sigurisë.		
Si mund të përfshihet Komuniteti lokal (Organizata për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive)		
Kërkoni prej tyre të përgatisin pajisjet dhe materialet, të japin shpjegime sesi bëhet një barelë dhe kryejnë menaxhim të sigurisë.		
Ndihma nga zjarrfikësit dhe Korpusi vullnetar zjarrfikës		
Ata i japin udhëzime paraprake personelit shkollor dhe komunitetit lokal (org. për red. të rrez. gjatë fatkeqësive) sesi të krijojnë barelat prej batanieve. Ata gjithashtu ndihmojnë me menaxhimin e sigurisë dhe përgatitjen e pajisjeve dhe materialeve në ditën e trajnimit.		
Pajisjet dhe materialet e nevojshme (Pjesët dhe sasi të standarde)		
Emri i pajisjes/materialit	Sasia	Mund të përgatitet nga
Batanie	1 për 4-5 pjesëmarrës	Shkolla, zjarrfikësit
Shtiza/shkopinj (bamboo, lavanderie, këmbalka, etj.)	2 për batanie	Shkolla, zjarrfikësit
Kukull (nëse ka)	1 për batanie	Zjarrfikësit, etj.
Barelë/material mbi të cilën do të bartet personi, siç është dërrasa	1 për secilin	Nëse mund të përgatitet
Vërejtje	Ky program gjithashtu mund të realizohet duke përdorur vetëm batanie	
"Suvenire" për t'i marrë në shtëpi		
Udhëzoni nxënësit t'iu tregojnë prindërve për atë që kanë mësuar në shkollë përfshirë dhe si të bëjnë barelë prej batanie dhe gjërat që mund të përdoren si barelë, kur të kthehen në shtëpi.		
Informacione shtesë për këtë program		
<p>(1) Kur të bartni një kukull ose njeri me barelë, e cila është bërë me shtiza dhe batanie, batania mund të rrëshqas nga shtizat nëse kukulla ose personi janë tepër të lehtë sepse fërkimi ndërmjet sipërfaqeve të kontaktit të batanies është shumë i vogël.</p> <p>(2) Në thelb, një person duhet të bartet duke e mbajtur pozitën e kokës pak më lartë, edhe pse kjo varet nga lëndimi.</p> <p>(3) Të ecurit me hapa ritmik duke thënë "një, dy, një, dy" kur bartet personi i lënduar/plagosur mund të minimizojë dridhjet që mund t'i ndiejë i plagosuri.</p>		
Çështje të rëndësishme		
<p>(1) Kur një person të luaj rolin e të sëmurit/plagosurit, kini kujdes mos të bjer, si dhe barelën ngriheni lehtësisht.</p> <p>(2) Kur nxënësit ngritin një person ose kukull, udhëzoni mos shtrëngohen shume dhe ta ngrejtnë atë duke përdorur qëndrimin e duhur të trupit (shpinën drejt dhe ta ngrejtnë duke i përdorur muskujt e këmbëve), që të parandalojnë lëndime të shpinës, etj.</p>		
Komente të nxënësve që kanë marrë pjesë në program (në Japoni)		
<ul style="list-style-type: none"> • Lehtë ishte. • U habita kur pashë sesa lehtë bëhej barela. • Mendoj se batania mund të rrëshqas nëse një njeri 200kgsh shtrihet mbi të • Më vjen mirë që tani mund t'ju ndihmoj njerëzve. • Ishte mirë që ushtrova bartjen e njerëzve të plagosur në rast se ndodh një tërmet. 		

Të ushtrime të trajtimeve lëndimet trupore

Nxënësit fitojnë shkathtësi

10

Përshkrimi i programit

Nxënësit ushtrjnë trajtimin e lëndimeve trupore duke përdorur fasha trekëndore në mënyra të ndryshme dhe duke zbatuar metoda të ndryshme për të ndërprerë gjakderdhjen, gjë që mund të bëhet relativisht me lehtësi nga filloristët.

Qëllimi

Nxënësit do të mësojnë shkathtësi të thjeshta që nevojiten për trajtim të lëndimeve trupore dhe do të mësojnë rëndësinë e ofrimit të ndihmës së parë të realizuar nga qytetarët.

Klasa	Lloji i mësimit	Vendi	Kohëzgjatja	Numri i nxënësve
V-VI	Trajnim praktik	Shkollë	Varet nga përmbajtja	1 klasë

Përmbajtja

[Hyrje]

Përdorni raste të suksesshme të ofrimit të ndihmës së parë dhe shpjegoni rëndësinë e administrimit të ndihmës së parë derisa prisni që të vijë ambulanca (shih Përshkrimin).

[Shpjegimi i metodave për trajtime]

(1) Selektoni disa metoda për përdorim të fashave trekëndore dhe metodave për ndërprerje të gjakderdhjes dhe shpjegoni nxënësve (shih Referencën).
Do të ishte më lehtë të realizohet kjo pjesë nëse njerëzit me përvojë do të jepnin shpjegime.



[Ushtrimi i trajtimeve]

(2) Pjesëmarrësit ndahen në çifte dhe ushtrjnë trajtimet e sqaruara më herët.
Shënim: Njëri luan rolin e të sëmurit/plagosurit e tjetri e administron trajtimin.



[Rotacioni]

(3) Pastaj ndërroni rolet e të sëmurit/plagosurit dhe ushtroni trajtimin.
(4) Realizojeni trajnimin në formë gare, nëse është e mundur (shih Përshkrimin).



[Përmbledhje]

(5) Tregojuni nxënësve të kenë parasysh rëndësinë e ndihmës së parë, edhe pse pranojnë përvojë të kufizuar për ndihmën e parë me këtë program.
(6) Pyetni nxënësit çfarë tjetër mund të përdoret nëse nuk ka në dispozicion fasha trekëndore.



Çështje të rëndësishme gjatë dhënies së udhëzimeve

(1) Është e rëndësishme që shpjegimet të jepen në mënyrë që nxënësit me të vërtetë të kuptojnë rëndësinë e ndihmës së parë nëpërmjet përvojës, edhe pse teknikat e ndihmës së parë mund të jenë të vështira për filloristët.
(2) Numri i metodave për t'u mësuar le të jetë prej 2 deri 4 sesa të mësohen tepër metoda.

Bashkëpunimi me organizata tjera		
Realizojeni këtë program në bashkëpunim me Komunitetin lokal (Organizatën për red.të rrez. gjatë fatkeqësive), korpusin vullnetar zjarrfikës, etj. sepse nxënësit mund të fitojnë më shumë shpjegime nëse ka më shumë instruktorë.		
Si mund të përfshihet Komuniteti lokal (Organizata për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive)		
Kërkoni prej tyre të ndihmojnë me udhëzimet gjatë administrimit të ndihmës së parë.		
Ndihmë nga zjarrfikësit dhe Korpusi vullnetar zjarrfikës		
Ata ofrojnë udhëzime fillestare për kuadrin shkollor. Gjithashtu ndihmojnë me udhëzime dhe gjatë ditës së trajnimit.		
Pajisjet dhe materialet e nevojshme (Pjesët dhe sasi të standarde)		
Emri i pajisjes/materialit	Sasia	Mund të përgatitet nga
Fasha trekëndore	1 për 2 pjesëmarrës	Shkolla
Revista	Sasia e nevojshme	Shkolla
Facoleta	Sasia e nevojshme	Shkolla
Peshqirë	Sasia e nevojshme	Shkolla
Qese plastike	Sasia e nevojshme	Shkolla
Copë druri (si jaki, nëse ka)	Sasia e nevojshme	Shkolla
Vërejtje	Fashat trekëndore duhet të blehen.	
"Suvenirë" për t'i marrë në shtëpi		
Udhëzoni nxënësit t'ua përcjellin prindërve përvojën e mësuar me këtë program sepse ka shumë të rritur që nuk kanë njohuri për këto metoda.		
Informacione shtesë për këtë program		
Administrimi i ndihmës së parë ka rëndësi, mirëpo ka gjasa që ata që ofrojnë ndihmë të parë të infektohen me llojloj sëmundjesh nëse i prekin lëngjet e trupit të të sëmurëve dhe plagosurve, siç është gjaku dhe e vjella. Kjo ndihmë do të ishte e padobishme nëse ndihmuesit do të infektohenin me sëmundje që shpiejnë në pasojë të pandreqshme. Prandaj, mësoni nxënësit siç duhet për rëndësinë e kontrollit të infektiveve, për shembull, përdorimin e dorezave plastike gjatë ofrimit të ndihmës së parë që të mos prekin drejtëpërdrejtë gjakun dhe të vjellën, si dhe të përdorin pipëz kur ofrojnë frymëmarrje gojë në gojë.		
Si mund të marrin pjesë prindërit		
Ky program është nxjerrur nga programet dhe ligjeratat emergjente për trajnimin e të rriturve. Prandaj, nëse është e mundur kërkoni nga prindërit që të marrin pjesë në këtë program.		
Variacionet		
(1) Gjithashtu është efikase të realizohet trajnim për atë sesi të bëhen barela prej batanieve në kombinim me këtë program me temë 'Operacionet e shpëtimit dhe ndihmës'.		
(2) Nëse nxënësit mësojnë mirë, poashtu është e mundur të organizohen gara (shih Përshkrimin).		
Komente të nxënësve që kanë marrë pjesë në program (në Japoni)		
<ul style="list-style-type: none"> • Ishte mirë që isha në gjendje të mësoj si palos një fashë trekëndore pa mos e vënë në dyshe. • Nëse më rrjedh gjak tani, mund ta ndaloj gjakderdhjen sepse ekzistojnë fasha dhe allçi, mirëpo kur të ndodh ndonjë emergjencë, dua të mbaj mend mësimin e sotëm dhe ta zbatoj në praktikë atë që e mësova. • Dëshiroj t'ju ndihmoj njerëzve të plagosur dhe të rrëzuar kur të ndodh ndonjë fatkeqësi. 		

Përballja! Brigadat me kova

Nxënësit fitojnë
shkathtësi

11

Përshkrimi i programit

Edhe pse brigadat me kova shpesh herë organizohen nga Komuniteti lokal për stërvitje emergjente, ky program i bën nxënësit të garojnë duke parë se cili ekip do të mbush rezervuarin sa më shpejtë, në vend që të përdorin një stërvitje të rëndomtë duke përdorur brigadë me kova.

Qëllimi

Nxënësit do ta mësojnë rëndësinë e bashkëpunimit të ndërsjellë gjatë emergjencave dhe nxisin frymën e ndihmës së ndërsjellë.

Klasa	Lloji i mësimit	Vendi	Kohëzgjatja	Numri i nxënësve
Të gjithë	Trajnim praktik	Shkollë	30 min.	Prej 1 klase deri në të gjithë shkollën

Përmbajtja

[Përgatitja]

- Përgatitni burimin e ujit (rezervuar uji, ujë rubineti, etj.).
- Përgatitni kovat, etj.

[Hyrje]

(1) Shpjegoni se gjatë tërmetit të madh Hanshin-Awaji ekipet e zjarrfikësve nuk mund vetvetiu të fiknin zjarret sepse zjarre shpërthenin në shumë vende, kështu që banorët bashkëpunonin me njëri tjetrin për të luftuar zjarret duke formuar brigada me kova (shih Përshkrimin).



[Lërimi i nxënësve të garojnë sipas mënyrës së tyre]

(2) Ndani nxënësit në ekipe dhe filloni garat për të mbushur një rezervuar me ujë. Lërimi vetë të provojnë, madje edhe nëse nuk formojnë brigada me kova.



[Shpjegime për metodën e saktë]

(3) Shpjegojeni metodën e saktë për brigadën me kova (shih Referencën).



[Organizimi i një gare tjetër duke zbatuar metodën e saktë]

- (4) Nxënësit garojnë sërish me zbatimin e brigadave me kova.
- (5) Pyetni se cila metodë ishte më e efikase kur të krahasoni të parën me të dytën.



Çështje të rëndësishme gjatë dhënies së udhëzimeve

Është e rëndësishme që të krijoni mënyra sesi t'ju mundësoni nxënësve të mësojnë se bashkëpunimi me njëri tjetrin do ta bëjë aktivitetin më efikas sesa secili të veprojë veç e veç.

Bashkëpunimi me organizata tjera		
Kur e realizoni këtë program, kërkoni nga prindërit, zjarrfikësit, banorët, etj., t'ju ndihmojnë gjatë përgatitjes së pajisjeve dhe materialeve, dhënies së udhëzimeve dhe menaxhimin e sigurisë.		
Si mund të përfshihet Komuniteti lokal (Organizata për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive)		
Kërkoni që të japin udhëzime rreth brigadave me kova, etj. Edhe ata mund të marrin pjesë në trajnim me nxënësit.		
Ndihma nga zjarrfikësit dhe Korpusi vullnetar zjarrfikës		
Ata ndihmojnë me përgatitjen e rezervuareve të ujit dhe kovave, si dhe japin udhëzime rreth brigadave me kova.		
Pajisjet dhe materialet e nevojshme (Pjesët dhe sasi të standarde)		
Emri i pajisjeve/materialeve	Sasia	Mund të përgatitet nga
Objekte që bartin ujë siç janë kovat, legenët dhe qeset e plastikës	Sasia e nevojshme	Shtëpi, Komuniteti, shkollë
Objekte të tjera që mund të bartin ujë (provoni objekte të llojllojshme.)	Sasia e nevojshme	Shtëpi, Komuniteti, shkollë
Rezervuar uji (si burim uji)/ (për të mbushur me ujë gjatë garave)	1 për secilin ekip	Zjarrfikësit
Karroçë dore	1	Shkolla, zjarrfikësit, Komuniteti
Zorrë uji (për të mbushur rezervuarin me ujë, si burim uji)	1	Shkolla
Pompë zjarri, zorrë zjarri	1 për secilin ekip	Zjarrfikësit, etj.
Vërejtje	(1) Programi mund të bëhet më interesant duke futur një top basketbolli në rezervuar (të mbushet me ujë gjatë garave) dhe pasi që të mbushet plotësisht me ujë, topi del në sipërfaqe dhe bie. (2) Pompa e zjarrit është e dobishme për të nxjerrur ujin nga rezervuarët e përdorura nga brigadat me kova.	
Si mund të marrin pjesë prindërit		
(1) Ky është një program i mirë për pjesëmarrjen dhe të prindërve sepse nuk ka kufizim të numrit të pjesëmarrësve dhe metoda lehtësisht mund të përshtatet varësisht nga numri i pjesëmarrësve, etj. (2) Kjo gjithashtu do të jetë një përvojë e dobishme për të rriturit sepse edhe të rriturit nuk kanë njohuri për metodat efikase të brigadës së kovave në shumicën e rasteve.		
Mësimet e fituara nga tërmetet të kaluara dhe fatkeqësi të tjera që kanë të bëjnë me këtë program		
(1) Në tërmetin e madh Hanshin-Awaji (që ndodhi në Japoni), u grumbulluan gjësende të ndryshme që mund të mbajnë ujë për të luftuar zjarret pasi që kishte një numër të kufizuar të kovave. Disa të mbijetuar madje i quanin brigadat me kova si "brigada shportash." (2) Brigadat me kova mund të përdoren për bartjen e mallrave të ndryshme përveç ujit për zjarrfikje. Për shembull, brigadat me kova mund të përdoren për bartjen e ndihmave humanitare dhe ujit në kate më të larta të ndërtesave të larta, si dhe të largojnë gërmadha të mëdha nga shtëpitë e rrënuara.		
Variacionet		
Nëse përveç kovave mund të grumbullohen gjësende të llojllojshme që mund të bartin ujë, pjesëmarrësit do të mësojnë t'i përdorin gjësendet e llojllojshme sipas rrethanave (kova plastike, shporta, qese plastike, legenë, etj.)		
Komente të nxënësve që kanë marrë pjesë në program (në Japoni)		
<ul style="list-style-type: none"> • Kovat ishin të rënda. • Kuptova që bashkëpunimi ishte i rëndësishëm. • Dua t'ju ndihmoj njerëzve duke punuar së bashku me fqinjët kur të ndodh ndonjë fatkeqësi. • Dua të ushtroj më shumë sepse do të shkaktohen më shumë dëme nëse nuk i fikim zjarret më shpejtë. • Nëse ndodh një zjarr i vërtetë, dua që ta fik atë duke përdorur metodën e brigadës me kova që e mësova sot. 		


Programi Nr.		<i>Përshkrimi Nr.3</i>		
3				
Emri i programit				
Vizatimi i përfytyrimit tuaj të tërmetit				
Qëllimet e mësimin				
Gjejeni dallimin ndërmjet përfytyrimit të nxënësve për një tërmet dhe fotografive vizuale të tërmeteve të vërteta. Përfytyroni si do duke qyteti ynë kur ta godet tërmeti dhe mësoni nevojën e të qenurit të gatshëm gjatë tërmeteve. Mësoni sa e rëndësishme është për ne që bëjmë jetën e përditshme dhe të çmojmë atë që nuk e marrim me seriozitet.				
Relacioni me lëndët tjera				
"Arti vizatimor dhe manual" – Mësoni metodën e të shprehurit nëpërmjet vizatimit dhe shkathtësive të vizatimit "Etika" – Mësoni frymën e bashkëpunimit dhe rëndësinë e të jetuarit - Mësoni rolin e Komuniteteve lokale				
Orari kohor				
Hyrje	Vizatimi i përfytyrimit	Prezantimi i vizatimit	Konkluzionet	
5 minuta	15-20 minuta	10-15 minuta	5-10 minuta	
Procedurat (Përkrahja dhe çështjet e interesimit)				
<p>[I. Hyrje (5 minuta)]</p> <p>A. Tregonu nxënësve se pothuajse çdo vit tërmete ndodhin në shumë vende të botës dhe se ato shkaktojnë dëme të mëdha. (Do të ishte ide e mirë të pyetni nxënësit çfarë dinë ato për tërmetet.) (Nëse vendin tuaj e ka goditur një tërmet, mund të flitni shkurt për dëmet e shaktuara.)</p> <p>B. "Le të vizatojmë përfytyrimin e tërmeteve. Çfarë mendoni se do t'i ndodh qytetit tone nëse ndodh një tërmet i madh? Përfytyroni dhe vizatojeni përfytyrimin tuaj." (Mos jepni ndonjë përfytyrim konkret të tërmeteve. Lërinu nxënësit të vizatojnë lirshëm.)</p>		<p>Aktivitete mësimi për nxënës</p> <p>○ Përfytyroni një tërmet dhe vizatojeni "Do të shemben ndërtesat kur të godet një tërmet?" "Do të shpëputen rrugët?" "Do të shembet shtëpia ime?"</p> <p>○ Bëni prezantim të vizatimit "Filani vizatoi shtëpinë e tij." "Filani vizatoi një zjarr." "Filani vizatoi një tren jashtë binarëve."</p> <p>○ Krahasur me fotografitë e vërteta të tërmeteve, shkruani se çfarë dallon nga vizatimet e juaja. "Mësova se tërmeti mund të shkaktoj zjarr." "Mësova se shumë ndërtesa mund të shkatërrohen." "Mësova se tërmeti mund të shkaktoj cunami." "Vërejtja njerëz të plagosur." "Mësova se disa njerëz kanë humbur shtëpitë e tyre."</p> <p>○ Mendoni se çfarë mund të bëjmë që të jemi të përgatitur në rast tërmeti. "Shtëpitë dhe rrugët duhet ndërtuar më fortë." "Duhet të përgatitim çantë shpine për evakuim." "Duhet të organizojmë stërvitje evakuimi më shpesh." "Duhet t'i forcojmë/lidhim dollapët dhe pjesët tjera të mobiljeve."</p>		
<p>[II. Vizatimi i përfytyrimit (15-20 minuta)]</p> <p>A. Nuk nevojitet punë në grupe. Çdo nxënës vizaton në mënyrë të pavarur në klasë.</p>				
<p>[III. Prezantimi i vizatimeve (10-15 minuta)]</p> <p>A. Tregojani vizatimin shokëve të klasës. Nëse lejon koha, të gjithë nxënësit, ose disa nxënës, bëjnë prezantimin e tyre para klasës, duke i treguar klasës se çfarë përfytyrimi kanë patur.</p> <p>B. Do të ishte mirë të bëhet përmbledhja e përfytyrimeve të nxënësve në dërrasë të zezë.</p>				
<p>[IV. Prezantimi i fotografive të vërteta vizuale/konkluzionet (5-10minuta)]</p> <p>A. Tregonu nxënësve fotografi ose filma të tërmeteve (fotografi të ndërtesave të rrënuara, zjarreve, dhe cunami) dhe shpjegoni dëmet që shkaktohen nga tërmetet. Tregonu nxënësve se tërmetet nuk shkaktojnë vetëm rrënim të ndërtesave, por dhe zjarre dhe cunami.</p> <p>B. Ndërgjegjësoni nxënësit për dallimin ndërmjet përfytyrimit të tyre të tërmetit dhe atë që e kanë mësuar dhe le të shkruajnë për atë. Shkrimet e tyre le t'i prezantojnë para klasës.</p>				
<p>(Konkluzione)</p> <p>A. Thuajuni nxënësve se jeta jonë e përditshme mund të prishet kur të godet tërmeti, për shembull, nuk do të ketë energji elektrike, gaz, ose ujë, rrugë dhe ndërtesa të rrënuara. (Lërinu të kuptojnë se sa me fat jemi që mund të jetojmë jetërat tona të përditshme dhe të çmojmë atë)</p> <p>B. Të mendojmë se çfarë mund të bëjmë kur godet një tërmet.</p> <p>C. Kërkoni prej nxënësve të flasin me familjet e tyre, kur të kthehen në shtëpi, nëse përgatiten për tërmete ashtu siç biseduam sot. (Nëse vendi juaj, shkolla ose mësuesi ka përjetuar tërmet, përcilluani atë përvojë nxënësve.)</p>				
Zhvillimi drejt krijimit të relacionit me programe tjera				
<p>· Pas fitimit të njohurive rreth tërmeteve, mësoni mënyrat praktike për përballim të tërmeteve (p.sh., si të evakohemi nga shkollat në rast tërmeti) në Programin 7 "Stërvitje për evakuim (në rast tërmeti)."</p> <p>· Mësoni si t'i transportoni njerëzit në rast fatkeqësie, si të ofroni ndihmë të parë dhe si të fikni zjarre në Programet 9, 10, dhe 11.</p>				

Programi Nr.	Referenca	Përshkrimi Nr.4	
4	4-1		
Emri i programit			
Stërvitja për raportim emergjent "Telefono XXX në rast të plagosjes ose zjarrit!"			
Qëllimet e mësimit			
Fitoni njohuri për raportim të zjarrit dhe rasteve emergjente dhe mësoni si të raportoni			
Relacioni me lëndët tjera			
"Studime shoqërore" – Mësoni rolet e zjarrfikësve dhe sistemin e raportimit			
Orari kohor			
Hyrje	Praktika e raportimit	Konkluzionet	
5 minuta	10 minuta	5 minuta	
Procedurat (Përkrahja dhe çështjet e interesimit)			
<p>[I. Hyrje (5 minuta)]</p> <p>A. Shpjegoni nxënësve për atë se kur dhe ku të raportojnë raste të zjarrit dhe emergjencave të tjera, si dhe prej nga nisen kamioni zjarrfikës dhe ambulanca.</p> <ul style="list-style-type: none"> · Kur të raportojmë? Në rast të zjarrit ose emergjencës (sëmundje e papritur, aksident trafiku me person të plagosur, ose plagosje tjera), thirrni stacionin zjarrfikës. * Në rast të një incidenti ose aksidenti, thirrni policinë. * Varësisht nga shteti juaj, numrat e telefonit të zjarrfikësve dhe policisë janë të ndryshme. Jepni shpjegime të përshtatshme sipas rrethanave të juaja. · Ku të raportojmë? Në rastin e qytetit Kobe, të gjitha thirrjet emergjente drejtohen tek "Dhoma e kontrollit të Departamentit të Zjarrfikësve." Shpjegoni se ato nuk i telefonojnë stacionit zjarrfikës pranë tyre kur e bëjnë telefonatën emergjente. Kështu, është me rëndësi që të japin informacione të sakta se nga vjen telefonata. · Nga niset ambulanca ose kamioni zjarrfikës? Në rastin e qytetit Kobe, pas pranimit të një telefonate emergjente, Dhoma e kontrollit automatikisht e zgjedh stacionin zjarrfikës që është më afër emergjencës dhe jep urdhër për të nisur kamioni zjarrfikës ose ambulanca. <p>B. Tregoni nxënësve se sot do të mësojnë sesi të bëjnë një telefonatë emergjente.</p> <ul style="list-style-type: none"> * Përgatitja – përgatitni një telefon (mund të përdoret dhe një telefon i prishur ose telefon lodër për ushtrimin) për të bërë telefonatën emergjente. 		<p>Aktivitete mësimore për nxënës</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Të mësohet mekanizmi i thirrjeve emergjente <ul style="list-style-type: none"> · Në rast zjarri ose emergjence, thirr XXX. · Thirrja emergjente do të drejtohet në (vendin) XXX. (Dallon nga shteti në shtet.) · Nga niset ambulance ose kamioni zjarrfikës? (stacioni i zjarrfikësve ,etj.) ○ Të realizohet një ushtrim për raportim. <ul style="list-style-type: none"> · Katër situata ○ Të diskutohet për atë sesi janë ndierë gjatë prezantimit para klasës. 	
<p>[II. Praktika e raportimit (10 minuta)]</p> <p>A. Duke përdorur Referencën 4-1 ("Raportoni saktësisht"), mësoni si të bëni një telefonatë emergjente për çdo lloj situatë. Ju lutemi shihni Referencën 4-1 (Udhëzuesi për mësuesit) për më shumë hollësi.</p> <p>B. Kërkoni prej disa nxënësve të demonstrojnë para klasës sesi bëhet telefonata emergjente për çdo situatë. Pyetni sesi janë ndier. Sipas orarit kohor, përshtateni numrin e nxënësve të cilët mund të demonstrojnë para klasës.</p>			
<p>[III. Konkluzione (5 minuta)]</p> <p>A. Shihni se ku janë të drejtuara thirrjet emergjente dhe nga nisen ambulanca dhe kamioni zjarrfikës.</p> <p>Në këtë moment, shpjegojeni raportimin jo vetëm për zjarret, por edhe për emergjenca të tjera, përfshirë dhe numrin e telefonit për emergjenca.</p> <p>B. Shpjegoni nxënësve pse nuk duhet të bëhen thirrje emergjente thjeshtë për argëtim sepse thirrjet urgjente i bëjnë qytetarët e rritur.</p> <p>C. Udhëzoni nxënësit që së pari të shikojnë përreth dhe të gjejnë një të rritur, dhe të kërkojnë ndihmë me zë të lartë, në rast zjarri.</p> <p>D. Përfundojeni mësimin duke e ndarë përvojën e mësuesit, etj.</p>			
Zhvillimi drejt krijimit të relacionit me programe tjera			
<p>* Ky program zgjat rreth 20 minuta (mund të përshtatet duke e ndryshuar numrin e nxënësve që bëjnë demonstrim të thirrjeve emergjente) dhe mund të kombinohet me tema tjera.</p> <ul style="list-style-type: none"> · Pas të mësuarit sesi të bëhet një telefonatë emergjente, zhvillojeni temën duke e kombinuar me Programin 8 ose 11 për të mësuar shkathtësitë e zjarrfikjes, ose Programin 10 për të mësuar ofrimin e ndihmës së parë. 			




Raportojeni siç duhet!

Ju jeni dëshmitari. Nuk keni asnjë të rritur rreth juve. Patjetër duhet të raportoni tani.




Kjo është zona për grumbullim të plehrave pranë shtëpisë suaj.



Kjo është një shtëpi pranë shkollës suaj fillore. Ka një shtëpi tjetër pranë kësaj shtëpie. (Duket që s'ka asnjë në këto shtëpi.



Një mik i juaji u godit nga një makinë dhe u lëndua (Këtu në lagje ka një fabrikë)



Kjo është në shtëpinë tuaj (të jeni të kujdesshëm që mos të ndodhë kjo). Kjo është vetëm një stërvitje.

Shembull i përgjigjeve të zyrtarit të dhomës së kontrollit

[Në rast zjarri] (1)



(2)



(4)



Roli i zyrtarit të dhomës së kontrollit	Shembull i përgjigjeve të telefonuesit
*Po vjen një telefonatë. “Alo. Kjo është dhoma e kontrollit të departamentit zjarrfikës XX. Po bëhet fjalë për zjarr apo emergjencë?”	“Zjarr është.”
“Zjarr është, apo jo? Çfarë po digjet?” “Ku ka ndodhur?”	“XX është në zjarr.” (Fëmija e jep adresën e shtëpisë së vet ose shkollës.)
*Në rast se nuk është në gjendje për ta dhënë adresën “A mund të më tregoni ndonjë objekt të madh aty pari?” “Më thoni si qani, ju lutem?”	“Ekziston një shkollë fillore.”
“Mund të më tregoni numrin tuaj të telefonit?” *(Shtoni dialog shtesë sipas mundësisë)	“Unë quhem XXXX.”
“Në rregull. Do të dërgojmë zjarrfikësit menjëherë. Nëse është rrezik, ju lutemi evakuoheni në vend të sigurtë.”	“Po, do të evakuohem.”
*Mbyllet telefonata.	“Mbyllet telefonata.”
Dialogu shtesë:	
“A ka ndonjë gjë që digjet lehtësisht pranë zjarrit?”	“Ka një shtëpi tjetër.” ‘Jo, nuk ka.’
“Sa të mëdha janë flakët? Sa lartë janë flakët?”	“Sa lartësia ime.” ‘Nuk e di.’
“A ka ndonjë të rritur pranë jush?”	“Jo.” ‘Po.’
*Nëse ka, “tregoni personit menjëherë për zjarrit.”	“Po, do ti tregoj.”
*Situata 2: “Cilën pjesë të shtëpisë e ka kapluar zjarri”	“Kati i dytë është në zjarr.”
* Situata 2: “ Ka mbetur ndonjëri ende në shtëpi?”	“Nuk besoj se ka ndonje në shtëpi.” “Nuk e di.”
*Situata 4: “Ke vëllanë ose motrën pranë juve?”	“Jo”. “ Po.”
*Nëse ke, “Evakuoheni menjëherë me ta.”	“Po, do të evakuohemi.”
*Situata 4: “A keni bombolë gazi zjarrfikës në shtëpi?”	“Po, ka.” “Jo, nuk ka.”
*Nëse po, “Mendoni që mund ta fikni zjarrit?”	“Po, do ta provoj.” “Jo, nuk besoj se mundem.”
Nëse fëmija nuk përgjigjet dot, ose heziton të përgjigjet, luteni për të marrë përgjigjen e duhur.	

Shembull i përgjigjeve të zyrtarit të dhomës së kontrollit

Në rast emergjence (3)



Roli i zyrtarit të dhomës së kontrollit	Shembull i përgjigjeve të telefonuesit
*Po vjen një telefonatë.	
“Alo. Kjo është dhoma e kontrollit të departamentit zjarrfikës XX. Zjar është apo emergjencë?”	“Emergjencë është.”
“Emergjencë është, apo jo?” “Çfarë ka ndodhur.”	“Një mikun tim e ka shkelur vetura.”
“Ku ka ndodhur?”	(Jepni adresën e mundshme)
*Në rast se nuk është në gjendje të tregojë adresën “A mund të shihni ndonjë objekt të madh aty pari?”	“Ka një fabrikë.
“Si e keni emrin, ju lutem?”	“Emri im është XXXX.”
“Mund të më tregoni numrin tuaj të telefonit?”	Është XXX-XXXX.
*(Shtoni dialog shtesë sipas mundësisë)	
“Në rregull. Do të dergojmë ambulancë menjëherë. Kur të mbërrij ambulanca, tregojani rrugën për te zona emergjente.”	“Po, do ia tregoj.”
*Mbyllet telefonata.	“Mbyllet telefonata.”
Dialogu shtesë	
“A është në vetëdije personi lënduar?”	“Po.”
“Ku është lënduar ai/ajo?”	“Dora e tij/saj është e lënduar.”
“Si duket?”	“Po i del gjak.”
“A ka të lënduar pjesë të tjera të trupit ai/ajo?”	“Nuk besoj.”
“Si ndodhi aksidenti?”	“Një veturë e shkeli.”
“Çfarë lloji veturë ishte? Kamion ishte?”	“Jo, veturë ishte.”
“Ku është personi i lënduar tani?”	“Në rrugë.”
“Është rrezik në rrugë, prandaj largojeni në trotuar.”	“Po, do ta largoj.”
“A është lënduar edhe dikush tjetër?”	“Jo.”
“A ka ngecur vozitësi brenda në veturë?”	“Jo.”
“A është i lënduar vozitësi?”	“Po. ai/ajo është.”
Nëse fëmija nuk përgjigjet dot, ose heziton të përgjigjet,	

Programi Nr.	Referenca	Përshkrimi Nr.5	
5	5-1		
Emri i programit			
Eksplorimi i shkollës për gjetjen e resurseve për reduktimin e rrezikut gjatë fatkeqësive			
Qëllimet e mësimit			
Të mësojnë për sistemin e reduktimit të rrezikut gjatë fatkeqësive në shkolla fillore dhe si të sillemi gjatë fatkeqësive.			
Relacioni me lëndët tjera			
"Studime shoqërore" – Mësojnë rreth parapërgatitjeve të zakonshme për ballafaqim me fatkeqësi - Mësojnë rreth roleve të institucioneve publike, siç janë shkollat.			
Orari kohor			
Hyrje dhe shpjegime fillestare	Eksplorimi i shkollës	Prezantimi dhe konkluzionet	
5-10 minuta	25-30 minuta	10 minuta	
Procedurat (Përkrahja dhe çështje të interesimit)			
<p>[I. Hyrje dhe shpjegime fillestare (5-10 minuta)]</p> <p>A. Në Japoni, shkollat fillore shfrytëzohen si zona evakuimi në rast të emergjencave. Duke u bazuar në situatën në vendet e juaja, diskutoni për vendet e evakuimit dhe rolin e tyre.</p> <p>B. Bisedoni për dëmet e shkaktuara nga tërmetet në vendin tuaj dhe vende tjera.</p> <p>C. Shpjegoni para kohe se çfarë objektësh posedon shkolla. (Shpjegoni rolet dhe metodat e përdorimit të atyre objekteve.)</p> <p>D. Shpjegoni nxënësve se në këtë program do të eksplorojmë shkollën që të gjejnë objekte që mund të përdoren si zona evakuimi, si p.sh. palestra, etj., pajisjet që janë në dispozicion në rast të zjarrit ose vendet që paraqesin rrezik.</p> <p>E. Jepni udhëzime dhe merrni masa para se të eksploroni shkollën (Mos i shqetësoni klasat tjera, shpjegoni vendet në të cilat nxënësve nuk iu lejohet të shkojnë, si p.sh. çatia, mos eksploroni vetëm, mos dilni jashtë terrenit të shkollës, etj.)</p> <p>F. Mund të jetë efikase dhe sigurtë të krijoni grupe dhe paraprakisht të caktoni vendet ku të eksplorojnë ato grupe. Përdoreni ose shpërndajeni Referencën 5-1, dhe jepni këshilla për eksplorimin.</p> <p>G. Konfirmojeni sistemin për menaxhim me fatkeqësi në shkollë dhe shihni se çfarë objektësh posedon shkolla. (Mësuesit)</p> <p>[II. Eksplorimi i shkollës (25-30 minuta)]</p> <p>A. Caktoni kohën se kur të takohen nxënësit dhe fillojeni eksplorimin e shkollës.</p> <p>B. Mësuesit duhet të vendosen nëpër ato vende ku nxënësit mund të shqetësojnë klasat tjera ose vende që mund të jenë vështirë për nxënësit t'i gjejnë (përfshirë dhe vende që kanë materiale të rrezikshme, siç është kabineti i shkencës, ose vende që janë vështirë për t'u gjetur, siç janë hidrantët e ujit kundër zjarrit në ndërtesë).</p> <p>C. Nëse është e mundur, ngitni shenja për të treguar ato vende.</p> <p>D. Nëse ka plan të kateve, bëni kopje dhe shpërndajeni nxënësve. Kjo do të jetë një vegël e dobishme për eksplorimin.</p> <p>[III. Prezantimi dhe konkluzionet (10 minuta)]</p> <p>A. Kërkoni nga çdo grup të bëjë prezantim lidhur me atë se çfarë kanë gjetur gjatë eksplorimit. Do të ishte ide e mirë të kërkoni prej tyre të shkruajnë një përmbledhje të prezantimit të tyre në dërrasë të zezë.</p> <p>B. Nëse janë shpërndarë kopje të planit të kateve të shkollës, çdo nxënës mund t'i shkruaj gjetjet e tyre në to.</p> <p>C. Kur nxënësit të flasin për pajisjet që i kanë gjetur, mund të jepen shpjegime shtesë, si p.sh., si të përdoren pajisjet.</p> <p>D. Pas prezantimit, jepni shpjegime shtesë nëse nevojitet. (Shih referencën 5-1 (Udhëzuesi për mësuesit).)</p> <p>E. Si pjesë e konkluzioneve të këtij programi, tregoni nxënësve ku janë të magazinuar pajisjet dhe si të përdoren ato në rast të një fatkeqësie, si p.sh., në klasë, kabineti i muzikës ose palestër. Përfundojeni mësimin duke i njoftuar nxënësit me përvojën e mësuesit, etj.</p>		<p>Aktivitete mësimore për nxënës</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Të mësojnë për rolin që e luan shkolla gjatë tërmeteve. ○ Të mësojnë rreth pajisjeve të llojllojshme për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive që gjenden brenda shkollës. ○ Të mësojnë për procedurat e eksplorimit të shkollës. <ul style="list-style-type: none"> · Ku të kërkojnë (vendet) · Çfarë të kërkojnë (listuar më poshtë) · Vendet ku nxënësit nuk duhet të shkojnë · Mos flitet me zë. Mos vrapohet, etj. ○ Eksplorimi i shkollës <Shfrytëzimi i Referencës 5-1> <ul style="list-style-type: none"> · Gjërat dhe vendet që duhet shfrytëzuar kur shkolla përdoret si zonë evakuimi. · Gjërat që duhet përdorur në rast zjarri. · Gjërat dhe vendet me rrezik. · Gjërat që mund t'ju ndihmojnë njerëzve. ○ Prezantimi i asaj çfarë kanë gjetur gjatë eksplorimit. ○ Merrni shënime në hartë boshe 	
Zhvillimi drejt krijimit të relacionit me programe tjera			
<ul style="list-style-type: none"> · Ky program mund të përdoret para ose pas stërvitjes aktuale për evakuim (Programi 7) për të rritur njohuritë e nxënësve. · Pas eksplorimit të shkollës, provoni një eksplorim në komunitet (Programi 6). 			

Eksplorimi i Shkollës për Gjetjen e Resurseve për Parandalim të Fatkeqësive

Viti () Klasa () Emri ()

Zona që e eksplorova ()

Të eksplorojmë!

[Vendet dhe gjërat në dispozicion të shkollës kur shkolla bëhet zonë evakuimi gjatë emergjencave]

Shembull) Zona (Kati I) - Palestra (vendi ku qëndrojnë të evakuarit)

[Gjërat që duhet përdorur në rast zjarri dhe gjërat që duhet përdorur për të alarmuar njerëzit për zjarrin]

[Gjërat dhe vendet me rrezik]

[Gjërat që mund t'iu ndihmojnë njerëzve]

Eksplorimi i Shkollës për Gjetjen e Resurseve për Parandalim të Fatkeqësive

Viti () Klasa () Emri ()

Zona që e eksplorova ()

Të eksplorojmë!

[Gjërat dhe vendet në shkollë që janë në dispozicion kur shkolla bëhet zonë për evakuim emergjent]

- Zonat e evakuimit emergjent – palestrën dhe auditorin, etj.
- Fushën atletike – të evakuarit mund të rrinë në stenda dhe vetura në fushën atletike kur vendet e sipërpërmendura të mbushen me njerëz. Gjithashtu përdoret edhe si zonë evakuimi për nxënësit në rast zjarri.
- Banjoja- të evakuarit mund ta përdorin.
- Fontana e ujit – njësoj si më lartë.
- Pishinën (me ujë) – uji mund të përdoret për përdorime ditore kur shterohen burimet e tjera të ujit.
- Bataniet, etj. – nëse ka gjësende të tjera në dispozicion të shkollës që mund të përdoren për menaxhim të zonave të evakuimit, theksoni tani.

[Gjërat që duhet përdorur në rast zjarri dhe gjërat që duhet përdorur për të alarmuar njerëzit përreth]

- Bombolat e gazit zjarrfikës – tregoni nxënësve se duhet të verifikojnë lokacionin e tyre në ndërtesë.
(të rriturit do ta fikin zjarrin)
- Hidrantet e ujit në ndërtesë – tregoni nxënësve se nuk duhet të lënë gjëra rreth hidrantit të ujit.
- Aparati për alarmin e zjarrit – panelet e kontrollit janë të vendosura në sallën e arsimtarëve dhe të sherbetori – Tregoni nxënësve çfarë duhet të bëjnë kur të aktivizohet alarmi.
- Pompa elektrike kompakte – nëse ka ndonjë magazin për materiale dhe furnizime, njoftoni nxënësit me to. (bataniet, kovat, etj.)

[Vendet dhe gjërat me rrezik]

- Kabineti i shkencës – materiale të rrezikshme, etj.
- Gjëra që mund të bien (dollarë, etj.)
- Njoftoni nxënësit me vendet dhe gjërat sipas situatave.

[Gjërat që mund t'iu ndihmojnë njerëzve]

- AED (defibrilatori automatik i brendshëm) njoftoni nxënësit për vendin ku gjendet.
- Materialet dhe furnizimet për parandalim të fatkeqësive – nëse këto janë në dispozicion në shkollë, tregoni nxënësve për to si dhe lokacionin e tyre.
- Kabinetin e shëndetësisë – barnat për ndihmën e parë dhe barelat, etj.

* Verifikoni para kohe sistemet e menaxhimit të fatkeqësive dhe sistemet e zjarrfikjes në shkollë.

* Më sipër janë dhënë shembuj në Japoni. Shpjegimet e juaja duhet të përshtaten sipas rrethanave të vendit tuaj.

Programi Nr.	Referenca	Përshkrimi Nr.6			
6	6-1				
Emri i programit					
Shëtitja nëpër qytet për gjetjen e resurseve për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësive					
Qëllimet e mësimit					
Të mësojnë për gatishmërinë gjatë fatkeqësive në komunitet dhe vendet e rrezikut në zonën e shkollës					
Relacioni me lëndët tjera					
"Studime sociale" – Të mësojnë për rolin e Komuniteteve lokal dhe përgatitjen ditore					
Orari kohor					
Hyrje	Eksplorimi i qytetit	Krijimi i hartës së sigurisë	Prezantimi	Konkluzionet	
15 minuta	30-40 minuta	30-40 minuta	10-15 minuta	5 minuta	
Procedurat (Përkrahja dhe çështjet e interesimit)					
<p>[I. Hyrje dhe parapërgatitje (15 minuta)]</p> <p>A. Kjo temë është e ndërlidhur me "Hartën e sigurisë në komunitet" nën seksionin e "Programeve të Komunitetit për stërvitje emergjente." Këtu, në fakt, nxënësit dalin dhe e eksplorojnë qytetin; bashkëpunoni me Komunitetin lokal (BOKOMI) dhe jepjani këtë program.</p> <p>B. Shpjegoni paraprakisht pse është e nevojshme krijimi i kësaj harte dhe çfarë duhet të kërkojnë për të krijuar këtë hartë.</p> <p>C. Nëse ekziston një hartë blanko e qytetit, ajo hartë mund të përdoret.</p> <p>D. Nëse mund të keni mbështetjen e Komunitetit dhe personelit të stacionit zjarrfikës ose korpusit vullnetar zjarrfikës, kërkoni që ata t'i presin fëmijët në vende konkrete që t'ju japin shpjegime ose të menaxhojnë sigurinë e tyre.</p> <p>E. Ndajeni klasën në grupe të vogla paraprakisht dhe caktoni se cilat në cilat zona duhet të shkojnë për kërkimin e tyre. Kini parasysh se zonat e eksplorimit nuk duhet të jenë shumë të mëdha. Shmangeni rrugëve me shumë trafik dhe ato të braktisura që të parandaloni incidente ose aksidente të nxënësve.</p>			<p>Aktivitete mësimore për nxënës</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Të mësojnë metodën e eksplorimit të qytetit <ul style="list-style-type: none"> · Ku gjendet zona e eksplorimit? (Zona e shkollës deri në qytetin XX, rrugën XX) · Koha e nevojshme për eksplorim? (Periudha e parë dhe e dytë shkollore) · Çfarë eksplorojnë? · Cilat janë çështjet e interesimit? (Metoda e kontaktimit të mësuesit në rast të një emergjence, etj.) ○ Të eksplorohej qyteti <ul style="list-style-type: none"> · Veproni në grupe · Eksploroni vetëm vendet e caktuara · Kthehuni me kohë në vendin e takimit ○ Të krijohet një hartë sigurie (secili grup) <ul style="list-style-type: none"> · Shënoni në hartë blanko atë që e keni zbuluar ○ Të bëhet prezantimi i gjetjeve duke u bazuar në hartën e krijuar. ○ Të ndahen mendime rreth eksplorimit. 		
<p>[II. Eksplorimi i qytetit (30-40 minuta)]</p> <p>A. Tregoni nxënësve se kur duhet të takohen, e pastaj të fillojnë kërkimin e tyre me hartë blanko. Patjetër t'u tregoni nxënësve të kenë kujdes nga veturat dhe të kalojnë tek vizëbardhat. Do të ishte ide e mirë të caktohet një lider për çdo grup.</p> <p>B. Bëni parapërgatitjet e nevojshme, si dhe ku të kontaktoni në rast emergjent, si p.sh., shpërndarja nxënësve kartela me numrin e telefonit të shkollës, si dhe monedha të vogla për të bërë telefonatat. Nëse mund të keni mbështetjen e Komunitetit, kërkoni prej tyre të qëndrojnë në vende të caktuara gjatë eksplorimit. Do të ishte ide e mirë t'ju kërkoni të ofrojnë shpjegime rreth pajisjeve dhe materialeve për reduktim të rrezikut gjatë fatkeqësisë para Deposë.</p> <p>C. Shfrytëzohen Referencën 6-1, mbani shënime për gjërat që i keni gjetur në mënyrë rendore.</p>					
<p>[III. Krijimi i hartës së sigurisë (30-40 minuta)]</p> <p>* Nxënësit le të bëjnë pushime të shkurtra sipas orarit</p> <p>A. Pas kthimit nga eksplorimi, çdo grup i shënon gjetjet e tyre në një hartë blanko. Do të ishte ide e mirë të listoni të gjitha gjetjet në një fletë të madhe.</p> <p>B. Nëse mund të keni mbështetje nga Komuniteti (BOKOMI) ose zjarrfikësit, kërkoni prej tyre të marrin pjesë në krijimin e hartës së sigurisë dhe të japin mendimet e tyre.</p> <p>C. Nëse mundeni, përgatitni një hartë të madhe blanko dhe ngjiteni mbi dërrasën e zezë, pastaj secili grup le t'i shënojë gjetjet e tyre mbi të sipas zonës që e kanë eksploruar. Në këtë mënyrë, do të krijohet një hartë origjinale e sigurisë.</p>					
<p>[IV. Prezantimi (10-15 minuta)]</p> <p>A. Secili grup do të mbajë prezantim duke u bazuar në hartën e sigursë që e kanë krijuar. Do të ishte ide e mirë të kërkoni prej tyre të ndajnë mendimet e tyre rreth eksplorimit.</p> <p>B. Nëse nxënësve iu ka ikur ndonjë çështje, mësuesit mund të japin shpjegime shtesë. Nëse ka të pranishëm pjesëtarë të Komunitetit (BOKOMI), kërkoni prej tyre të ndajnë mendimet e tyre.</p>					
<p>[V. Konkluzione (5 minuta)]</p> <p>A. Bisedoni për nevojën e bërjes së kërkimeve të përditshme në komunitet, si dhe rëndësinë e bërjes së parapërgatitjeve të nevojshme në rast të një fatkeqësie, siç janë tërmetet.</p> <p>B. Thuajuni nxënësve se gjithashtu duhet të kenë kujdes nga vendet me rrezik në komunitet dhe të verifikojnë rrugën e evakuimit në baza ditore (nga shkolla në shtëpi, shtëpia te zona e evakuimit) në rast të një fatkeqësie. (Verifikojini paraprakisht zonat e evakuimit në komunitet)</p> <p>C. Thuajuni nxënësve të flasin me familjet e tyre për zonat dhe rrugët e evakuimit.</p> <p>D. Përfundojeni mësimin duke i njoftuar nxënësit me përvojën e mësuesit, etj.</p>					
Zhvillimi drejt krijimit të relacionit me programe tjera					
· Do të ishte ide e mirë të eksploroni shkollën duke e zbatuar Programin 5 para se të eksploroni qytetin/komunitetin.					

Shëtitja nëpër Qytet për Gjetjen e Resurseve për Menaxhim të Fatkeqësive

Viti Klasa Emri Grupi ()

Zona që e eksplorova ()

Shënoni çfarë keni gjetur gjatë eksplorimit (përfshirë dhe lokacionin)

Gjëra që mund të përdorni në rast zjarri ose tërmet në zonat e evakuimit

Gjërat/vendet me rrezik

Shënoni gjërat për të cilat keni dëgjuar nga njerëzit në qytet

Programi Nr.	Referenca	Përshkrimi Nr. 7	
7	7-1		
Emri i programit			
Evakuohuni sigurtë dhe qetë! (Stërvitja për evakuim)			
Qëllimet e mësimit			
Të mësohet nevoja e stërvitjeve të evakuimit në shkolla dhe procedurat sesi në fakt bëhet evakuimi nga godinat e shkollave.			
Orari kohor			
Stërvitje evakuimi	Konkluzione		
15 minuta	5 minuta		
Procedurat			
<p>[I. Parapërgatitja fillestare]</p> <p>* Realizoni rregullisht stërvitje evakuimi në shkolla në rast zjarri ose tërmeti. Si mësim fillestar, nxënësit mësojnë si të evakuohen nga godina e shkollës në rast zjarri ose tërmeti. Mësojnë njohuri të majftueshme për planet e evakuimit në çdo shkollë dhe si të raportojnë ndonjë incident, mësojnë për zonat e evakuimit, metodat e evakuimit, metodat e zjarrfikjes, si të transportojnë të plagosurit, etj. (nga mësuesit)</p> <p>[II. Plan konkret për stërvitjen e evakuimit]</p> <p>A. Bisedoni dhe merrni vendim në mbledhjen e kolegiumit për llojin e stërvitjeve të evakuimit që ka nevojë shkolla në rast zjarri ose tërmeti duke e përdorur Referencën 7-1 "Skenari për stërvitjen e evakuimit."</p> <p>B. Duke u bazuar në skenarin, caktoni rolet e çdo mësuesi. Është e mundur që disa mësues të përjetojnë stërvitjen së bashku me nxënësit (duke mos i treguar disa pjesë të skenarit). Ju lutemi provojeni këtë. Në këtë rast, drejtori, nëndrejtori dhe mësuesit e ngarkuar me këtë detyrë duhet të krijojnë një skenar dhe të realizojnë stërvitjen pa mos iu dhënë mësuesve të tjerë dhe nxënësve informacione për vendin e fatkeqësisë, pengesat në rrugë, njerëzit humbur, etj.</p> <p>[III. Realizimi i stërvitjes (15 minuta)]</p> <p>A. Realizojeni stërvitjen sipas planit. Varësisht nga përmbajtja e stërvitjes, caktoni njerëz për mbajtjen e kohës, vërtetimin e stërvitjes dhe ato që e luajnë rolin e njerëzve të plagosur.</p> <p>B. Mësuesve dhe nxënësve që e luajnë rolin e njerëzve të plagosur dhe të humbur do iu jepen shpjegime, para kohe, për rolet e tyre, përfshirë dhe vendndodhjen. Paralajmëroni këto nxënës të mos flasin për rolet e tyre me nxënësit e tjerë.</p> <p>C. Stërvitja kundër zjarrit do të filloj kur do të aktivizohet alarmi automatik dhe kur do të bëhet shpallja publike për tërë shkollën. Si metodë më praktike, mund të përdoret një raketë ndriçuese në korridor që t'i paralajmëroj nxënësit në mënyrë vizuale. Kjo do të shënojë fillimin e stërvitjes. Në rast të tillë, është e nevojshme që nxënësit në korridor t'i lajmërojnë nxënësit tjerë në klasa dhe vite të ndryshme për zjarrin (në rast të stërvitjes kundër zjarrit).</p> <p>D. Në rast të stërvitjes për tërmet, do të ishte ide e mirë të transmetohet tingulli gjëmues nëpërmjet sistemit shkollor të adresimit publik në mënyrë që të duket më realiste.</p> <p>E. Pas sinjalit të dhënë për emergjencën, nxënësit do të evakuohen nga ndërtesa shkollore te oborri i shkollës duke zbatuar udhëzimet e mësuesve. Evakuoni duke pasur parasysh tre MOS: Mos u shtyni, mos vraponi dhe mos flitni. Kur ka ndonjë pengesë në rrugë, ndërroini rrugë. Në rast të stërvitjes për tërmet, nxënësit duhet të zvarriten nën banka së pari, e pastaj të fillojnë të evakuohen.</p> <p>F. Kur të gjithë nxënësit të jenë evakuar në oborr, kërkoni t'i thonë emrat me zë një nga një për të shikuar nëse mundon ndonjë (cili nuk është evakuar). Nëse mungojnë njerëz, mësuesit në krye do t'i kërkojnë ata. Mësuesit e tjerë do ta fikin zjarrin (në rast të stërvitjes kundër zjarrit) dhe do të ofrojnë ndihmë të pare për njerëzit e plagosur/lënduar. Shpëtimi i njerëzve mund të bëhet nga ekipi zjarrfikës. (Ekipi mund të shpëtojë njerëzit mbi çati duke përdorur kamion me shkallë.)</p> <p>* Nxënësit mund të mësojnë për punën e zjarrfikësve.</p> <p>[IV. Konkluzione (5 minutes)]</p> <p>A. Drejtori ose shefi i stacionit të zjarrfikësve mund të japin komente në fund. Mësuesi në krye do t'i njoftoj të gjithë për atë sesa minuta kaluan për të përfunduar evakuimin e plotë dhe do të komentojë disa çështje të stërvitjes.</p>		<p>Aktivitete mësimore për nxënës</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Nxënësit që e luajnë rolin e njerëzve të plagosur do të pranojnë shpjegime para kohe dhe do ta luajnë rolin në përputhje me ato udhëzime. ○ Pas aktivizimit të alarmit për emergjencë, nxënësit do të evakuohen nga ndërtesa shkollore sipas udhëzimeve të mësuesve. <ul style="list-style-type: none"> · Nëse stërvitja është për tërmet, nxënësit duhet të zvarriten nën bankat e tyre së pari. · Nëse stërvitja është për zjarr, nxënësit duhet t'i mbulojnë gojë e tyre me façoleta, etj. dhe të evakuohen nga ndërtesa duke e mbajtur trupin e tyre sa më të përkulur që mundet. · MOS-at: Mos u shtyni, mos vraponi, mos flitni, mos u ktheni dhe mos u afroni. 	
Zhvillimi drejt krijimit të relacionit me programe tjera			
<ul style="list-style-type: none"> · Një stërvitje evakuimi zakonisht zgjat rreth 20 minuta. Pas stërvitjes, mund të jetë ide e mirë të vazhdohet me programe tjera. · Mund të pasojë një ushtrim me ardhjen e prindërve në shkollë dhe marrjen e fëmijëve të tyre. (Nxënësit mund të shkojnë në shtëpi pas këtij ushtrimi.) 			


Skenarët e stërvitjeve të evakuimit

1. Në rast të stërvitjes kundër zjarrit

- (1) Të caktohet vendi i fatkeqësisë ()
- (2) Të caktohet madhësia e zjarrit (Mund të fiket me bombolë gazi zjarrfikës, Mund të fiket me hidrant uji,
Ose Është e pamundur të bëhet zjarrfikje fillestare)
- (3) Vendosija e njerëzve të lënduar (Po: persona/Jo) (Vendi:) (Rolet: Mësuesit/Nxënësit)
- (4) Njerëz që nuk u evakuuan (Po: Persona/Jo)(Vendi:) (Rolet: Mësuesit/Nxënësit)
- (5) Caktimi i kohës për ndodhjen e fatkeqësisë (Gjatë pushimit: Gjatë orës: periudha. Gjatë drekës. Të tjera ()
- (6) Prania e një pengese në rrugën e evakuimit (Po/Jo) (Vendi: devijim:)
- (7) Njerëz të humbur (Po: persona/Jo) (Vendi:) (Rolet: Mësuesit/Nxënësit)
- (8) Vendosija e mësuesve që janë në krye të verifikimit të stërvitjes (kohëmatësi/Personi që verifikon stërvitjen: Vendet

[Procedurat e stërvitjes]

(Ndërtesa e shkollës, etj)




2. Në rast të stërvitjes për tërmet

- (1) Përcaktoni madhësinë e tërmetit (intenziteti i tërmetit: Dëmet e ndërtesave:)
- (2) Përcaktimi i dëmeve të ndërtesa (Po/Jo) (Vendi: Devijim:)
- (3) Vendosija e të lënduarve (Po: persona/Jo) (Vendi:) (Rolet: Mësuesit/Nxënësit)

- (4) Vendorsja e njerëzve të humbur (Po: persona/Jo) (Vendi:) (Rolet: Mësuesit/Nxënësit)
- (5) Personat e paevakuar (Po: persona/Jo) (vendi:) (Rolet: Mësuesit/Nxënësit)
- (6) Përcaktimi i kohës për ndodhjen e fatkeqësisë (Gjatë pushimit, Gjatë mësim: ndërrimi, Gjatë drekës, të tjera())
- (7) Përcaktimi i mësuesve në krye të verifikimit të stërvitjes (Kohëmatësi/Personi që e verifikon stërvitjen: Vendet

[Procedurat e stërvitjes

(Ndërtesa e shkollës, etj)




- * Skenari mund të përshtatet edhe për cunami, gjetjen e një personi të dyshimtë ose objekti, etj. Bëhuni kreativ dhe krijoni skenarin tuaj

Programi Nr.				<i>Përshkrimi Nr.8</i>
8				
Emri i programit				
Lojë me qitje në objektiv duke përdorur bombola uji zjarrfikës				
Qëllimet e mësimin				
Të mësohet sit ë përdoren bombolat zjarrfikës nëpërmjet trajnimit që është si lojë me qitje				
Relacioni me lëndët tjera				
"Studime shoqërore" – Të mësojnë të jenë të përgatitur për fatkeqësi				
Orari kohor				
Hyrje	Përdorimi i bombolave me ujë për qëllime stërvitjeje	Konkluzione		
5 minuta	10-35 minuta (sipas numrit të pjesëmarrësve)	5 minuta		
Procedurat				
<p>[I. Parapërgatitja fillestare]</p> <p>A. Nëse mund të keni mbështetje nga zjarrfikësit, korpusi vullnetar i zjarrfikësve ose pjesëtarët e Komunitetit, ata do të mund të përgatitin materialet e nevojshme dhe ofrojnë udhëzime si të përdoren bombolat e ujit.</p> <p>B. Do të ishte ide e mirë të kërkonit që prindërit e nxënësve të marrin pjesë në stërvitje.</p> <p>C. Departamenti i zjarrfikësve dhe vetëqeverisja lokale mund të posedojnë bombola zjarrfikës për qëllime trajnimit dhe modele edukative të bombolave zjarrfikës. Kontaktoni vetëqeverisjen lokale për këto kërkesa.</p> <p>Mësimi preliminar</p> <p>Masat parandaluese në komunitet për përballimin e fatkeqësive dhe pse Komuniteti përgatit masa të tilla mund të mësohen para trajnimit. Në këtë mënyrë, nxënësit mund të përmirësojnë njohuritë e tyre kur të shohin pjesëmarrës nga Komuniteti (BOKOMI). Nxënësit gjithashtu do të mësojnë se ku janë të vendosur bombolat e gazit zjarrfikës.</p>			<p>Aktivitete mësimore për nxënës</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Të fitojnë njohuri paraprake për aktivitetet e parandalimit të zjarreve në komunitet dhe ku janë të vendosura bombolat e zjarrit. ○ Të dëgjojnë shpjegimet rreth bombolave të gazit dhe si t'i përdorin. <ul style="list-style-type: none"> · Të barten bombolat afër zjarrit. · Të hiqet gjilpëra, dhe të vihet caku në shënjestër me zorrën. · Të shtypet leva dhe të lëshohet pluhuri. ○ Loja me qitje në cak me përdorim të bombolave të ujit (për qëllime trajnimit). ○ Të bisedojnë me anëtarët e familjeve të tyre në shtëpi sesi të përdoren bombolat e gazit zjarrfikës 	
<p>[II. Hyrje (5 minuta)]</p> <p>A. Informoni nxënësit për këtë në vijim: Bombolat e gazit zjarrfikës përdoren në fazën e parë të zjarrfikjes (para se flakët të arrijnë në tavan). Nxënësit nuk duhet të tentojnë të fikin zjarrin, por duhet menjëherë të evakohen dhe të informojnë të rriturit. Bombolat e ujit që do të përdoren janë për qëllime trajnimit dhe nuk mund të përdoren për zjarr të vërtetë. Një bombolë e vërtetë gazi zjarrfikës do të lëshojë pluhurin kur të shtypet leva dhe do të vazhdojë të lëshojë pluhurin derisa të zbrazet (rreth 15 sekonda).</p> <p>B. Për këtë trajnim, klasa mund të ndahet në grupe and mund të garojnë. Në këtë mënyrë, nxënësit edhe do të ushtrojnë edhe do të argëtohen.</p>				
<p>[III. Përdorimi i bombolave të ujit për qëllime trajnimit (10-35 minuta)]</p> <ul style="list-style-type: none"> · Lojë me qitje në shishe plastike (shishe uji e mbushur me vetëm 1/3 me ujë) si cak <p>A. Vendosni disa nga këto shishe plastike mbi tryezë.</p> <p>B. 1-3 e njerëzve të çdo grupi do të merr pjesë në lojë. Me dhënien e sinjalit, secili prej tyre të merr nga një bombolë dhe të lëviz në drejtim të caktuar. Pastaj, le të heqin gjilpërën, e vënë shishen në shënjestër dhe shtypin levën për të dalur uji. (Përshtateni numrin e pjesëmarrësve dhe caqeve sipas orarit kohor.)</p> <p>C. Qëllimi i garës është që grupi t'i rrezojë të gjitha shishet. Grupi që e bën këtë në kohën më të shkurtër do të jetë fitues.</p> <p>D. Nëse shishet kanë shumë ujë, nuk do të mund të rrezohen lehtësisht. Përshtateni sasinë e ujit në shishe siç duhet.</p> <p>* Mund të krijoni edhe një cak që do të rrezohet pasiqë të goditet me ujë. Jini kreativ që nxënësit të argëtohen me trajnimin.</p>				
<p>[IV. Konkluzione (5 minuta)]</p> <p>A. Nëse ka pjesëmarrës nga departamenti i zjarrfikësve ose Komuniteti (BOKOMI), kërkonit prej tyre të japin komentet e tyre.</p> <p>B. Udhëzoni nxënësit se duhet t'i mësojnë edhe anëtarët e familjeve të tyre si t'i përdorin bombolat. Gjithashtu mund t'i mësojnë familjet e tyre si të raportojnë një zjarr.</p> <p>C. Përfundojeni mësimin duke ua përcjellur nxënësve përvojën e mësuë, etj. Nëse ka pjesëtarë të Komunitetit, falenderoni pjesëmarrjen e tyre para nxënësve dhe përfundoni trajnimin.</p>				
Zhvillimi drej krijimit të relacionit me programe tjera				
<ul style="list-style-type: none"> · Ky program do të zgjat së paku 20 minuta. Pas trajnimit, mund të jetë ide e mirë të vazhdoni me programe tjera. · Kombinojeni me stërvitjen për evakuim (Programi 7) · Mësoni si të raportoni një zjarr (Programi 4) · Mësoni metoda tjera të zjarrfikjes (Brigada me kova) (Programi 11) 				


Programi Nr.	Referenca	<i>Përshkrimi Nr.9</i>	
9	9-1		
Emri i programit			
Përjetimi i transportimit të një personi me batanie			
Qëllimet e mësimit			
Të mësojnë se mund të bëjnë barelë duke përdorur gjërat përreth tyre dhe të mësojnë si ta bëjnë atë			
Relacioni me lëndët tjera			
"Etika" – Të mësojnë për rëndësinë e ofrimit të ndihmës së ndërsjellë			
Orari kohor			
Hyrje	Ndërtimi I barelës për bartjen e njerëzve të lënduar/plagosur	Konkluzione	
5 minuta	10 minuta	5 minuta	
Procedurat			
<p>[I. Hyrje (5 minuta)]</p> <p>A. Pas tërmetit të madh Hanshin-Awaji, nuk kishte barela të mjaftueshme në dispozicion. Prandaj, njerëzit përdornin gjësendet rreth tyre si p.sh., shtresat tatami, futona, batanie, dhe dërrasën e derës për të bartur njerëzit e plagosur.</p> <p>B. Udhëzoni nxënësit se me këtë program do të mësojnë si të bëjnë barela duke përdorur gjërat rreth tyre dhe do t'i bartin shokët e klasës me të vërtetë.</p> <p>C. Përgatitni gjërat në dispozicion të shkollës, si p.sh., bataniet, shtiza/shkopinj dhe mësoni se mund të bëni barela prej tyre.</p> <p>[II. Ndërtimi i barelës/bartja e njerëzve (10 minuta)]</p> <p>A. Do të ishte ide e mirë të ndani klasën në grupe. Përgatitni materialet e nevojshme sipas numrit të grupeve. Grupit duhet të përbëhet prej së paku 5 anëtarëve dhe do të bashkëpunojnë me njërit tjetrin për të bartur personin e plagosur. (Njëri prej anëtarëve të grupit do të luajë rolin e personit të plagosur)</p> <p>B. Bazuar në Referencën 9-1 (Si të bëni barelë prej batanies), vetë nxënësit në fakt do të bëjnë barela. Zbatoni udhërat për bërjen e barelave.</p> <p>C. Njëri nga anëtarët e secilit grup do të luajë rolin e personit të plagosur, kurse të tjerët do ta bartin me barelë këtë person. Jepni udhëzime për çështjet e shqetësimit gjatë bartjes së personit me barelë, të cilat janë përshkruar në fund të Referencës 9-1. Është e rëndësishme që nxënësit të ulin barelën ngadalë në tokë që të mos e lëndojnë kokën në tokë personi i plagosur</p> <p>D. Që të shmangen aksidentet gjatë këtij programi, distanca e nxënësve që e bartin barelën nuk duhet të jetë e madhe. Mund të përdorni edhe një kukull në vend të personit.</p> <p>E. Nxënësit të ndërrojnë rolet e tyre duke e luajtur personin e plagosur kështu që të gjithë nxënësit do të përjetojnë bartjen e tyre në barelë.</p> <p>F. Në fund, edhe mësuesi mund të luajë rolin e të plagosurit dhe të bartet nga nxënësit. Në këtë mënyrë, nxënësit mund të mësojnë se barela është mjaft e fortë për të bartur edhe të rritur.</p> <p>G. Nëse lejon koha, provoni metodat e tjera të bartjes së njerëzve të përshkuara në Referencën 9-1.</p> <p>[III. Konkluzione (5 minuta)]</p> <p>A. Dëgjoni përshtypjet e nxënësve që kanë qenë bartësit dhe të atyre që kanë qenë të plagosurit.</p> <p>B. Përveç batanieve dhe shtizave/shkopinjve të përdorur në këtë mësim, mund të përdoren edhe shumë gjëra të tjera në rast të një fatkeqësie, si p.sh., shportat ose qeset për mbeturina për të bartur ujë për fikjen e zjarrit, si dhe mbështjellës plastike rreth plagës së të plagosurit për parandalim të hemostazës. Këto gjëra mund të përgatiten para kohe dhe të ruhen në një torbë për evakuime emergjente.</p> <p>C. Përfundojeni mësimin duke i njoftuar nxënësit me përvojën e mësuesit, etj.</p>		<p>Aktivitetet mësimore për nxënësit</p> <p>○Të mësohet se njerëzit, gjatë tërmeteve të vërteta, kanë përdorur gjësendet përreth tyre për të bartur njerëzit.</p> <p>○Të dëgjojnë një mësim sesi bëhet një barelë.</p> <p>○Ndërtimi i barelës dhe bartja e një personi.</p> <p>○Të mësojnë metoda të tjera për bartjen e njerëzve (Referenca 9-1)</p> <p>○Të ndahen përshtypjet e bërjes së barelës dhe bartjes me barelë edhe me nxënësit e tjerë në klasë</p> <p>"Po dridheshte shumë dhe isha i frikësuar. 'Mendoval se njerëzit duhet bartur ngadalë."</p> <p>"Ndërtimi i një barele ishte më e lehtë sa që mendoja."</p> <p>"U habita kur pashë se barela mund të bëhej me aq gjëra të thjeshta përreth neve."</p>	
Zhvillimi drejt krijimit të relacionit me programe tjera			
<ul style="list-style-type: none"> · Ky program do të zgjat rreth 20 minuta. Pas programit, do të ishte ide e mirë të vazhdohet me programe tjera. · Kombinojeni me stërvitjen për evakuim (Programi 7) · Mësoni si të raportoni një zjarr (Programi 4) · Mësoni metoda të zjarrfikjes (Programet 8,11) 			

Si të krijohet një barelë me batanie

- Përgatitja
 - 1 batanie
 - 2 shtiza/shkopinj bambu (Mund të përdoren këmbalka)
- Si të bëjmë një barelë prej batanies (Shih foton më poshtë)



Mënyra të ndryshme të bartjes së njerëzve




[Çështje që duhet konsideruar kur bartet një person]

- Kur bartet një person me ndihmën e të tjerëve, këmba e personit duhet të jetë përpara – Në këtë mënyrë, njerëzit që e bartin personin dhe që janë më afër kokës së tij/saj mund t'ia shohin fytyrën.
- Ngriteni dhe uleni ngadalë. – Para se ta ulni, sigurohuni që toka të jetë e rrafshët nën batanien dhe uleni ngadalë për të evituar goditjet.
- Kur e ngritni dhe ulni, ngriteni dhe uleni në 3, duke numëruar '1,2,3!', që të mund ta ngritni dhe ulni njëkohësisht. – Caktoni një person që të thotë '1,2,3,' dhe të tjerët e ngritin dhe ulin në 3. Koordinimi i dobët mund të lëviz batanien, që është e rrezikshme.
- Kujdes pozitiv të trupit tuaj gjatë ngritjes! Kur ngritni diçka të rëndë, mund të tërhiqni ndonjë muskul të shpinës. Pozita e keqe e trupit mund të dëmtojë shpinën tuaj.

Programi Nr.	Referenca	Përshkrimi Nr.10	
10	10-1		
Emri i programit			
Të ushtrojmë të trajtojmë plagët			
Qëllimet e mësimit			
Të kuptohet domosdoshmëria e administrimit të ndihmës së parë dhe të mësuarit e shkathhtësisë			
Relacioni me lëndët tjera			
"Edukatë fizike dhe të shëndetit" – të mësohet administrimi i ndihmës së parë			
Orari kohor			
Hyrje	Ndihma e parë me fasha trekëndore	Konkluzione	
5 minuta	35 minuta	5 minuta	
Procedurat			
<p>* Administrimi i ndihmës së parë me fasha trekëndore mund të realizohet me udhëzime të ekipit të shpëtimit. Mund të kërkoni udhëzime nga ato që e dinë metodën si p.sh., kuadri shkollor ose anëtarët e Komunitetit (BOKOMI).</p> <p>[I. Hyrje (5 minuta)]</p> <p>A. Rregulla themelore e reagimit ndaj një fatkeqësie është që të raportohet menjëherë dhe të administrohet ndihma e parë. Tregoni nxënësve se është e rëndësishme të njoftojnë menjëherë një të rritur kur të hasin një rast emergjent.</p> <p>B. Tregoni nxënësve se metoda e ndihmës së parë të cilën do ta mësojnë sot do të jetë e dobishme në raste emergjente. Kur në fakt administrojnë ndihmë të parë, është e rëndësishme që të mos e prekin gjakun e të tjerëve.</p> <p>[II. Trajnimi për administrimin e ndihmës së parë me fasha trekëndore (35 minuta)]</p> <p>A. Bazuar në Referencën 10-1 (Ndihma e parë me fasha trekëndore), nxënësit do të ushtrojnë si ta bëjnë atë duke përdorur fasha të vërteta. Së pari, ushtroni "Si të paloset një fashë trekëndore."</p> <p>B. Pastaj, provoni disa metoda të përdorimit të fashave trekëndore të përshkuara në Referencën. Përcaktohuni për disa metoda sipas orarit kohor. Ekzistojnë 5 metoda për përdorimin e fashave trekëndore për të mbështjellur pjesë të ndryshme të trupit.</p> <p>C. Ndahuni në çifte në klasë dhe ushtroni me njëri tjetrin. Përdorni "nyjen palë" si mënyrë themelore të lidhjes së fashës (shih "Trajnimin për lidhjen e nyjeve të litarëve" në pjesën "Programet e komunitetit për stërvitje emergjente"). Në këtë program, përqendrohuni si të përdorni një fashë dhe nuk ka shumë rëndësi të flitet shumë për mënyrat e lidhjes</p> <p><Këshillë për progamin></p> <ul style="list-style-type: none"> Luani një lojë për të ushtruar disa metoda – pasi që nxënësit të mësojnë disa metoda të përdorimit të fashës në pjesë të ndryshme të trupit, të luajnë një lojë për të parë se cili çift do të mund të mbështjellë më mirë pjesën e trupi dhe në mënyrë më të saktë. Përcaktohuni për dy metoda të cilat i kanë mësuar nxënësit. Kur mësuesi të thotë, "Filloni," secili çift do të fillojë të mbështjell pjesën e trupit të partnerit duke përdorur fashë trekëndore. Kur një çift të ketë mbaruar mbështjelljen, vijnë para mësuesit dhe ai/ajo e kontrollon lidhjen. Nëse është lidhur shumë lirë dhe mund të lirohet shpejtë, duhet ta bëjnë sërish. 10 çiftet e para që me sukses i kanë lidhur fashat janë fituesit. Kështu, nxënësit do të argëtohen më shumë gjatë trajnimit. <p>[III. Konkluzione (5 minuta)]</p> <p>Mendoni se çfarë do të bënit nëse nuk kishit fasha trekëndore. (përdorni fasha, peshqir ose facoletë).</p> <p>A. Tregoni nxënësve se mund të përdorim gjërat pranë nesh në rast të emergjencës, kur furnizimet tjera janë të kufizuara. Mund të përdorim edhe mbështjellës plastike për hemostazën, ose një revistë ose çadër për dorë ose këmbë të thyer, në vend të jakisë.</p> <p>B. Tregoni nxënësve se do të ishte e dobishme, në rast emergjence, nëse mbajnë një fashë trekëndore, peshqir ose mbështjellës plastike në çantën e tyre të evakuimit.</p> <p>C. Përfundojeni mësimin duke i njoftuar nxënësit me përvojën e mësuesit, etj.</p>		<p>Aktivitete mësimore për nxënës</p> <p>○Të mësojnë domosdoshmërinë e administrimit të ndihmës së parë.</p> <p>○Të mësojnë si të përdorin fashë trekëndore për mbështjelljen e pjesëve të ndryshme të trupit</p> <ul style="list-style-type: none"> · Si të paloset fasha trekëndore · Fashohet koka · Fashohet balli · Fashohet këmba dhe krahu · Mbështillet koka (pa e palosur fashën) · Mbështillet dora ose shputa e këmbës <p>○Të mësojnë për gjëra të dobishme përveç fashave trekëndore</p> <ul style="list-style-type: none"> · Përdorin facoleta, peshqir ose mbështjellës plastike, etj, në vend të fashës trekëndore · Përdorin revistë ose çadër, etj, në vend të jakisë. 	
Zhvillimi drejt krijimit të relacionit me programe tjera			
· Mësoni si të thirrni ambulancën për ndonjë lëndim/plagë duke e zbatuar Stërvitjen për raportim emergjent (Programi 4).			

Ndihma e parë me përdorim të fashave trekëndore


1. Si të paloset një fashë trekëndore




Mbajeni fashën trekëndore të pastër.
Mos e palosni në tokë.
Paloseni gjatë mbajtjes.
Provoni!

2. Mënyra të ndryshme të përdorimit të fashave trekëndore (me palosje)

Fashojeni kokën qendër



Fashojeni ballin (përafërsisht 15 cm)



Fashojeni krahun ose këmbën
Mbajeni fashën në këtë pozitë




Bëni një nyje afër bërrylit.



Kur e beni nyjen, shmangeni plagën.

3. Mënyra të llojlojshme të përdorimit të fashave trekëndore (pa palosje)

Kur e mbuloni kokën



Kur e mbuloni dorën ose këmbën



Fasha trekëndore është material i dobishëm që mund të përdoret me palosje ose pa palosje.
Mbajeni një në shtëpi, për çdo rast!

Programi Nr.	Referenca	Përshkrimi Nr.11	
11	11-1		
Emri i programit			
Përballja! Brigada me kova			
Qëllimet e mësimit			
Të mësojnë shkathësitë për zjarrfikje dhe rëndësinë e punës së përbashkët			
Relacioni me lëndët tjera			
"Etika" – Të mësojnë rëndësinë e ndihmës së ndërsjellë			
Orari kohor			
Hyrje	Pasimi i kovave	Konkluzione	
5 minuta	20 minuta	5 minuta	
Procedurat			
<p>* Në këtë mësim, nxënësit do të mësojnë si të fikin një zjarr duke realizuar një Garë me pasim të kovave dhe duke përdorur kova të rëndomta. Kërkoni bashkëpunimin e njerëzve të Komunitetit.</p> <p>[Parapërgatitja fillestare]</p> <ul style="list-style-type: none"> Përgatitni një rezervuar me ujë që të shërbejë si burim uji dhe një tjetër që do të shërbejë si enë depozitimi. Departamenti i zjarrfikësve ose vetëqeverisja lokale mund të kenë në dispozicion rezervuarë për qëllime edukative. Kërkoni ato. <p>[I. Hyrje (5 minuta)]</p> <p>A. Tërmeti i madh Hanshin-Awaji shkaktoi shumë zjarre në qytetin Kobe (54 zjarre ndodhën brenda 14 minutave pas tërmetit). Ishte pamundur të luftohen të gjitha nga zjarrfikësit. Tregonu nxënësve se banorët e zonës së tërmetit i fiknin zjarret duke përdorur metodën e Brigadave me Kova (pasim të kovave njëri tjetrit) duke përdorur kova dhe shporta plehërash.</p> <p>B. Si mësim fillestar, nxënësit mund të mësojnë për dëmet e tërmeteve të kaluara. Kjo do të avancojë njohuritë e tyre për rëndësinë e Brigadave me kova.</p> <p>[II. Brigada me kova (20 minuta)]</p> <p>Me qëllim që nxënësit të kuptojnë rëndësinë e Brigadave me kova, tregojuni të bartin ujë duke bartur një kovë deri në një pikë të caktuar pa mos iu dhënë udhëzime. (Do të mësojnë që nuk nuk është efikase.)</p> <p>A. Krijoni një rresht me një grup njerëzish, p.sh. të gjithë nxënësit e klasës ose shkollës. Bazuar në Referencën 11-1 (Metoda e Brigadave me Kova), krijoni një rresht me një grup njerëzish.</p> <p>B. Ndajeni tërë grupin në dy dhe le të garojnë me njëri tjetrin që të shohin cili ekip do të bart ujë më shpejtë. (Përgatitni rezervuarë të mëdha uji ose përdorni kazanët e plehrave si enë depozitimi. Ekipi që do të mbush enën e depozitimit i pari, do të jetë fituesi.) Kështu, nxënësit do të argëtohen me këtë program.</p> <p>C. Para garës, tregoni nxënësve të ushtrijnë masat vijuese: mos e lëkundin kovën, mos e mbushin tepër me ujë dhe mos e heqin dorën nga kova derisa t'ia dorëzojnë personit tjetër. Sipas orarit mund të organizohen disa gara.</p> <p>[III. Konkluzione (5 minuta)]</p> <p>A. Pasiqë të garojnë dy ekipe, përgëzoni fituesit. Nëse marrin pjesë në këtë program anëtarë të Komunitetit ose të zjarrfikësve, lutni që të japin komentet e tyre. Luteni dhe drejtorin që të jep komentet e tij.</p> <p>B. Nëse ka pjesëmarrës nga Komuniteti, falenderoni për pjesëmarrjen e tyre dhe mbylleni trajnimin.</p>		<p>Aktivitete mësimore për nxënës</p> <ul style="list-style-type: none"> Të mësojnë për rastet e kaluara (tërmetet në Japoni) Të mësojnë rëndësinë e Brigadave me kova dhe metodën e zbatuar Të organizohen gara me Brigada kovash (Zbatimi i Referencës 11-1) Të shkëmbejnë përshtypjet e tyre 	
Zhvillimi drejt krijimit të relacionit me programe tjera			
<ul style="list-style-type: none"> Ky program (nëse realizohet vetëm Brigada me kova) do të zgjat rreth 20 minuta. Pas programit, do të ishte ide e mirë të vazhdohet me programe të tjera. Kombinoheni me stërvitjen e evakuimit (Programi 7) Mësoni si të raportoni një zjarr (Programi 4) Mësoni metoda të tjera të zjarrfikjes (bombola) (Programi 8) 			

Metoda e Brigadave me Kova (pasim)


Si të rreshtohemi për Brigadën me Kova

Shënim: Çdo rresht me njerëz ka përparësitë dhe mangësitë e veta. Selektoni një rreshtim të përshtatshëm në pajtim me numrin e pjesëmarrësve dhe llojin e pjesëmarrësve (p.sh., pjesëmarrës me ose pa përvojë).

(1) Rënditje në një rresht

Kjo është e përshtatshme kur ka numër të vogël të njerëzve.

Pjesëmarrësit qëndrojnë në një rresht në distancë 1.5 metre larg njëri tjetrit dhe pasojnë kova me ujë nga burimi i ujit tek burimi i zjarrit. Rreth një e pesta e numrit të njerëzve në rresht janë të caktuar për kthimin e kovave të zbrazura tek burimi i ujit. Mangësia e kësaj metode është se njerëzit nuk mund të shohin çfarë ndodh prap tyre. Nëse është e nevojshme, caktoni personel të cilët do të kujdesen për sigurinë e pjesëmarrësve (për shembull, kur krijohet një rresht i këtillë në anën tjetër të rrugës).




(2) Rënditja në një rresht ku njerëzit janë të përballur njëri me tjetrin

Ky është verzion i modifikuar i renditjes në një rresht.

Njerëzit qëndrojnë në një rresht. Çdo numër tek kthehet 180 shkallë që të mund të shohin në drejtim të personit tjetër, në drejtim të personim me numër çift. Njerëzit me numër tek bëjnë dy hapa prapa. Kjo krijon mundësi që një grup njerëzish të shohin ndërmjet boshllëqeve të njerëzve që i kanë para tyre. Pastaj mund të shohin nëse ka ndonjë rrezik prapa tyre (prapa njerëzve me të cilët janë të përballuar)


Mangësia e këtij sistemi është se kërkon më shumë kohë në renditjen e njerëzve në pozitat e tyre.



(3) Rënditja në dy rreshta

Kjo është metodë e përshtatshme ku ka shumë pjesëmarrës.

Njerëzit në njërin rresht ua kalojnë kovat me ujë njerëzve në rreshtin tjetër për t'i kthyer tek burimi i ujit. Të dy rreshtat qëndrojnë të renditur duke ia kthyer shpinën njëri tjetrit, kështu e realizojnë brigadën me kova dhe ia ruajnë shpinën njëri tjetrit (nëse e ballafaqojnë njëri tjetrin, do të jetë vështirë të kontrollohet siguria e njëri tjetrit sepse e bllokojnë pamjen e njëri tjetrit). Distanca e duhur është 1 metre. Nëse nuk ka numër të mjaftueshëm njerëzish, caktoni anëtarë në distancë prej 1 metre në rreshtin që dorëzon ujë, kurse të tjerët caktoni në rreshtin e kthimit të kovave të zbrazura.



(Shënim) Distanca është vetëm një udhëzues i përafërt. Përshtateni distancën ndërmjet njerëzve sipas madhësisë së trupit të tyre.

(Shënim) Udhëzoni që të mos i mbushin kovat me ujë të tepërt (50-60%)

Doracaku “BOKOMI”

- Shkëmbimi i mësimëve të fituara në Qytetin Kobe nga Tërmeti i madh i ashtuq. Hanshin-Awaji -

**Programet për Stërvitje gjatë Emergjencave në komunitet
dhe
Programet Edukative Arsimore gjatë Fatkëqsive**

Shkup, 2016

Kansai International Center, Japan International Cooperation Agency (JICA KANSAI)

Disaster Reduction Learning Center (DRLC)

1-5-2 Wakihama Kaigan-dori, Chuo-ku, Kobe-shi, Hyogo 651-0073, JAPAN

TEL: +81-78- 261-0341 FAX: +81-78- 261-0465

KOBE City Office

KOBE City Fire Bureau (KCFB)

6-5-1, Kanou-cho, Chuo-ku, Kobe, Hyogo 650-8570, JAPAN

TEL: +81-78-325-8510 FAX: +81-78- 392-2119

Programi duhet të shfrytëzohet vetëm për qëllime jokomerciale dhe për të mirën publike!